

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

UBT News

Media & Events

4-24-2017

UBT News - Prill 2017

University for Business and Technology

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper>

Recommended Citation

University for Business and Technology, "UBT News - Prill 2017" (2017). *UBT News*. 2.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper/2>

This Book is brought to you for free and open access by the Media & Events at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in UBT News by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Editorial: Historia e UBT-së në 680 faqe libri

Faqe 2

Presidenti Thaçi: Ushtria do të bëhet, s'ka kthim prapa



Faqe 3

Janusz Bugajski: SHBA nuk ka ndërruar qasje ndaj Kosovës



Faqe 4

Ekspertët e NATO-s sqarojnë anëtarësimin e shteteve në këtë organizatë politike e ushtarake



Faqe 6

Kosova triumfon në Garën për Siguri kibernetike në Çeki

Faqe 7

UBT e nderon me Çmimin "Excellence Leadership Award", Driton Kukën

Faqe 9

Ministri Ferat Shala: Qytetarët e Kosovës të jetojnë në një ambient shumë më të pastër

Faqe 14

Kosova kishte nevojë për dije evropiane e amerikane – e sollëm me UBT-në



Sulmet kibernetike, kërcënimi më i madh ndaj sigurisë dhe privatësisë

(faqe 11)

Editorial

Edmond Hajrizi

Historia e UBT-së në 680 faqe libri

Mbi 680 faqe ka një libër që është botuar javë më parë. Në të përfshihen të gjitha aktivitetet kryesore të UBT-së, në një hark kohor prej 15 vjetësh, nga viti 2001 deri në vitin 2016. Fotografitë e fillimit tregojnë një institucion në fillesat e tij. Por, në to shpërfaqen trajnime e konferenca serioze, profesorë ndërkombëtarë, planprograme studimi kryesisht të reja për kohën dhe për Kosovën.

Lajmet nga periudha e fillimit, po kështu, dëshmojnë të njëjtën gjë – synimin e qartë të UBT-së që të sjellë në Republikën e Kosovës modelin e universiteteve më të mira amerikane e evropiane. Një shkollë të re. Një mundësi të ri. Një mendësi të re. Një qasje ndryshe, shumë më të ndryshme e më të avancuar se studimet akademike që ishin ofruar deri atëherë në vendin tonë e në rajon.

Shfletimi i këtij libri, nga muaji në muaj e nga viti në vit, dëshmon plotësisht se ky institucion u rrit, u zgjerua e u zhvillua pandalshëm, por duke i qëndruar besnik, pa asnjë lëkundje, parimeve të vëna në themel të punës – programet më të mira akademike, profesorët më të mirë ndërkombëtarë e vendorë, studentët më të mirë e më të kërkuar në tregun e punës. Të gjitha ato që një institucion e bëjnë të jetë i kërkuar nga të rinjtë e të rejtat që nisin jetën akademike, të respektuar në nivel vendor e rajonal, adresë të parë bashkëpunimi për të gjitha universitetet e institucionet akademike ndërkombëtare. Adresë të padiskutueshme për të gjitha institucionet shtetërore të Kosovës, që kanë nevojë për përkrahje profesionale në të gjitha fushat. Institucion, përfutur i padiskutim i shumë projekteve nga institucionet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian, që përkrahin institucionet akademike e profesionale në Kosovë e në rajon. Për të arritur deri këtu, sigurisht që është dashur punë e madhe, e pandalshme. Pesëmbëdhjetë vjet mund të duken pak, por kur shihet sa puna është kryer dhe cili është niveli që ka arritur UBT gjatë kësaj periudhe, mund të duket e pabesueshme që është një institucion me moshë kaq të re. Për ta kuptuar këtë, të shohim vetëm telegrafikisht të dhënat kryesore të UBT-së sot:

Katër kampuset, ai në Prishtinë, në Lipjan, në Prizren e në Ferizaj, si dhe zyrat e kontaktit në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës dhe kryeqendrat e vendet të rajonit e më gjerë i mundësojnë UBT-së të jetë në kontakt të përhershëm edhe me studentët edhe me institucionet partnere.

Por, janë fakultet në të cilat ofron studime UBT, që e bëjnë atë institucion atraktiv e kaq të kërkuar: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi; Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri; Mekatronikë dhe menaxhment; Sistemet e informacionit; Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor; Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe infrastrukturë; Juridik; Shkenca Politike; Media dhe Komunikim; Politika Publike dhe Menaxhim; Inxhinieri e Energjisë; Shkenca e Shëndetësisë dhe Teknologjia (Infermiera); Dizajn i integruar; Shkenca e ushqimit dhe Teknologjia.

Në UBT funksionojnë edhe këto institute: Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim (IEME); Instituti për Ndërmarrësi, Transfer të Teknologjisë dhe Inovacione; Instituti për Gjuhë dhe Kompetencë ndërkulturore; Instituti për Studime Evropiane dhe Ndërkombëtare; Instituti për Zhvillimin e Arsimit dhe Çështjeve Akademike; Instituti për Planifikim Hapësinor, Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inxhinieri; Instituti për Politika Publike dhe Menaxhment; Instituti për Shkenca dhe Teknologji dhe Instituti për Sundimin e Ligjit. Rezultatet që ato sjellin, me hulumtimet e tyre, janë mundësi shumë e madhe për studentët dhe profesorët e UBT-së, por edhe për të gjithë profesionistët e interesuar.

Pastaj, duke u zgjeruar UBT themeloi edhe institucione të tjera: Asociacioni Kosovar për Menaxhim: Quality Kosova; Shoqata e Kosovës për Kontrollin e Automatizimit dhe Sistemeve Inxhinierike; Qendra për Turizëm dhe Mikpritje; Qendra për Statistika, Përpunimi i të dhënave dhe Parashikimi; Qendra për Modelim dhe Simulim; Qendra për Zhvillim të Softuerit dhe Inovacionit; Qendra për inkubacion dhe start-up; Qendra për Arte, Multimedia dhe Kulturë; Qendra për Siguri Kibernetike dhe Privatësia; Qendra për Zhvillim Profesional dhe mësimin gjatë gjithë jetës; Qendra për IPR dhe mbështetje ligjore; Qendra për Menaxhim të Dijes dhe Biblioteka; Qendra e UBT e SAP University Alliance.

Po ashtu, funksionojnë: Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare; Zyra për Sigurimin e Cilësisë; Zyra për Shërbimet ndaj studentëve; Zyra për Zhvillimin e Karrierës dhe

Internship; UBT Biblioteka; Laboratori i modelimit dhe simulimit; Laboratorët e programimit të kompjuterëve; Laboratori për Mekatronikë dhe inxhinieri; Laboratori për Sistemet e inteligjencës dhe laborator i robotikës; Laboratori i rrjeteve dhe komunikimit; Laboratori i sistemeve të operimit; Qendra për Certifikim; Laboratori i energjisë; Laboratori i shkencave materiale; Laboratori i prodhimit industrial; Laboratori i aftësive klinike; Laboratori i mikrobiologjisë; Laboratori i kimisë; Laboratori i fizikës; Laboratori i biokimisë; Laboratori i fizioterapisë; Laboratori i anatomisë; Laboratori me pajisje për kryerjen e workshopeve; Laboratori i fiziologjisë; Laboratori i teknologjisë ushqimore; Laboratori i krijimtarisë dhe projektimit të studios; Laboratori i krijimit të hapësirave; Laboratori për projektim të tekstileve; Laboratori i arteve të bukura; Laboratori për projektimin e arkitekturës; Laboratori i këndit të sipërmarrjes; Laboratori i arkitekturës kompjuterike; Laboratori i SAP e të tjera.

Pastaj “Spin Off-et”: “Quality Kosova” - Shoqata e Kosovës për Menaxhment, Anëtare e Shoqërisë Ndërkombëtare për Menaxhimin e Projekteve; CA-CASE - Shoqata e Kosovës për Kontroll, Automatizim të Sistemeve të Inxhinierisë: anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare për Kontroll dhe Automatizim; KA-SIM - Shoqata e Kosovës për Modelim dhe Simulim, anëtare e EUROSIM (Federata Evropiane e Shoqatave të Simulimit); KAAF- Shoqata e Kosovës për Kontabilitet, Auditim dhe Financa; IES - Shërbimi i Përsosmërisë Intelektuale; Qendrat Rajonale të UBT-së për Zhvillimit Akademik; IPC - Vlerësimi dhe Certifikimi Personal Ndërkombëtar.

Gjithashtu, Akademitë Verore dhe Ditët Zyrtare: Akademia e Inovacionit dhe Sipërmarrjes; Akademia e Informacionit dhe Teknologjisë së Komunikacionit; Akademia e Robotikës dhe Teknologjisë së Avancuar; Akademia e Projektimit të Qëndrueshëm dhe të Integruar; Akademia e Energjisë Efiçiente; Akademia e Shkencave të Jetës; Akademia e Studimeve Evropiane dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Akademia e Investimeve të Huaja të Drejtpërdrejta dhe Zhvillimit Rajonal; Akademia e Infrastrukturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit; Dita e Mbrojtjes së Konsumatorit; Dita e Inovacionit; Dita e Sipërmarrjes; Dita e Projektit; Dita e Cilësisë; Dita e Turizmit dhe Mikpritjes; Dita e Austrisë dhe Kosovës; Forumi i Biznesit etj.


Kur zhvillon gjithë këtë aktivitet, sigurisht që anëtarësime ndërkombëtare janë të pashmangshme. Këto janë vetëm disa nga anëtarësimet: EOQ - European Organization for Quality; IPMA - International Project Management Association; IFAC - International Federation for Automatic and Control; ITA - Information Technology for Automotive Industry; SEECEL - South East European Countries Entrepreneurship Learning; FIRA European Chapter - Federation of International Robot-soccer Association (1st Place in 2011); PLAN = Procurement Laë Academic Network; AESOP - Association of European Schools of Planning; EUROSIM - The Federation of European Simulation Societies; EFQM - The European Foundation for Quality Management; UIIN - University Industry Innovation Network; IASP - International Association of Science Parks and Areas of Innovation etj.

E partnerët ndërkombëtarë janë të numër, rreth 250, institucione nga shtetet kryesore në SHBA, në Evropë e gjetu: Itali, Çeki, Francë, Rumani, Poloni, Spanjë, Bullgari, Britani e Madhe, Austri, SHBA, Irlandë, Kanada, Suedi, Finlandë, Norvegji, Kore Jugore, Japoni, Turqi, Gjermani, Shqipëri, Kroaci, Slloveni, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni, Mali i Zi, Lituani, Letoni, Hungari, Portugali, Holandë, Zvicër, Moldavi, Sllovaki...

Përfundimisht, nga fillimi e deri sot, në UBT kanë qenë të angazhuar 1009 profesorë, ekspertë e kuadër tjetër profesional. Një numër shumë i madh, për t'u admiruar. Kur kësaj t'i shtohet se një numër shumë i madh prej tyre janë ndërkombëtarë, kjo e shton edhe shumë më shumë vlerën e UBT-së.

Ky është UBT, telegrafikisht. Rrita dhe zhvillimi i tij tashmë ecë njëtrajtshëm – vazhdimisht duke u rritur e duke u zgjeruar, duke shtuar numrin e fakulteteve dhe drejtimeve të studimit, duke shtuar numrin e profesorëve, studentëve, partnerëve, instituteve e institucioneve.

Gjithnjë i pari, gjithnjë një hap para të tjerëve.



IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Numrin e përgatitën: Jehona Kapllani, Anisa Rada, Edona Jerliu, Fatbardhë Kiqina dhe studentët e Media dhe Komunikimit

Adresa: www.ubt-uni.net / Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Trimor Racaj

Presidenti i Republikës së Kosovës vizitoi UBT-në

Presidenti Thaçi: Ushtria do të bëhet, s'ka kthim prapa

Presidenti i Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaçi vizitoi UBT-në. Ai u prit nga rektori, prof.dr.Edmond Hajrizi dhe u njoftua lidhur dhe punën dhe funksionimin e këtij institucioni model të arsimit të lartë në vend e në rajon.

Në vijim, para një numri të madh studentësh, profesorësh dhe të interesuarish të tjerë, Presidenti Thaçi mbajti një ligjëratë dhe bashkëbisedoi me të pranishmit për shumë procese të rëndësishme nëpër të cilat është duke kaluar shteti ynë.

Në ligjëratën e tij në UBT, presidenti Thaçi ka thënë se si shtet po kalojmë nëntë vjet të themelimit dhe gradualisht kemi arritur që të konsolidohemi dhe forcohemi.

“Kemi arritur t'i kemi 114 njohje ndërkombëtare. Presim njohje të reja në ditët e ardhshme. Kemi arritur të anëtarësohemi në shumë organizata ndërkombëtare. Në veçanti ka qenë vit i jashtëzakonshëm ky i kaluari sa i përket anëtarësimit të Kosovës në organizatat sportive ndërkombëtare si UEFA, FIFA”, ka thënë presidenti Thaçi.

Presidenti ka thënë se synimi dhe qëllimi, por edhe vizioni ynë, është që të jemi sa më shpejtë pjesë e familjes evropiane dhe pjesë e NATO-s.

Ai është ndalur me theks të veçantë edhe tek krijimi i ushtrisë së Kosovës, si dhe tek Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin ndëretnik në Kosovë.

“Duke respektuar Kushtetutën e Kosovës, ligjet në fuqi, të drejtën e një vendi të pavarur dhe sovran, unë kam iniciuar këto ditë projektligjin në përputhje të plotë me procedurat, rregulloren e punës së Kuvendit, pra projektligjin për themelimin e ushtrisë së Kosovës apo transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës nga misioni civil në atë ushtarak”, ka thënë presidenti Thaçi.

Ky propozim e ka edhe parahistorinë e vet, sipas presidentit Thaçi, sepse FSK-ja është një forcë që e kemi krijuar nga zero, në kuadër të transformimeve apo shpërbërjes së TMK-së dhe pastaj fillimit të ndërtimit të FSK-së, në pjesën e dytë të vitit 2008 dhe fillimit të vitit 2009. “Ka qenë një proces krejt i mbikëqyrur, i trajnuar prej faktorit ndërkombëtar, NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Prandaj, me të drejtë të plotë në vitin 2014 kemi marrë vendim dhe kemi pasur mbështetjen e plotë të faktorit ndërkombëtar, të SHBA-së dhe NATO-s, për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. S'ka më kthim, ushtria do të bëhet”, ka thënë ai.

Për shkak të zhvillimeve të brendshme politike, presi-



denti Thaçi ka thënë se asokohe spektri politik ka hezituar që të votojë në Kuvendin e Kosovës për themelimin e Forcave të Armatosura.

“Në atë kohë kemi humbur një shans, të cilin jemi munduar ta përmirësojmë gjatë tërë këtyre tri vjetëve, mirëpo pas zgjedhjeve 2014, ngërçit politik që ka ndodhur dhe ardhjes së Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës është krijuar një realitet krejt tjetër”, ka thënë presidenti Thaçi.

Ai ka thënë se Lista Serbe e ka dhënë përgjigjen e saj për krijimin e ushtrisë së Kosovës dhe serbët e Kosovës po shfrytëzohen vetëm si karta për nacionalizmin e autoriteteve në Beograd.

“Pas kësaj përgjigje shumë të qartë, për fat të keq u krijua një realitet që në vend që të shkojmë me ndryshime kushtetuese, duhet të lëvizim me ligj, gjë që lejon edhe Kushtetuta edhe e drejta jonë ligjore si shtet sovran”, ka thënë presidenti Thaçi.

Presidenti ka thënë se nuk mund të anëtarësohemi as në NATO dhe në asnjë mekanizëm tjetër, madje as të fillojmë procesin e partneritetit për paqe, pa e themeluar ushtrinë.

“Do të vazhdojmë të punojmë me të gjithë faktorin relevant politik. Do të vazhdojmë të punojmë me shoqërinë civile. Do të vazhdojmë të punojmë me mediat, me të gjitha komunitetet në Kosovë, në mënyrë që ky proces të

ketë sukses të plotë”, ka thënë presidenti Thaçi.

“Kemi pasur 109 nënshkrime për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. Besoj se do t'i kemi 110 deputetë të Kuvendit të Kosovës që do ta mbështesin plotësisht themelimin e ushtrisë së Kosovës”, ka shtuar ai.

Kurse, për iniciativën e themelimit të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin ndëretnik në Kosovë, presidenti Thaçi ka thënë se ai komision do të jetë i pavarur, i paanshëm dhe do të udhëhiqet prej përfaqësuesve të dy komuniteteve, shqiptare dhe serbe.

“Jam shumë i vetëdijshëm se këto projekte nuk fitojnë ndonjë duartrokitje apo nuk paraqesin ndonjë entuziazëm në kuptimin populist, por edhe jam shumë i bindur se janë projekte dhe qëndrime të drejta për vendin tonë dhe të ardhmen euroatlantike”, ka thënë presidenti Thaçi. Duke folur për raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për dialogun, presidenti ka konfirmuar se do të respektohet plotësisht ajo rezolutë.

Në bashkëbisedë me studentët e Kolegjit UBT, presidenti Thaçi ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, por edhe për Asociacionin e komunave me shumicë serbe dhe për marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi.

Rektori Hajrizi rizgjidhet udhëheqës i Grupit të Ekspertëve të Arsimit të Lartë



Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi është rizgjedhur udhëheqës i Grupit të Ekspertëve të Arsimit të Lartë në Kosovë.

Hajrizi tha se rizgjedhja e tij në këtë post është motiv për të shtuar kontributin e tij në rritjen e cilësisë së arsimit në Kosovë.

“Në një fazë të tillë siç është Kosova, është shumë shumë e nevojshme që të kontribuojmë në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë, duke i marrë nga jashtë përvojat më të mira evropiane, prandaj për mua është nder dhe privilegj që të vazhdojë të jap kontributin tim për të përmirësuar dhe për të sjellë nga jashtë praktikatat më të mira, për të cilat ka nevojë vendi ynë”, tha ai.

Hajrizi për katër vitet e kaluara, në cilësinë e udhëheqësit të ekspertit të arsimit të lartë, ka përfaqësuar Kosovën në shumë konferenca ndërkombëtare, duke kontribuar në reformat e arsimit të lartë në Kosovë.

Krahas kësaj, ai gjithashtu është takuar me shumë ekspertë dhe përfaqësues të shumë vendeve të Evropës. UBT ka partneritet me më shumë se 250 universitete ndërkombëtare, ndërsa bashkëpunimi i vazhdueshëm, e ka bërë këtë institucion të arsimit të lartë të Kosovës, të jetë më i përkushtuar në përhapjen e dijes akademike të studentëve në Kosovë, pa u dalluar nga universitetet ndërkombëtare.

Ligjërata tematike “Çfarë të pritët nga presidenca e Trump-it”

Janusz Bugajski: SHBA nuk ka ndërruar qasje ndaj Kosovës

“Fitorja e Trump-it ka ngjallur frikë të madhe në mesin e shumicës së vendeve evropiane, për shkak të politikës së tij karshi Rusisë, por edhe përkundër kësaj, politika e jashtme amerikane nuk ka ndryshuar karshi vendeve evropiane, sidomos karshi Kosovës, të cilën po e shtyn drejt finalizimit të proceseve integruese”, vlerësoi analisti me famë botërore, njëherësh drejtor i Qendrës për Analiza të Politikës, Janusz Bugajski, gjatë ligjëratës tematike “Çfarë të pritët nga presidenca e Trump-it”, mbajtur në UBT në Prishtinë

Përkrahja e SHBA-së kundrejt vendeve evropiane, veçanërisht ndaj Kosovës, nuk është zbehur pas fitores së Donald Trump-it dhe si rrjedhojë e kësaj, SHBA po e shtyn përpara procesin e shndërrimit të FSK-së në ushtri, madje do të fillojë të bëjë më tepër presion në shtetet e Bashkimit Evropian, të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën si shtet, si dhe do të vazhdojë të jetë ndihmuese në proceset integruese të Kosovës në NATO dhe në BE.

Këtë konstatim e ka bërë analisti me famë botërore, njëherësh drejtor i Qendrës për Analiza të Politikës, Janusz Bugajski, gjatë ligjëratës tematike “Çfarë të pritët nga presidenca e Trump-it”, mbajtur në UBT në Prishtinë.

“Fitorja e Trump-it ka ngjallur frikë të madhe në mesin e shumicës së vendeve evropiane, për shkak të politikës së tij karshi Rusisë, por edhe përkundër kësaj, politika e jashtme amerikane nuk ka ndryshuar karshi vendeve evropiane, sidomos karshi Kosovës, të cilën po e shtyn drejt finalizimit të proceseve integruese”, vlerësoi Bugajski, nën arsyetimin se “një shtet mund të konsiderohet si i tillë vetëm atëherë kur bëhet me forcë ushtarake të përgatitur mirë dhe të gatshme për ta mbrojtur veten dhe kufijtë, si dhe për të dhënë kontribut edhe në NATO”.

Duke folur për politikën e jashtme amerikane, ai shtoi se nuk ka mundë-

si të ndryshohet qasja karshi vendeve në mënyrë drastike, pasi që, sipas tij, është e nevojshme që SHBA të mbaljë lidhje me vendet e tjera të botës, në mënyrë që të vazhdojë të mbetet e fuqishme.

“Në qendër të doktrinës politike të presidentit Trump është Amerika e madhe dhe e fuqishme, por Amerika nuk është e vetmja në botë, prandaj për të forcuar atë, duhet të mbahen dhe të forcohen lidhjet me vendet e tjera të botës”, theksoi Bugajski.

Tutje, ai pohoi se presidenti Trump nuk e ka humbur interesimin ndaj mbështetjes së NATO-s dhe BE-së, por sipas tij, kanë ndryshuar vetëm kërkesat e tij ndaj këtyre organizatave.

“Kritikat e Trump-it ndaj BE-së dhe në veçanti ndaj NATO-s qëndrojnë tek përqendrimi dhe mënyra e financimit të kësaj organizate, sepse vendet e Evropës paguajnë shumë më pak se sa Amerika, e në anën tjetër, ndonëse të gjitha janë të obliguara, vetëm 5 shtete e shpenzojnë 2 përqindëshin e buxhetit të tyre në këtë organizatë”, tha Bugajski, për të shtuar se “duke e ndihmuar Amerikën, secili shtet e ndihmon veten”.

Sipas tij, ashtu siç ishte pritur dhe siç kishin shpresuar Rusia dhe Serbia, SHBA nuk ka ndryshuar qëndrim ndaj tyre, edhe pas zgjedhjeve të fundit.

“Rusia është munduar që ta shkatërrojë kredibilitetin e kandidates Clinton



Përkrahja e SHBA-së kundrejt vendeve evropiane, veçanërisht ndaj Kosovës, nuk është zbehur pas fitores së Donald Trump-it dhe si rrjedhojë e kësaj, SHBA po e shtyn përpara procesin e shndërrimit të FSK-së në ushtri

dhe ta dobësojë atë, në atë mënyrë që të manipulojë më lehtë me Trump-in, por në vend të kësaj, në vend të braktisjes së NATO-s, siç shpresonte Rusia, presidenti Trumpi u kërkoi aleatëve që, vetëm të shpenzojnë më shumë në këtë aleancë, në mënyrë që së bashku t'i arrijnë qëllimet”, theksoi Bugajski.

Në fund të ligjëratës, të pranishmit shtruan pyetje mbi çështje të rëndësishme dhe aktuale, duke përfshirë të metat e udhëheqjes së presidentit Obama, karshi vendeve që po përbalen me luftë, për ndikimin e Rusisë në zhvillimet e fundit në Maqedoni, për rreziqet dhe krizat që mund t'i përbal-

lojë BE-ja, për ndikimin e Gjermanisë tek vendet e Evropës, për situatën e krijuar pas daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja etj.

Para fillimit të ligjëratës, Janusz Bugajski u prit në takim nga rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, i cili e njoftoi me punën e UBT-së, si lider, ambasador dhe përfaqësues i vendit tonë, në shumë institucione ndërkombëtare.

Në takim u diskutuan një varg planesh për bashkëpunim midis UBT-së dhe Qendrës për Analiza të Politikës, të cilën e drejton Bugajski.

Profesori i Universitetit “Staffordshire” të Britanisë së Madhe në UBT

Dr. Hasan: Zhvillimi i hovshëm teknologjik, po e ndryshon mënyrën tonë të jetesës

Profesori i Universitetit “Staffordshire”, të Britanisë së Madhe, njëherësh edhe pjesë e Institutit kërkimor brenda këtij universiteti, dr. Mohammad Hasan ka mbajtur ligjërata tematike për studentët e Fakultetit të Shkencave kompjuterike të nivelit bachelor në UBT.

Gjatë kësaj ligjërate u trajtua tema: “Shpikjet inovative në ndërveprimin në mes njeriut dhe kompjuterit”, me ç’rast për studentët u prezantuan disa nga shpikjet e fundit teknologjike, që janë rezultat i punës së përbashkët mes njerëzve dhe pajisjeve të ndryshme teknologjike, duke përfshirë makinat e mençura, robotët kontrollues të trupit, rripi që i parashikon sulmet në zemër, orët e mençura, asistentet personale digjitale, televizionet manekinet e mençura, televizorët transparentë etj., shpikje të cilat sipas dr Hasan, pritët që së shpejti ta ndryshojnë mënyrën e funksionimit të botës.

“Ne jemi dëshmitarë se teknologjia po përparon me hapa të shpejtë dhe me këtë ritëm, të gjitha gjërat abstrakte që i kemi parë nëpër filma, shumë shpejt do të bëhen realitet i jetës sonë”, vlerësoi ai.

Kjo ligjëratë është rezultat i bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë, teksa UBT po synon të zgjerojë edhe më tutje bashkëpunimin, në mënyrë që studentët të vazhdojnë studimet në Universitetin “Staffordshire”, falë bursave të ndryshme, që do të ndahen për këtë qëllim.



“Ne jemi dëshmitarë se teknologjia po përparon me hapa të shpejtë dhe me këtë ritëm, të gjitha gjërat abstrakte që i kemi parë nëpër filma, shumë shpejt do të bëhen realitet i jetës sonë”, vlerësoi dr. Mohammad Hasan

Intervistë e rektorit, prof.dr.Edmond Hajrizi

Hajrizi: Kosova kishte nevojë për dije evropiane e amerikane – e sollëm me UBT-në

“Ne kemi filluar me profesorë ndërkombëtarë dhe kemi dashur që të sjellim përvoja që ekzistojnë në botë. Ne duam që Kosova të integrohet sa më shpejtë në botë. Në mënyrë që ne të eliminojmë paragjykimet, sepse atë ndjenjë e kam përfituar vetë kur kam shkuar në Austri, kështu që 5-6 vjet kemi zhvilluar mësimin me 90 për qind të profesorëve ndërkombëtarë”, tregon Hajrizi

Rектори i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në një intervistë për “Radio Campus” rrëfen për motivin dhe arsyet e themelimit të UBT-së, këtu e 15 – vjet më parë. Si arsye të parë ai përmend vështirësitë arsimore në Kosovë, menjëherë pas përfundimit të luftës.

“Kemi filluar më 2001, kur isha kthyer nga Austria në pushim vere. Tashmë kisha përfunduar studimet e doktoratës në Austri dhe po punoja në të njëjtin universitet”, ka thënë rektori, sipas të cilit, kur është kthyer në Kosovë, ka vërejtur se ky shtet i ri ka shumë nevojë për dije, për çfarë duhej kontribuar secili.

Ai, përvojën e tij nga studimet dhe mësimdhënia në Universitetin e Vjenës e solli dhe po e zbaton në Kosovë.

Rектори Hajrizi tregon se para 15 viteve themeloi Institutin për menaxhim të Ndërmarrjeve dhe Inxhiniering (IEME), i cili u themelua si institut profesional për ofrimin e edukimit, trajnimeve, hulumtimeve dhe konsultimeve në fusha të ndryshme të biznesit dhe të teknologjisë.

“Ishim të mbyllur në komunikim të jashtëm. Kosova nuk ishte e lidhur me zhvillimet. Në atë kohë erdhi interneti, një ndryshim që neve na gjeti të papërgatitur. Mendova që mund të japë kontribut në transferim të dijes dhe të teknologjisë, që të përmirësojmë gjendjen”, vijoi rektori, me rrëfimin se menjëherë ka filluar të organizojë konferenca ndërkombëtare, që biznesmenët t’i dërgojë jashtë vendit për trajnime e shkëmbim përvojash.

Pas themelimit të Institutit filluan studimet master. Në fillim kishte vetëm 28 studentë, kurse 15 vjet pas ka rreth 20 mijë, me rritje të vazhdueshme - 3000 të regjistruar brenda vitit. UBT ka filluar punën pa ndonjë zyrë, ndërsa sot ka një infrastrukturë moderne, ajo në rritje ka vazhduar gradualisht.

UBT pas 15 viteve të punës ka 1000 punëtorë, staf administrativ dhe akademik. “Programi master ka qenë

programi për teknologji, i bazuar në programin e Vjenës dhe universitetit të OHAIOS të SHBA. Dëshirova shumë që këtë program ta sjellim në Kosovë. I tërë programi ishte në gjuhën angleze edhe profesorët ishin të huaj”, tregon rektori Hajrizi.

Ai shton se UBT ka arritur rezultate të lakmueshme në shumë fusha dhe se përveç qëllimit primar që është edukimi i kuadrove të reja, UBT ka qenë ambasadore e Kosovës jashtë vendit, duke e anëtarësuar vendin në shumë institucione ndërkombëtare, duke qenë e para në rajon.

Rектори Hajrizi u pozicionua në teknologji dhe biznes për të vetmin qëllim që të krijojë kuadro të reja me perspektivë të veçantë dhe të ndryshojë pikëpamjen për biznesin. “Dhe ne, faktikisht themelimin e bëmë në kohën kur Evropa tentonte çdoherë të themelonte institute për teknologji. Në shkollat e biznesit në universitete amerikane pashë që kishin një qasje mjaft të respektueshme, një qasje që ti do të jesh një lider i suksesshëm. Biznesi nuk duhet shikuar si diçka private, jo një interes i veçantë sa për vete. Ti duhet të punosh, të krijosh e të gjenerosh vlera. E, ai gjenerim në një ndërmarrësi me përgjegjësi quhet biznes”, thotë rektori Hajrizi.

Rектори ishte i fokusuar që në UBT të sillte më të mirën. Angazhoi më shumë se 300 profesorë dhe ekspertë nga të gjitha anët e botës. Krijoi bashkëpunim me mbi 200 universitete dhe institucione partnere me renome botërore.

“Ne kemi filluar me profesorë ndërkombëtarë dhe kemi dashur që të sjellim përvoja që ekzistojnë në botë. Ne duam që Kosova të integrohet sa më shpejtë në botë. Në mënyrë që ne të eliminojmë paragjykimet, sepse atë ndjenjë e kam përfituar vetë kur kam shkuar në Austri, kështu që 5-6 vjet kemi zhvilluar mësimin me 90 për qind të profesorëve ndërkombëtarë”, tregon Hajrizi për të shtuar

se është ndjenjë e mirë “që kemi krijuar një sistem modern të arsimit të lartë në Kosovë, që i përmbush praktikat ndërkombëtare”.

“Kosova është një vend në transicion, ku mungojnë shumë gjëra. Dhe në këtë atmosferë ne kemi krijuar diçka nga asgjë dhe kemi krijuar që brenda 15 viteve të krijojmë shembull. Përkundër ambientit të vështirë kemi arritur të ndërtojmë UBT-në. Nga një ide, nga një dëshirë për të kontribuar kemi arritur shumë”, ka vijuar Hajrizi, derisa ka shtuar se është shumë domethënëse për të rinjtë, që, nëse duan mund të angazhohen dhe të kesh suksese. UBT ka shkallë shumë të lartë të punësimit të të diplomuarve. Rектори tregon se të diplomuarit në këtë institucion e kanë gjetur shpejt veten në tregun e punës.

“Ne kemi një punësim shumë të lartë të të diplomuarve. Një element tjetër janë degët gjithëherë të reja, jo kopje, por diçka alternative. UBT është rritur falë rrjedhës që krijohet nga vetë studentët dhe stafi i tij.

Çdo vit kemi rritje të theksuar të studentëve dhe stafit. Ne i falënderojmë për besimin. Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm që duhet të punojmë, që të fitojmë kompetenca të mirëfillta tek këta studentë”, shton rektori Hajrizi, sipas të cilit UBT nuk u ikë problemeve që ka shoqëria kosovare, por mundohet t’i zgjidhë ato, në të gjitha mënyrat. “Përveç kësaj, e veçanta në këtë 15-vjetor është një qasje proaktive me problemet që ka shoqëria. Kemi ofruar mbështetje komunave në studimet e fizibilitetit për zonat ekonomike. Ne kemi bërë analiza, publikime e konsultime për t’i ndihmuar vendimmarrjeve tona, qoftë në nivel lokal, qoftë në nivel qendror. Ne kemi një kompetencë proaktiviteti institucional, që nuk është shumë i njohur në Kosovë”, ka përfunduar Hajrizi.



“Kosova është një vend në transicion, ku mungojnë shumë gjëra. Dhe në këtë atmosferë ne kemi krijuar diçka nga asgjë dhe kemi krijuar që brenda 15 viteve të krijojmë shembull. Përkundër ambientit të vështirë kemi arritur të ndërtojmë UBT-në. Nga një ide, nga një dëshirë për të kontribuar kemi arritur shumë”

Personalitete prestigjioze vizitojnë UBT-në

Ekspertët e NATO-s sqarojnë anëtarësimin e shteteve në këtë organizatë politike e ushtarake

Ekspertët e lartë të NATO-s: Giorgio Battisti, komandant i Komandës së Stërvitjes dhe Doktrinës së Ushtrisë italiane dhe Brook Smith-Windsor, përfaqësues i Kolegjit të Mbrojtjes i NATO-s qëndruan në UBT

UBT, me organizimin e tryezës më temë “NATO dhe e ardhmja e sigurisë euroatlantike”, ka mbledhur të enjten ekspertët e lartë të NATO-s: Giorgio Battisti- komandant i Komandës së Stërvitjes dhe Doktrinës së Ushtrisë italiane dhe Brook Smith-Windsor - përfaqësues i Kolegjit të Mbrojtjes i NATO-s.

Ekspertët në mënyrë të detajuar kanë përshkruar rolin e NATO-s gjithandej globit, duke sqaruar për të pranishmit rolin dhe ndikimin e saj, historikun e krijimit dhe mënyrën e funksionimit të kësaj aleance, si dhe për anëtarët dhe partneritetet që ka me shumicën e shteteve të botës.

Që në hapje, rektori i UBT-së ka falënderuar pjesëmarrësit, për të vijuar se, institucioni të cilin ai drejton, i kushton rëndësi të madhe fushës së sigurisë së përgjithshme.

“Siguria është një element thelbësor për të gjitha shtetet e botës, duke përfshirë edhe Kosovën, prandaj krahas institucioneve shtetërore, UBT po mundohet t’i jap hapësirën e merituar sigurisë shtetërore e globale, sigurisë kibernetike e marrëdhënieve ndërkombëtare”, tha rektori Hajrizi, teksa tregoi se “në UBT është themeluar Qendra për Siguri trans-atlantike, e cila do të merret me trajtimin, studimin dhe analizimin e çështjeve të sigurisë”. Presidenti i Këshillit Atlantik të Shqipërisë, Arian Starova tha se rrethanat aktuale në të cilat gjendet Kosova, “tregojnë se jemi në rrugë të mbarë për të përshpejtuar procesin e pranimit të Kosovës në NATO”.

“Rezultatet e fundit tregojnë se FSK është plotësuar dhe se është e gatshme të shndërrohet në ushtri, madje këtë e ka mbështetur edhe administrata e Amerikës”, vlerësoi Starova.

Përfaqësuesi i Kolegjit të Mbrojtjes i NATO-s, dr Brook Smith - Windsor, duke treguar për hapat që një shtet duhet ndërmarrë për t’u bërë anëtar i NATO-s, tha se pranimi në këtë aleancë nuk është destinacion, por është udhëtim sepse, sipas tij, që në momentin kur hyn, duhet të bëhesh bashkë me vendet e tjera, për të luftuar dhe për të kërkuar zgjidhje për problemet e fushës së sigurisë.

“Është qenësore që para aplikimit për anëtarësim në NATO, secili shtet të rregullojë sigurinë e vet të brendshme, të jetë shtet i sigurt e stabil dhe në gjendje për të menduar më pas për sfida më komplekse, të shënjojë kufijtë dhe të ketë raport të mirë me shtetet fqinje”, theksoi Smith- Windsor, teksa tregoi mënyrën e funksionimit të kësaj aleance.

“Përfitimi nga pranimi i një vendi në NATO, nuk është i njëanshëm. Secili shtet duhet të marrë, por dhe të kontribuojë në aspektin e sigurisë së përgjithshme globale, prandaj edhe reagimi është i përbashkët, sepse brenda aleancës, të sulmohet një shtet, është njësoj sikur t’i sulmohet të gjitha njëherësh.”.

Tutje, Smith- Windsor shpjegoi disa prej ideve të gabuara, të cilat shtetet dhe popujt e ndryshëm i kanë krijuar karshi NATO-s.

“Brenda popujve të ndryshëm janë krijuar disa ide dhe koncepte të gabuara për mënyrën e funksionimit, organizimit dhe veprimit brenda aleancës euroatlantike”, theksoi ai, teksa numëroi disa prej tyre.

“NATO nuk është vetëm aleancë ushtarake, por edhe politike dhe si e tillë, as SHBA dhe as ndonjë vend tjetër nuk dominon mbi anëtarët e tjerë sepse çdo vendim merret me miratimin e të gjitha shteteve përbërëse. Përveç kësaj, NATO nuk është në shërbim të asnjë feje dhe nuk punon kundër myslimanëve, si dhe nuk është garuese me BE-në e as kundërshtar e Rusisë”, tha Smith- Windsor.

Komandant i Komandës së Stërvitjes dhe doktrinës së Ushtrisë italiane, Giorgio Battisti tha se në përbërjen e vet, NATO ka një shumëllojshmëri popujsh, kulturash,



Përfaqësuesi i Kolegjit të Mbrojtjes i NATO-s, dr Brook Smith - Windsor, duke treguar për hapat që një shtet duhet ndërmarrë për t’u bërë anëtar i NATO-s, tha se pranimi në këtë aleancë nuk është destinacion, por është udhëtim sepse, sipas tij, që në momentin kur hyn, duhet të bëhesh bashkë me vendet e tjera, për të luftuar dhe për të kërkuar zgjidhje për problemet e fushës së sigurisë.

traditash, gjuhësh, gjinish, uniformash e pikëpamjesh, por sipas tij, asnjëra prej tyre nuk përbën dobësi dhe vetëm sa e shton vlerën e kësaj aleance.

“Në qendrën e interesit të NATO-s janë njerëzit dhe më pas teknologjia dhe të gjitha mjetet janë nën shfrytëzimin e tyre, ndonëse të ndryshëm, kjo organizatë është unike dhe nuk ka asnjë problem të llojit etnik, gjuhësor apo gjinor”, vlerësoi Battisti, i cili duke folur për mënyrën e marrjes së vendimeve, shtoi se “secili vend e ka peshën e njëjtë në marrjen e vendimeve, pra brenda aleancës, të gjitha vendet duhet të jenë të barabarta”.

Sipas gjeneralit Battisti, një rol të madh në funksionimin dhe koordinimin e NATO-s, e luajnë edhe partnerët e jashtëm, të cilët sipas tij, janë mbështetës dhe kontribuues të mëdhenj në ruajtjen e sigurisë dhe paqes.

“NATO nuk është vetëm përbërje e 28 shteteve të ndryshme, por është rrjet i madh i partneritetit mes vendeve të ndryshme të botës”, tha ai, për të shtuar se, Mali i Zi është pothuajse në përfundim të procedurave për t’u bërë aleati më i ri i kësaj aleance.

Komandanti i Komandës së Stërvitjes në FSK, Enver Cikaqi vlerësoi se Kosova është në një pikë të rëndësishme, sa i përket zhvillimeve të brendshme, në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare.

“Kosova dhe veçanërisht ne si FSK, kemi bashkëpunuar ngushtë me NATO-n dhe të gjithë bashkëpunëtorët tanë,

për të krijuar të gjitha kushtet për ngritjen e kapaciteteve tona”, tha ai, teksa vlerësoi lart kontributin e aleancës euroatlantike në këtë aspekt.

“FSK ka punuar ngushtë me NATO-n dhe jemi duke pritur të bëjmë ndryshimet kushtetuese për të shndërruar forcat tona të armatosura në ushtri, pasi që këto vlerësime kanë ardhur edhe nga partnerët tanë strategjikë”.

Tutje, ai sqaroi se FSK ka ndërtuar një sistem të mirë, bazuar në standardet e NATO-s, mbi edukimin dhe shkollimin, e që sipas tij, këto vlera e kanë bërë institucionin më të besueshëm në vend.

Profesori Nusret Pillana, duke folur për rëndësinë e ndërhyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, përmes një kumtese tregoi se përfshirja e kësaj aleance në luftën e Kosovës, kishte karakter humanitar.

“Ndërhyrja e forcave euroatlantike bëri që qytetarët e Kosovës të shpëtonin nga shfarosja etnike, të cilën e kishte planifikuar Serbia dhe kjo fushatë ishte kundërpërgjigje kundër zhdukjes së njërit prej popujve më të vjetër dhe më liridashës të Ballkanit”, vlerësoi ai.

Në fund të këtij organizimi, referuesit u përgjigjën në pyetjet e të pranishmëve, që kryesisht kishin të bënin me rëndësinë e ndërhyrjes së forcave të NATO-s, për mbrojtjen e popujve të vegjël, pastaj për ndikimin e Amerikës në këtë aleancë, për marrëdhëniet me Rusinë dhe kërcënimin që vjen prej saj, për problemet dhe përballjen me sulmet kibernetike etj.

Në 15-vjetorin e punës

UBT për 15 vjet ekzistimi e kishte në fokus Kosovën

“Gjatë këtyre 15 viteve, nuk kemi pasur asnjë koncentrim tjetër, përpos Kosovës dhe dëshirës së madhe për të qenë kontribuues në zhvillimin e vendit tonë”, tha rektori Hajrizi



“UBT aktualisht numëron rreth 10 000 studentë aktivë, mbi 1000 njerëz, që si pjesë e stafit akademik, e kanë dhënë kontributin e tyre në rritjen e zhvillimin e këtij institucioni, si dhe mbi 250 marrëveshje me universitete dhe organizata ndërkombëtare. E tërë kjo punë e përbashkët ka bërë që 98% e të diplomuarve ta gjejnë veten në tregun e punës”.

Misioni dhe fokusi 15 vjeçar i UBT-së ka qenë Kosova, si në aspektin e plotësimit të nevojave dhe zbrazësive që e kanë lënë universitetet publike në fushën e edukimit e arsimit, ashtu edhe në përmbushjen e nevojave të industrisë dhe të tregut kosovar të punës. Ky konstatim ka dalë nga vetë themeluesi i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, në ceremoninë festive për nder të 15-vjetorit të themelimit të UBT-së, si dhe festave të fundvitit, të enjten.

“Gjatë këtyre 15 viteve, nuk kemi pasur asnjë koncentrim tjetër, përpos Kosovës dhe dëshirës së madhe për të qenë kontribuues në zhvillimin e vendit tonë”, ka vijuar rektori Hajrizi. Duke folur për historikun e zhvillimit të UBT-së, ai tha se rrugëtimi drejt themelimit ka qenë i mbushur me vështirësi, sfida dhe suksese të vazhdueshme.

“Rruga jonë ka qenë e vështirë, sepse kemi nisur nga hiçi dhe kemi arritur që me sukses të rritemi dhe të zhvillohemi shëndetshëm, duke i mbledhur të mirat e arsimit botëror dhe duke i implementuar ato në institucionin tonë”, theksoi Hajrizi, për të shtuar se, “falë punës dhe angazhimit të vazhdueshëm, UBT është shndërruar në institucionin e parë arsimor në Ballkanin Perëndimor, që ka arritur nivelin e

ekselencës”.

Tutje, rektori përmendi edhe sukseset e njëpasnjëshme të UBT-së, që nga koha e themelimit e deri më sot.

“UBT aktualisht numëron rreth 10 000 studentë aktivë, mbi 1000 njerëz, që si pjesë e stafit akademik, e kanë dhënë kontributin e tyre në rritjen e zhvillimin e këtij institucioni, si dhe mbi 250 marrëveshje me universitete dhe organizata ndërkombëtare”, potencoi Hajrizi, me ç’rast sipas tij, “e tërë kjo punë e përbashkët ka bërë që 98% e të diplomuarve ta gjejnë veten në tregun e punës”.

Për kontributin e dhënë në ngritjen e një institucioni të vlerësuar lart ndërkombëtarisht, stafi akademik i UBT-së, në shenjë falënderimi, ndau mirënjohje për rektorin Hajrizi. Ndërkaq, fill pas kësaj, rektori i nderoi me mirënjohje disa nga pjesëtarët e parë të stafit akademik, të cilët ndikuan në rritjen dhe ngritjen e cilësisë së UBT-së.

Duke folur për mirënjohjen e marrë, menaxheri i zyrës së financave në UBT, Selmon Berisha tha se njohja me rektorin Hajrizi dhe punësimi në UBT, ka bërë që jeta e tij të ndryshojë rrënjësisht.

“Jam shumë me fat që kam pasur mundësinë të jem pjesë e UBT-së dhe të japë kontributin tim në zhvillimin e këtij institucioni prestigjioz”, përfundoi Berisha.

Ceremonia u përmbyll me një koktej rasti, organizuar me qëllim të argëtimit të stafit akademik dhe të ftuarve të tjerë në këtë ngjarje, teksa të gjithë të pranishmit u shpërblyen me dhurata modeste.

Edhe një sukses ndërkombëtar i UBT-së

Kosova triumfon në Garën për Siguri kibernetike në Çeki

E përfaqësuar nga UBT-CERT, prof. dr Edmond Hajrizi, Atthe Buja, Betim Gashi dhe Rexhep Berlajolli, Kosova ka triumfuar në Garën e Sigurisë kibernetike, të organizuar nga Agjencia Kombëtare për Siguri e Çekisë dhe Universiteti “Masaryk”, përkrahur edhe nga programi “TAIEX”, i Komisionit Evropian.

Gara kishte të bënte me mbrojtjen e infrastrukturës së simuluar kritike dhe me funksionimin normal të rrjetit hekurudhor në vendin X, me ç’rast në të njëjtën kohë, në mënyrë krejtësisht sekrete, ekipi sulmues “Red team”, me çdo kusht dhe mundësi tentonte ta largonte nga funksioni çdo shërbim, sistem e aplikacion, nga përdorimi online, si dhe ta marrë nën kontroll infrastrukturën, gjë të

cilën nuk ka arritur ta bëjë përgjatë gjashtë orëve, sa edhe ka zgjatur gara.

Në këtë garë, pjesëmarrës ishin të gjitha vendet e rajonit dhe Ballkanit, por rezultate më të larta arritën UBT-CERT nga Kosova, ALCIRT nga Shqipëria dhe MKD-CIRT nga Maqedonia, të cilët, me anë të bashkëpunimit dhe punës ekipore, u treguan shumë profesionalë dhe të përgatitur për mbrojtje ndaj sulmeve kibernetike, ndonëse gara nuk kishte për qëllim të identifikonte fitues.

Në fund të këtij aktiviteti, pjesëmarrësit u shpërblyen me certifikata nga NSA-ja çeke, për punën, profesionalizmin dhe angazhimin e treguar gjatë garës.



Flet Mentor Geci, koordinator i Qendrës së Kompetencës për Statistika, Analiza dhe Parashikim

UBT STATS, burim i rëndësishëm i statistikave në Kosovë

“Qëllimi i UBT STATS është të krijojë një bazë statistikore të të dhënave, për të ofruar informata statistikore të strukturuar dhe të krahasueshme në kohë, të cilat do të mund t’i referohen këtyre të të dhënave si burime të referencës, të organizuara në formë të qartë dhe lehtë të kuptueshme”, tha Geci

Statistikat janë burim i domosdoshëm informacioni për vendimmarrje , për këtë qëllim, në UBT funksionon Qendra e Kompetencës për Statistika, Analiza dhe Parashikim, e themeluar me qëllim të krijimit të bazës së të dhënave statistikore.

Duke treguar për arsyet e krijimit të qendre të tillë, koordinatori i UBT STATS, Mentor Geci tha se kjo qendër lindi si nevojë e pasjes së një baze të të dhënave, konsistent me praktikat statistikore ndërkombëtare, lehtësisht të konvertueshme për analiza kuantitative, ekonomike dhe për parashikime, por edhe me qëllim të krijimit të serive kohore.

“Qëllimi i UBT STATS është të krijojë një bazë statistikore të të dhënave, për të ofruar informata statistikore të strukturuar dhe të krahasueshme në kohë, të cilat do të mund t’i referohen këtyre të të dhënave si burime të referencës, të organizuara në formë të qartë dhe lehtë të kuptueshme”, tha Geci, duke shtuar se, “në UBT STATS realizohet përpunimi

i të dhënave statistikore, si nga burimet e institucioneve të tjera, po ashtu edhe nga burimet vetanake të UBT-së”.

Burim i informatave lidhur me UBT STATS, sipas tij, janë institucionet publike në Kosovë.

“Në kontekst sektorial, deri më tani janë përpunuar statistikat e llogarive kombëtare, statistikat e llogarive qeveritare, anketa e fuqisë punëtore, anketa strukturore e ndërmarrjeve, indeksi i çmimeve të konsumit, indeksi i çmimeve të importit, indeksi i çmimeve të prodhimit, statistikat e energjisë, hotelerisë, arsimit, si dhe statistikat e shëndetësisë”, tregoi Geci, i cili duke folur për punën e tanishme të kësaj qendre tha se, së fundmi është filluar edhe me përpunimin e statistikave në nivel individual, të institucioneve individuale.

“Tashmë është kryer sektori i telekomunikacionit që përfshin PKT-në, IPKO-n dhe Z-Mobile dhe jemi në fazën finale të validimit të statistikave të sektorit të sigurimeve që përfshin statistikat në nivel kompanive individuale”, tha ai, për të shtuar se “së shpejti do të finalizohet edhe do të pub-

likohet sektori i bankave, i detajuar në nivel të çdo banke”.

Tutje, koordinatori Geci u shpreh se statistikat e prodhuara nga kjo qendër janë krijuar me ndihmën e studentëve të dalluar të UBT-së.

“UBT STATS është mundësi e shkëlqyeshme e kryerjes së praktikës (internship) për studentë, por marrë parasysh specifikat e punës në UBT STATS, kusht kyç i angazhimit të studentëve është që ata të jenë të dalluar në lëndët kuantitative”.

Përveç angazhimit në aspektin e kryerjes së praktikës, studentët e UBT-së kanë mundësi të përdorin statistikat e përpiluara nga UBT STATS në punimet e tyre hulumtuese. Gjatë këtij viti UBT STATS synon që të zhvillojë module të reja, vazhdimin e publikimeve të rregullta, përfshirjen e hulumtimeve të bëra nga konferencat dhe studentët, lidhur me temat e caktuara, përditësimin periodik të moduleve ekzistuese, promovimin e shërbimeve të UBT STATS etj.

UBT lider në shumë fusha studimi

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, lider rajonal për teknologji informative

“Në UBT ndodhet numri më i madh i studentëve të interesuar për studime në fushën e teknologjisë informative dhe kjo rritje ka ardhur gradualisht, falë angazhimit të stafit profesional, si dhe përkushtimit e talentit të studentëve tanë”

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, çdo vit tërheq qindra të rinj, të pasionuar pas shkencës dhe inovacionit, duke u bërë kështu shkolla më e madhe e teknologjisë informative në rajon, falë ofrimit të kushteve dhe nivelit të profesorëve të këtij drejtimi.

Menaxheri i Programit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë (SHKI), njëherësh ligjërues në këtë fakultet, Blerton Abazi tha se fakulteti është lider në rajon për mësimin që ofron, si dhe për punësimin e studentëve, të cilët dalin të diplomuar nga ky drejtim.

“Në UBT ndodhet numri më i madh i studentëve të interesuar për studime në fushën e teknologjisë informative dhe kjo rritje ka ardhur gradualisht, falë angazhimit të stafit profesional, si dhe përkushtimit e talentit të studentëve tanë”, vlerësoi Abazi, për të shtuar se “e tërë kjo punë shpërblehet kur produktet tona sistemohen dhe japin kontribut në vendet e tyre të punës”.

Duke folur për mënyrën e funksionimit të këtij drejtimi, ai tregoi se këtë fakultet e bënë të veçantë niveli i profesorëve dhe ndërlidhja e metodave më të reja të edukimit dhe aplikimit të industrisë.

“Fakulteti i Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë e veçon fakti se kemi stafin akademik më cilësor, të cilët u dhurojnë studentëve përvojën e tyre të marrë nga industria, por mbi të gjitha, në këtë dre-

jtim ndërlidhet industria dhe edukimi, me ç’rast studentët marrin njohuri nga trendët e fundit të zhvillimit të teknologjisë, përmes vizitave studimore në terren”, tha Abazi.

Duke qenë se UBT i kushton rëndësi të madhe aspektit të zhvillimit teknologjik, menaxheri Abazi theksoi se ky institucion është ihtar i të qenit në hap me kohën dhe me trendët ndërkombëtarë të zhvillimit teknologjik.

“Labororët e UBT-së janë të pajisur me mjetet më të sofistikuar të kohës, që mundësojnë kryerjen e ushtrimeve praktike më cilësi të lartë dhe të cilat, më pas aplikohen edhe në ambientet e punës nga studentët tanë, gjë që i shtyn studentët tanë ta duan edhe më tepër këtë profesion”, tha ai, për të shtuar se të rinjtë e interesuar për këtë fushë, janë inkurajuar nga organizimet dhe të arriturat e këtij drejtimi.

“Mbi 90% e të diplomuarve në këtë drejtim janë sistemuar menjëherë nëpër vende të punës, kurse mbi 1500 të rinj, aktualisht janë duke i ndjekur studimet, sepse sukseset e studentëve tanë kanë qenë pasqyrimi më i mirë i punës sonë përgjatë këtyre viteve të ekzistimit”.

Krahas ofrimit të studimeve në një nivel të lartë akademik, pjesë e SHKI-së janë edhe disa akademi dhe qendra mbështetëse.

“Në kuadër të Fakultetit të SHKI-së funksionon Qendra për Zhvillim Softuerik, si



“Zhvillimi i hovshëm ndërlidhet edhe me krijimin e bashkëpunimit me partnerë të shumtë akademik, duke përfshirë Cisco-n, Comptia, Android ATC, Microsoft, C++ Institute, ECDL, SAP etj.”

dhe Akademia Ekzekutive për Zhvillim Profesional e UBT-së, si pjesë e të cilave studentët tanë marrin mbi 198 certifikime ndërkombëtare në fushën e teknologjisë informative dhe të komunikimit”, tregoi Abazi, për të shtuar se “zhvillimi i hovshëm ndërlidhet edhe me krijimin e bash-

këpunimit me partnerë të shumtë akademik, duke përfshirë Cisco-n, Comptia, Android ATC, Microsoft, C++ Institute, ECDL, SAP etj”.

Sipas Abazit, suksesi i studentëve të këtij drejtimi është treguesi më i mirë për nivelin dhe seriozitetin e UBT-së.

Suksesi i studentit të SHKI

Tema master e studentit të UBT-së, Exhevit Ymeri, zbatohet edhe në praktikë



Studenti i Shkencave Kompjuterike në UBT, Exhevit Ymeri, ka mbrojtur titullin master, tema: “Sinkronizimi dhe disponueshmëria e lartë e të dhënave duke përdorë teknologjinë: SQL Server 2012 Always ON”. Tema është mbrojtur para Komisionit: prof.dr Zhibert Tafa, prof. dr. Bertan Karahoda dhe prof. dr. Ramiz Hoxha, ndërsa atë e përcollën studentët, profesorët, prindërit e të interesuar të tjerë.

Punimi i Ymerit është paksa më i veçantë, pasi që ka gjetur sistemim në praktikë. Si punim, tashmë është implementuar nëpër

institucione të ndryshme ndërkombëtare në Kosovë.

Kjo për faktin se me këtë temë trajtohet eliminimi i ndërprerjeve të komunikimit të softuerit apo aplikacioneve të ndryshme gjatë përdorimit.

Sipas Ymerit, shfrytëzuesit, si rezultat i këtij hulumtimi, nuk e hetojnë ndërprerjen e energjisë, gjë kjo që ndihmon shumë që aplikacionet të mos ndalen si rezultat i bllokimeve të sistemit, të rrymës, të ngarkesave apo prishjeve kompjuerike.

Plani i prezantuar në kuadër të lëndës Menaxhimi Strategjik dhe Ndërmarrësia

Studentja Arta Rustemi implementon biznes-planin

“Ngritja e pemishtes së re me mollë”

Ka filluar të implementohet biznes-planin “Ngritja e pemishtes së re me mollë”, projekt ky i cili është punuar nga studentja e UBT-së në vitin e tretë në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Arta Rustemi. Ky projekt përmban të gjitha planet operacionale për hapjen e një biznesi të ri dhe fillimisht si plan është prezantuar në kuadër të lëndës Menaxhimi Strategjik dhe Ndërmarrësia.

Grandin e projektit, studentja e UBT-së, Arta Rustemi e ka fituar nga Ministria e Bujqësisë në Kosovë dhe bëhet fjalë për riparim të pemishtes dy hektarë, si dhe krijimin e një pemishteje të re prej katër hektarësh.

Sipas saj, projekti do të zhvillohet në fshatin Prapashticë të komunës së Prishtinës dhe ka për synim rritjen dhe shitjen e produktit vendor.

“Me mjetet si sistemin solar edhe mjetet të caktuara të ujitjes, do të punojmë sipas “Lean Management”, që e parasheh kursimin e ujit dhe kostove pa ulur cilësinë e produktit”, tha Rustemi, e cila shtoi se falë mundësive të ofruara nga UBT dhe



Ministria e Bujqësisë, zbatimi i planit po ecë mirë.

Për zbatimin e këtij projekti, vëmendje të veçantë i kanë kushtuar edhe mediat zvicerane, që cilat kanë konsideruar që në Kosovë po hapen biznese të reja nga studentë të suksesshëm. Madje, sipas gazetës “20 minuten”, këto biznes-plane janë të modelit zviceran.

Ndërkohë, studentja Arta Rustemi është fituese edhe e bursës së programit “Erasmus Mundus”, përmes së cilës ka vijuar studimet për dy semestra në Berlin të Gjermanisë.

UBT është përkushtuar në zhvillimin e programeve akademike, të cilat janë kombinuar me hulumtime shkencore të kualitetit të lartë dhe në harmoni me standarde ndërkombëtare

Çmimi vjetor i UBT-së

UBT e nderon me Çmimin “Excellence Lidership Award”, Driton Kuka

“Ky çmim i ndarë nga UBT për mua, në mesin e shumë mirënjohjeve dhe titujve evropianë, është specifik, sepse po dhurohet nga një tempull i dijes, që gëzon kredibilitet të lartë në vend, por edhe sepse është dhuruar nga njerëz që e vlerësojnë punën e atyre që e meritojnë”, vlerësoi Kuka

Çmimi më i lartë i UBT-së “Excellence Lidership Award”, sivjet i është dhënë selektorit të reprezentacionit të xhudos së Kosovës, Driton Kuka.

Atë ia ka dhënë rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, sipas të cilit UBT në vazhdimësi i vlerëson atributet e njerëzve dhe i promovon ata si vlerë dhe si shembull që duhet ndjekur.

Kuka u nderua për kontributin e dhënë në përfaqësimin, njohjen dhe sukseset e sportit të xhudos në arenën ndërkombëtare.

“Çmimi i zhvilluar nga UBT nderon dhe shpërblen personalitetet, të cilët përmes punës dhe përpjekjeve të tyre, shndërrohen në shembuj dhe modele për të rinjtë”, theksoi Hajrizi, teksa jepte çmimin.

Duke e falënderuar UBT-në për vlerësimin, Driton Kuka tha se ky Çmim është i një rëndësie të veçantë për faktin se sipas tij, ky institucion është një tempull i dijes, që gëzon reputacion ndër qytetarë.

“Ky çmim i ndarë nga UBT për mua, në mesin e shumë mirënjohjeve dhe titujve evropianë, është specifik, sepse po dhurohet nga një tempull i dijes, që gëzon kredibilitet të lartë në vend, por edhe sepse është

dhuruar nga njerëz që e vlerësojnë punën e atyre që e meritojnë”, vlerësoi Kuka.

Gjatë kësaj ceremonie, UBT ndau bursa dhe i shpërbleu me mirënjohje mbi 100 studentë të dalluar të këtij institucioni, të cilët kanë arritur nota të larta me punë dhe angazhim të vazhdueshëm.

“Ne jemi krenarë me atë që studentët tanë po arrijnë, e në veçanti me studentët e dalluar”, tha rektori, i cili duke shpjeguar qëllimin e bursave, shtoi se përmes bursave “po mundohemi t’i motivojmë, t’i ndihmojmë në aspektin financiar, por edhe t’i promovojmë studentët tanë të dalluar”, përfundoi ai.

Në fund të këtij organizimi, u promovua edhe monografia e 15-vjetorit të themelimit të UBT-së, si përmbledhje e punës dhe të arriturve të këtij institucioni gjatë kësaj periudhe kohore.

“Përmes këtij libri kemi menduar të prezantojmë angazhimin, faktet, zhvillimin dhe ndikimin e UBT-së në zhvillimin dhe njohjen e Kosovës në arenën ndërkombëtare”, theksoi Hajrizi, teksa e prezantoi librin për të pranishmit.



Për nder të Ditës së Pavarësisë

UBT u dhuron bursa mbi 100 studentëve



UBT-ja, si institucion i arsimit të lartë privat në Kosovë, ka vendosur që përvjetorin e nëntë të shpalljes së pavarësisë ta shënojë duke ndihmuar studentët me bursa dhe duke nderuar personalitetet më të shquara të vendit.

Kështu, për nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, mbi 100 studentë të UBT-së u shpërblyen me 20 % zbritje për vitin akademik 2016/2017.

Studentët u vlerësuan në bazë të notës mesatare, kryerjes së provimeve në afat të rregullt, aktiviteteve studentore e të komunitetit, disiplinës, moralit të lartë akademik e shkencor etj.

Rrektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi theksoi se ndarja e bursave për studentë të dalluar tani më është bërë traditë në UBT, por tani shpallja e studentëve të dalluar do të bëhet tradicionale, saktësisht për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Ai shton se qëllimi i shpalljes së studentëve të dalluar është motivimi i tyre.

“Motivimi i studentëve për të vazhduar me suksesin e shkëlqyer, si dhe dhënia e kontributit në krijimin e gjeneratave të reja kontribuon edhe në përmirësimin e jetesës së qytetarëve në Kosovë në përgjithësi, por edhe cilësisë në studime në veçanti”, tha rektori Hajrizi.


Me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës

UBT ndihmon në zbukurimin e bulevardit “Bill Klinton”

Rrektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se qëllimi i institucionit të cilin ai e drejton, është që të nderoj dhe të kujtoj kontributin e njerëzve dhe shteteve që ndikuan në pavarësimin e Kosovës.

“Krahas ndihmës së ofruar në përgatitjen profesionale të gjeneratave të reja, që potencialisht janë e ardhmja e vendit tonë dhe anëtarësimi i Kosovës në shumë organizata ndërkombëtare, synim i vazhdueshëm për ne është kujtimi dhe nderimi i të gjitha figurave dhe shteteve, që sollën frymën e lirisë në vendin tonë”, tha Hajrizi, duke përmendur kontributin e madh dhe të pazëvendësueshëm të SHBA-ve.

“Falë mbështetjes së SHBA-ve, ne e kemi fituar pavarësinë dhe e njëjta po vazhdon edhe sot, kur ne po e ndërtojmë shtetin tonë”, përfundoi Hajrizi.



“Falë mbështetjes së SHBA-ve, ne e kemi fituar pavarësinë dhe e njëjta po vazhdon edhe sot, kur ne po e ndërtojmë shtetin tonë”, tha rektori Hajrizi

Grupi Iniciativ Alpbach Kosova

“IG Alpbach Kosovo” njoftoi studentët për mundësinë e fitimit të bursave

Udhëheqësi i kësaj organizate, Shkumbin Asllani tha se qëllimi i forumit “Alpbach” është që të mbledhë të rinj entuziastë dhe inovativë nga vende të ndryshme të botës, për të ndarë mes vete ide, qëllime, eksperiencë dhe probleme të ndryshme, me të cilat përballen shtetet prej nga vijnë

Organizata “IG Alpbach Kosovo” (Grupi Iniciativ Alpbach Kosova), të hënën mbajti sesion informues për studentët e UBT-së, me qëllim të informimit dhe të njoftimit të tyre me mundësitë e përfitimit të bursave, për pjesëmarrje në Forumin Evropian “Alpbach”, që do të mbahet më 16 gusht - 1 shtator, në Austri.

Udhëheqësi i kësaj organizate, Shkumbin Asllani tha se qëllimi i forumit “Alpbach” është që të mbledhë të rinj entuziastë dhe inovativë nga vende të ndryshme të botës, për të ndarë mes vete ide, qëllime, eksperiencë dhe probleme të ndryshme, me të cilat përballen shtetet prej nga vijnë.

“Pjesëmarrja në këtë forum është mundësi e mirë për të rinjtë, të cilët duan të kontribuojnë në shoqëri dhe të jenë pjesë aktive e saj, është vend për adresimin e ideve dhe problemeve, me të cilat përballen vendet e ndryshme të botës, por edhe të marrin dhe të ndajnë përvoja me njerëz të ndryshëm nga e tërë bota”, theksoi ai.

Tutje, Asllani i informoi studentët për mënyrën e aplikimit, si dhe për kushtet që duhet plotësuar për përfitimin e bursave, që i ndanë organizata, të cilën ai e udhëheq.

“Dërgimi i CV-së, letra motivuese, përzgjedhja e seminareve, në të cilat dëshironi të merrni pjesë, pastaj transkripta e notave, njohuri të gjuhës angleze dhe plotësimi i formularit për aplikim, janë kushtet që duhet t’i përmbushë secili student, që dëshiron të jetë përfitues i bursës”, tregoi ai, teksa shtoi se ky organizim është epiqendër e diskutimeve dhe investimeve të Bashkimit Evropian.

Forumi Evropian “Alpbach”, çdo vit mbledh mbi 5000 të rinj dhe njerëz me ndikim, duke përfshirë, politi-



UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me organizatën “IG Alpbach Kosova”, pjesë e rrjetit të organizatave të Forumit Evropian “Alpbach”, teksa në vitin e kaluar, këtë bursë e kanë fituar 3 studente të UBT-së

kanë, udhëheqës, gjyqtarë etj., nga më shumë se 50 vende të ndryshme të botës, teksa tema e diskutimit do të jetë “Konflikti dhe bashkëpunimi”, kurse për studentët që duan të jenë pjesë, ndahen rreth 700 bursa për pjesëmarrje.

UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me organizatën “IG Alpbach Kosova”, pjesë e rrjetit të organizatave të Forumit Evropian “Alpbach”, teksa në vitin e kaluar, këtë bursë e kanë fituar 3 studente të UBT-së.

Kujdesi për studentët në UBT

Zyra për Çështje Studentore lehtëson shërbimet për studentët

“Sektori ynë është themeluar tash e 15 vjet dhe është rritur së bashku me UBT-në. Ka filluar me një person, kurse tash jemi gjithsej 17 persona, duke i përfshirë edhe ata që funksionojnë dhe punojnë nëpër degët e UBT-së në qytetet e tjera”, tha Menaxheri i ZQS-së në UBT, Murat Retkoceri



“Këtë vit kemi lansuar modulën e profesorëve për shkarkime të procesverbaleve dhe për vendosjen e notave, gjatë një periudhe kohore, të caktuar nga Zyra për Çështje studentore, proces ky që krijon lehtësi për profesorët, sa i përket mënyrës së vlerësimit”

Me qëllim të përkrahjes, ofrimit të ndihmës dhe orientimit të studentëve, në UBT është themeluar Zyra për Çështje Studentore dhe IT, në mënyrë që studentët të

jenë të përkrahur gjatë tërë procesit të studimeve në këtë institucion.

Menaxheri i ZQS-së në UBT, Murat Retkoceri vlerësoi se pasuria më e madhe janë studentët, prandaj sipas tij, UBT po mundohet vazhdimisht të krijojë lehtësi për ta. “Qëllimi ynë është që t’i përkrahim dhe t’i ndihmojmë studentët tanë gjatë tërë procesit të studimeve, por edhe pas tyre”, tha ai, teksa përmendi fazat nëpër të cilat kalon puna e kësaj zyre.

“Puna jonë ndahet në tri faza, të cilat përfshijnë periudhën e regjistrimit të të rinjve, pastaj është faza e kryerjes së punëve gjatë vijimit të ligjëratave, si dhe ajo që kryhet gjatë procesit të diplomimit”.

Duke treguar për historikun e themelimit të kësaj zyre, Retkoceri theksoi se puna filloi me një njeri të vetëm, teksa sipas tij, me rritjen e numrit të studentëve, u shtua edhe nevoja për të rritur stafin administrativ.

“Sektori ynë është themeluar tash e 15 vjet dhe është rritur së bashku me UBT-në. Ka filluar me një person, kurse tash jemi gjithsej 17 persona, duke i përfshirë edhe ata që funksionojnë dhe punojnë nëpër degët e UBT-së në qytetet e tjera”, tha ai.

Me rritjen e numrit të studentëve, është ngritur edhe nevoja për evoluimin dhe gjenerimin e punëve që kryhen në kuadër të ZQS-së, si rezultat i kësaj, Retkoceri vlerësoi se UBT ka shënuar progres të madh në përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen studentëve.

“Suksesi më i madh i UBT-së është se studentët nuk kanë nevojë të presin në radhë për dokumente, por u ofrojmë

shërbime të menjëhershme, me ç’rast në këtë aspekt janë përmirësuar edhe platformat elektronike SMIS dhe Moodle, ku studentët i paraqesin provimet dhe e pranojnë vlerësimin e punës së tyre nga distanca, përkatësisht ata pajisjen me material akademik, të nevojshëm në lëndët përkatëse”, tregoi ai, duke shtuar se ky proces i ndryshimit të funksionimit, po u shërben për të mirë edhe profesorëve.

“Këtë vit kemi lansuar modulën e profesorëve për shkarkime të procesverbaleve dhe për vendosjen e notave, gjatë një periudhe kohore, të caktuar nga Zyra për Çështje studentore, proces ky që krijon lehtësi për profesorët, sa i përket mënyrës së vlerësimit”.

Zyra për Çështje Studentore dhe IT e UBT-së, sivjet ka shënuar 15 vjetorin e funksionimit, teksa në kuadër të saj ofrohen shërbime që kanë të bëjnë me informimin e studentëve me drejtimet e UBT-së, me mundësitë që ofrohen në to, pastaj merren me pajisjen e studentëve me ID kartela, me njoftimet për orarin e mësimin, bëjnë hapjen e afatit të provimeve në sistem, njoftimin e studentëve për afatin dhe datat e provimeve, pajisjen e studentëve me dokumente të ndryshme, në varësi të kërkesave të tyre, pastaj me pranimin e kërkesave të studentëve për mbrojtjen e temave të diplomës, si dhe me krijimin e formularit mbi përshtypjet e studentëve për UBT-në, marrjen e informatave prej ish-studentëve, lidhur me sistemin e tyre nëpër vende të punës etj.

Atdhe Buja, drejtues i UBT-CERT

UBT lider në fushën e sigurisë kibernetike

Suksesi i fundit i studentëve të UBT-së, vendi i parë në garën ndërkombëtare të zhvilluar në Çeki, me ftesë nga programi “TAIEX” i BE-së

Alumni: Keni realizuar shumë projekte, falë të cilave edhe jeni shpërblyer edhe me çmime ndërkombëtare. Aktiviteti i fundit ishte në Çeki, prej ku u kthyet me një çmim të rëndësishëm. Çka do të thotë kjo për ju?

Buja: Aktiviteti i fundit në të cilin morëm pjesë ishte falë një ftese që na u bë nga programi “TAIEX”, i BE-së. Ata ishin financuesit kryesorë të projektit, ndërkaq ishim të ftuar edhe nga Agjencia Kombëtare për Siguri e Çekisë (NSA), me ç’rast morëm pjesë si ekip nga UBT-CERT. Në këtë garë morën pjesë shtete nga tërë rajoni, duke përfshirë Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë, Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinën etj.

Alumni: Cili ishte rezultati që e arritët në këtë garë?

Buja: Rezultatet e kësaj gare na kanë renditur në krye të kësaj liste, kurse pas nesh ka qenë Shqipëria, Maqedonia dhe të tjerat me radhë.

Alumni: Sipas mendimit tuaj, çka e bëri diferencën?

Buja: Aty ka qenë një tabelë, e cila i ka prezantuar rezultatet e pikëve në mënyrë të vazhdueshme aty për aty. Ne kemi qenë ekipet e veshura në të kaltër, kurse ekipi i kuq ka qenë ai sulmues, për të cilën nuk kemi qenë në dijeni se kush janë ose çka bëjnë. Në një skenar fiktiv, është imagjinuar një sistem hekurudhor, ku treni do të mbahet në lëvizje dhe të mos devijojë nga binarët. Qëllimi i ekipit të kuq ishte që ta largonte këtë tren nga binarët.

Organizimi i kësaj gare ka qenë shumë i mirë dhe është zhvilluar në një universitet publik të Çekisë dhe ne, shtetet pjesëmarrëse (të veshura me ngjyrë të kaltër), ishim mbrojtëse të kësaj infrastrukture.

Alumni: Sa ka zgjatur gara?

Buja: Gara ka zgjatur rreth 6 orë dhe përgjatë këtyre orëve ka pasur sulme, por edhe mbrojtje të vazhdueshme nga ana jonë dhe kështu, në fund të garës, rezultati ka qenë shumë i mirë.

Edhe pse nga organizatorët nuk është shprehur dëshira për të identifikuar ekipe fituese, megjithatë më së shumti jemi vlerësuar për aftësitë teknike, bashkëpunuese dhe komunikuese.

Alumni: A ishte e njohur për ju teknika e lojërave të tilla?

Buja: Shumica e teknikave të përdorura nuk ishin të reja dhe ne kishim njohuri paraprake për to.

Një pjesë e rëndësishme në këtë garë ishte edhe marrëdhënia me publikun dhe mediat, të cilën ne nuk e kemi provuar apo aplikuar më parë, ku ne kishim përgjegjësi për njoftimin e publikut, për raportimin për radio dhe televizione të ndryshme dhe e tërë kjo ishte vetëm simulim.

Alumni: Cila ka qenë sfida më e madhe për ju gjatë

garës?

Buja: Vështirësitë më të mëdha na janë paraqitur derisa e kemi kuptuar mënyrën e funksionimit dhe të shfrytëzimit të infrastrukturës, teksa ekipi i kuq kanë qenë të njoftuar për gjithçka që kishte të bënte me infrastrukturën. Por, për një kohë shumë të shkurtër kemi arritur ta marrim vesh tërë infrastrukturën, e cila ka qenë e përbërë nga makinat virtuale, sistemet e ndryshme operative, ueb aplikacionet, email-at etj., pra ka funksionuar si një organizatë e madhe.

Alumni: Çka mendoni që ju bëri fitues?

Buja: Koha e përgjigjeve është një parametër shumë i rëndësishëm që merret parasysh tek sulmet kibernetike. Gjithashtu, ne kemi pasur një koordinim tejte të mirë mes vete dhe kemi arritur që të japim përgjigje kundrejt sulmeve brenda një kohe shumë të shkurtër.

Alumni: Pse janë të rëndësishme për UBT-CERT-in aktivitetet e tilla?

Buja: Kjo garë krijon shtigje të reja për bashkëpunim me vendet e rajonit, pasi që ne nuk kemi bashkëpunim me të gjitha shtetet tjera, veçanërisht me Serbinë dhe Bosnjë e Hercegovinën. Pra, kjo mund të shërbejë si një urë lidhëse e komunikimit mes vendeve tona, në këtë fushë që nuk po njeh kufij.

Alumni: Sa po mësoni nga këto aktivitete?

Buja: Po mësojmë skenarë të rinj po pajisemi me njohuri të reja teknike dhe besoj shumë që, shumë shpejt këto përvoja do i sjellim edhe në UBT e Kosovë, përmes organizimeve të këtij lloji.

Alumni: Sa do të jetë UBT-CERT aktiv edhe në gara të ardhshme?

Buja: Ne po synojmë që të fillojmë të marrim pjesë edhe nëpër gara për siguri kibernetike në nivel evropian, ku po mendojmë që ta dërgojmë një ekip të talenteve prej vendit tonë, ndërkaq garat e tilla mbahen në fund të këtij viti në ndonjë shtet të Evropës. Para kësaj gare, ne do ta organizojmë një garë në nivel shtetëror dhe prej aty planifikojmë ta nxjerrim ekipin që do ta përfaqësojë Kosovën.

Alumni: Si është zhvilluar UBT-CERT-i me kalimin e kohës?

Buja: Kemi arritur që të rritemi gradualisht, por për këtë vit, planet janë akoma më të mëdha. Ne e kemi krijuar laboratorin e parë të UBT-CERT-it, i cili tashmë është në funksionalitet të plotë, pastaj e kemi edhe projektin e internshiptit të studentëve të UBT-së, ku për një periudhë kohore 4-6 mujore, bashkë me studentët do të mbajmë trajnime dhe do të zhvillojmë projekte të shumta, ku në fund ata do të certifikohen.



Atdhe Buja

Alumni: Çka punohet në këtë laborator?

Buja: Ne kemi ndërtuar një infrastrukturë fizike, që përbëhet prej harduerëve, pajisjeve të rrjetit, serverëve, pra i tërë rrjeti është i ndarë fizikisht dhe logjikisht nga pjesa tjetër e UBT-së, në mënyrë që puna e laboratorit të mos ndikojë tek infrastruktura reale, pastaj aty do të bëhen edhe testime të aplikacioneve të ndryshmeve dhe sistemeve. Krahas kësaj, do të zhvillojmë aplikacione të ndryshme për mobile e ueb, për fushën e sigurisë kibernetike, që qytetarëve u nevojiten për ruajtjen e privatësisë e sigurisë, për ruajtjen e të dhënave në telefonat e tyre, si dhe bëhen analiza të ndryshme të softuerëve të dëmshëm etj.

Alumni: A ka diçka të tillë në Kosovë?

Buja: Jo vetëm në Kosovë, por as në rajon nuk ka diçka të tillë

Alumni: Sa keni bashkëpunim me institucionet e ndryshme shtetërore dhe sa po angazhohen ato në fushën e sigurisë kibernetike?

Buja: Nga disa nga institucionet publike ka pasur një nismë pozitive, me ç’rast kanë krijuar disa CERT ekipe, të cilat nuk janë të konsoliduara aq sa duhet, mirëpo janë në rrugë të mbarë në këtë drejtim. Institucionet publike duhet ta mbrojnë infrastrukturën e tyre kritike financiare, doganore, të sigurisë etj., nga sulmet e mundshme kibernetike.

Ne kemi kontakt me institucionet e sigurisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Policinë e Kosovës, me ç’rast u kemi ofruar mundësi bashkëpunimi dhe përkrahje, që kanë të bëjnë me incidentet e ndryshme që lidhen me sigurinë kibernetike. Përveç kësaj, kemi bashkëpunim shumë të mirë edhe me Rregullatorin e komunikimeve elektronike, me kompanitë që ofrojnë internet në Kosovë etj., me ç’rast edhe ato kanë shprehur gatishmëri bashkëpunimi për çdo lloj nevojë që ata kanë, si në aspektin teknik, ashtu edhe në atë organizativ.

Dekani i Arkitekturës flet për ekspozitën “Modernizimi i Ferizajt 1960-1990”

Studentët e Arkitekturës në UBT po e dëshmojnë veten si profesionistë

Në javën e arkitekturës, në të cilën janë konkurrentë shumë studentë nga gjithë Kosova, studenti ynë ka marrë vendin e parë. Kjo na bën më të fuqishëm, duke e ditur që shkollën e kemi vendosur në një rrugë e cila reflekton te studentët dhe përmes tyre në sukseset që i ka në studentët”, tha dekani dr. Lulzim Beqiri

Dekani i degës së Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, prof. dr. Lulzim Beqiri në emisionin e përjavshëm “Agora”, në Radio Kampus ka folur lidhur me ekspozitën “Modernizimi i Ferizajt 1960-1990”, në të cilën janë paraqitur punimet e përbashkëta të profesorëve dhe të studentëve të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, dega në Ferizaj.

Prof.dr. Beqiri tha se në ekspozitë është prezantuar puna e arkitektëve, përmes maketeve, posterëve, broshurave, videove dhe fotografive, të cilat shfaqën vlerat e arkitekturës së Ferizajt në një periudhë 40 vjeçare. Ai gjithashtu tha se këto informacione do të shërbejnë qytetarëve si letërnjoftim i objekteve të cilët gjenden në qytetin e tyre.

Z.Beqiri tha se ekspozita të tilla planifikohet të prezantohen në shumë komuna. Ai gjithashtu tha se është vetëm fillimi i modernizimit të komunave.

“Edhe pse është shumë sfiduese por prapa nesh është një ushtri e tërë e studentëve të cilët po punojnë dhe kanë potencial. Duke parë përvojën e studentëve të cilët janë shumë entuziastë nuk dyshojë që do të kemi suksese në këtë aspekt”, tha dekani Beqiri.

Dekani gjithashtu tregoi për sukseset e shumta që po e karakterizojnë departamentin e arkitekturës në UBT.

“Studentët tanë janë duke e dëshmuar veten, qoftë brenda apo jashtë vendit. Në javën e arkitekturës, në të cilën janë konkurrentë shumë studentë nga gjithë Kosova, studenti

ynë ka marrë vendin e parë. Kjo na bën më të fuqishëm, duke e ditur që shkollën e kemi vendosur në një rrugë e cila reflekton te studentët dhe përmes tyre në sukseset që i ka në studentët”, tha dekani Beqiri.

Ai shtoi se studentët tanë që i kemi në mastar nëpër shumicën e shteteve të Evropës janë pranuar pa telashe. “Studenti ynë është profesionalisht mjaft i përgatitur me bazën që merr nga UBT dhe është konkurrent edhe në aspektin rajonal e evropian. Kjo na inkurajon që të jemi më tepër entuziastë në harmonizimin e veprimeve tona në zhvillim e shkollës pikërisht me pas sukses për Kosovën”, tha ndër të tjera Beqiri.

UBT siguron literaturë profesionale për studentët

Librat profesionalë, me autorë të zgjedhur dhe fusha specifike – prioritet i UBT-së

Rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi thekson se ky institucion, në pesëmbëdhjetë vitet e punës së tij, ka publikuar mbi 40 tituj të librave, të cilat paraqesin një pasuri shumë të madhe për institucionin, por edhe një mundësi shumë të madhe për studentët e të gjitha niveleve



Gjatë punës së deritanishme, UBT i ka kushtuar një kujdes shumë të madh edhe sigurimit të literaturës adekuate dhe sa më bashkëkohore për studentët. Marrëveshjet me shumë institucione ndërkombëtare u kanë mundësuar studentëve të kenë qasje online në bibliotekat më të njohura, që sigurojnë literaturën përkatëse për të gjitha drejtimit e studimit.

Gjithashtu, ka krijuar bibliotekën më të madhe universitare në vend, me titujt më të fundit, të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe profesorëve në të gjitha kampuset e UBT-së.

Ky institucion, njëkohësisht i ka kushtuar kujdes shumë të madh edhe publikimit të librave të profesorëve dhe ekspertëve të angazhuar në këtë institucion.

Rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi thekson se ky institucion, në pesëmbëdhjetë vitet e punës së tij, ka publikuar mbi 40 tituj të librave, të cilat paraqesin një pasuri shumë të madhe për institucionin, por edhe një mundësi shumë të madhe për studentët e të gjitha niveleve.

“UBT ka ndjekur parimin e publikimit të librave në fushat në të cilat është vërejtur

mungesë e literaturës për studentët. Krejt kjo me qëllimin që studentëve t’u ofrohet literaturë në gjuhën shqipe në fushat e reja dhe në harmoni me planprogramet mësimore moderne që ofron UBT”, thotë rektori Hajrizi.

Sipas tij, kujdes i është kushtuar literaturës nga shkencat kompjuterike, arkitektura, prokurimi e shkencat so-




cialë, ku një pjesë e librave janë të parat të kësaj fushe në gjuhën shqipe.

Para publikimit të librave të rinj, organet drejtuese të UBT-së vlerësojnë cilat janë lëndët në të cilat ka nevojë për literaturë shtesë dhe pastaj merret vendimi për publikimin e librave, botimi i të cilave mbështetet materialisht nga UBT.

Gjatë vitit 2016, UBT publikoi disa tituj, kryesisht libra që mbulojnë fusha specifike dhe që shënojnë të arritura dhe paraqesin prurje të veçanta, me interes jo vetëm për studentët, por edhe për lexuesit e tjerë në përgjithësi, që paraqesin edhe të arritura në fushën e shkencës.

UBT do të vazhdojë me publikimin e librave të rinj edhe gjatë vitit 2017. “Kemi hartuar planin e publikimit të librave gjatë vitit në të cilin sapo kemi hyrë. Do të përkrahim me prioritet librat autorialë të profesorëve dhe ekspertëve të angazhuar në UBT, gjithnjë duke u kujdesur që këta libra të sjellin risi dhe të jenë nga fusha specifike”, tha dr.Hajrizi.

“UBT e ka mision të vetin të sigurojë literaturë për studentët, por edhe të japë kontributin në pasurimin e literaturës shkencore në përgjithësi në vend, duke qenë edhe në këtë fushë prijatë, siç është edhe në të gjitha fushat e tjera”, theksoi rektori Hajrizi.



Profesori i arkitekturës në UBT, dr. Binak Beqaj

UBT jep kontribut për përmirësimin e çështjeve urbane

“Zgjidhja duhet të vijë me bashkërendimin e shumë faktorëve, duke i përfshirë qytetarët, institucionet, bizneset, akademinë, shoqërinë civile etj.”, ka thënë profesori Beqaj

Gjendja urbanistike në Prishtinë është reflektim i gjendjes së përgjithshme urbanistike në tërë Kosovën. Këtë konstatim e ka nxjerrë profesori i arkitekturës në UBT, dr. Binak Beqaj, sipas të cilit kur të kritikohet Prishtina duhet të merren parasysh krejt qytetet e Kosovës. Sipas tij, gjendja nuk është e mirë, por nuk është pa zgjidhje. “Zgjidhja duhet të vijë me bashkërendimin e shumë faktorëve, duke i përfshirë qytetarët, institucionet, bizneset, akademinë, shoqërinë civile etj.”, ka thënë profesori Beqaj.

Beqaj ka botuar edhe libra në këtë fushë, duke sensibilizuar publikun e gjerë për problemet e përgjithshme urbanistike që ka Kosova.

Ai thekson se me planifikimin e mirë urban rregullohet dhe cilësia e jetesës së qytetarëve.

Gjithnjë sipas tij, Kosova ka mungesë të ekspertëve në këtë segment, si dhe ka edhe probleme të tjera që e dëm-

tojnë konsiderueshëm urbanizmin.

“Meqenëse Kosova ende nuk është konsoliduar si një shoqëri e zhvilluar, sfidat që e përballin atë janë korrupsioni, dezorganizimi i tregut dhe shumë elemente të tjera”, ka thënë Beqaj.

Duke folur konkretisht për komunën e Prishtinës, Beqaj ka thënë se fillimisht duhet të aprovohet Ligji për decentralizimin e Prishtinës, i cili sipas tij zgjidh shumë probleme urbanistike.

“Vizioni i planit urbanistik në Kosovë është drejt standardeve evropiane: me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, me infrastrukturë dhe me teknologji moderne, që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet etj.”, ka përfunduar profesori Beqaj.



Ministri Ferat Shala mbajti ligjërata tematike në UBT për “Sfidat e mjedisit në Kosovë”

Qytetarët e Kosovës të jetojnë në një ambient shumë më të pastër

“Mjedisi dhe Planifikimi është pjesë e pandashme e shoqërisë sonë, prandaj Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor po i mbulon elementet e zhvillimit dhe të ekonomisë, të politikëbërjes institucionale dhe shtetërore”, tha ministri Shala



“Sfidat e mjedisit në Kosovë” ishte tema e ligjërates tematike që e mbajti para studentëve dhe profesorëve të UBT-së, ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i Republikës së Kosovës, Ferat Shala.

Në ligjërata, ministri Shala trajtoi sfidat dhe vendim-marrjet në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, si dhe ku është dhe kah po shkon Kosova në këtë sektor. Mes të tjerash, ai theksoi se kjo ministri

i ka caktuar katër prioritete bazike për mirëqenien dhe funksionimin adekuat të tyre: ajri, uji, mbetjet urbane dhe planifikimi hapësinor, ku për secilën u diskutua në mënyrë të veçantë.

“Jemi duke punuar që qytetarët e Kosovës të jetojnë në një ambient shumë më të pastër, të kenë ujëra të rrjedhës së pastër dhe të pijshëm, me vendbanime të ndërtuara në mënyrë legale, duke pasur parasysh gjithmonë uljen e koston”, tha ministri Shala.

Sipas tij, Mjedisi dhe Planifikimi është pjesë e pandashme e shoqërisë sonë, prandaj Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor po i mbulon elementet e zhvillimit dhe të ekonomisë, të politikëbërjes institucionale dhe shtetërore.

Në fund në ligjërata u zhvillua një debat i gjerë rreth një varg çështjesh me interes për planifikimin hapësinor dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.

Para ligjërates, ministri Ferat Shala u prit në një takim nga rektori i UBT-së Prof. dr. Edmond Hajrizi, me të cilin

nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve.

“Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është një ministri që ngërthen në vete funksione, fusha me interes shumë të mëdha për UBT-në, duke marrë parasysh se ne merremi kryesisht me fushat që përfshihen në këtë lëmi dhe ky bashkëpunim është vërtet i rëndësishëm për ne. Ne kemi edhe kënaqësi të veçantë që Ministri me këtë qasje i ka dhënë mundësi të madhe studentëve në ofrimin apo studimin e të dhënave për të rezultuar analizë dhe studime që janë në interes të përgjithshëm për Kosovën”, theksoi rektori Hajrizi me këtë rast.

Interaktiviteti dhe bashkëpunimi mes UBT-së dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të na shtyjë dhe do të na përkrahë që të shkojmë më tutje, ku do t’i përgjigjemi sfidave dhe pyetjeve që janë ende pa përgjigje në aspektin infrastrukturor dhe në aspektin e përgjithshëm që lidhet me këtë Ministri, tha rektori Hajrizi.

Siguria kibernetike

UBT-CERT për herë të parë në rajon hap Laboratorin e Sigurisë Kibernetike

Gjatë fazës së konfigurimeve është realizuar edhe adaptimi për përdorimin e një pjese të infrastrukturës nga Laboratori i harkimit Evropian, platformë në të cilën zhvillohen shumë gara mes talenteve të fushës së sigurisë kibernetike, por zhvillohen edhe garat evropiane ndërmjet Cert-ve

Për herë të parë në rajon, UBT-Cert ka hapur Laboratorin e Sigurisë Kibernetike, që do të shërbejë si qendër e koordinimit dhe organizimit për Cert-ekipet në Kosovë edhe më gjerë.

Gjatë fazës së konfigurimeve është realizuar edhe adaptimi për përdorimin e një pjese të infrastrukturës nga Laboratori i harkimit Evropian, platformë në të cilën zhvillohen shumë gara mes talenteve të fushës së sigurisë kibernetike, por zhvillohen edhe garat evropiane ndërmjet Cert-ve.

Ndërkohë, sipas menaxherit të UBT-Cert, Atdhe Buja, tashmë është përgatitur edhe plani vjetor i aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë laborator. Sipas tij, projekti është realizuar në harmoni të standardeve ndërkombëtare si dhe politikave të organizatës botërore “First”.

“Ky planifikim përcakton organizimin e simulimeve të ndryshme testuese në rrjete, aplikacione dhe sisteme, internship për studentët, trajnime dhe takime me talente të rinj, analiza dhe kërkime për softuer të dëmshëm (malwares) dhe kampanja të vetëdijesimit”, ka theksuar Buja.

Ai tutje shtoi se zhvillimi dhe implementimi i këtij projekti ka kaluar nëpër faza të ndryshme deri tek funksionalizimi i plotë i saj.

Bazuar në Strategjinë për Siguri Kibernetike të UBT-CERT, më saktë parashihet zhvillimi dhe krijimi i mundësive për punë praktike të studentëve në fushën e sigurisë kibernetike, etj.



Edhe një publikim i rëndësishëm i UBT-së

Rektori Hajrizi e ministri Hoxhaj pajtohen për bashkëpunim më të ngushtë në 2017

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka takuar ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Enver Hoxhaj, me të cilin kanë bashkëbiseduar për një sërë çështjesh të karakterit bilateral të bashkëpunimit. Në këtë takim UBT dhe MPJ, janë pajtuar të koordinojnë një listë të aktiviteteve të përbashkëta për vitin 2017. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve do të fokusohet veçmas në përfshirjen e studentëve të UBT-së, në projektet e Diplomacisë Publike dhe të kryerjes së praktikës në disa fusha specifike. Palët u pajtuan se universitetet mundë të luajnë rolë të rëndësishëm në fushën e diplomacisë publike. Gjithashtu, në takim janë diskutuar edhe mundësi të tjera bashkëpunimi.

Në Vjenë të Austrisë

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në Forumin Global për Ndërmarrësi e Inovacion

Themeluesi dhe Presidenti i UBT-së, prof. dr.Edmond Hajrizi, ka marrë pjesë në Forumin e tetë Global të “Druker për Ndërmarrësi dhe Inovacion, me moton ‘Shoqëria Ndërmarrëse’, mbajtur në Vjenë të Austrisë. Në këtë Forum morën pjesë ndërmarrës, profesorë dhe liderë botërorë, të njohur në fushën e ndërmarrësisë dhe inovacionit, si Clayton Christensen, Anil Gupta, Roger Martin, Philip Kotler, Gary Hamel, Fredmund Malik, Hermnn Simon, Ralf Koester, GisbertRuehl, Rovan Leen, Sarah Cliffe dhe shumë të tjerë. Gjatë këtij forumi, rektori Hajrizi, është

takuar me shumë pjesëmarrës, ndërsa ka diskutuar përvojat e mira në ndërmarrësi, inovacion dhe për rolin e tyre në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi. “UBT është një shembull tipik i ndërmarrësisë, ekselencës dhe inovacionit.Po ashtu, janë krijuar mundësi të mira për bashkëpunim në të ardhmen”, tha rektori Hajrizi. Rektori Hajrizi ka takuar edhe autorin e shume botimeve në fushën e marketing-ut, z. Philip Kotler, i cili pak vjet më parë është nderuar me çmimin e lartë të UBT-së ‘Lidership Excellence Award’.

Rektori i UBT-së vizitë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Salzburg

UBT forcon bashkëpunimin ndërkombëtar për fushën e turizmit

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi,po e forcon bashkëpunimin në fushën e turizmit me Universitetin e Shkencave të Aplikuara, në Salzburg të Austrisë. Rektori Hajrizi tregon se në takimin me rektorin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Salzburg, Prof. Mag. Dr. Gerhard Blechinger, është konfirmuar gatishmëria e këtij institucioni për bashkëpunim me UBT. “Ne do të bashkëpunojmë në ngritjen e kapaciteteve për fushën e turizmit dhe mikpritjes në Kosovë përmes Qendrës së Kompetencës për Turizëm dhe Mikpritje, e themeluar nga UBT në vitin 2015”, tregoi rektori Hajrizi. Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve do të vazhdojë me krijimin e programeve të përbashkëta, me trajnime,

vizita studimore, shkolla verore si dhe aplikime të përbashkëta për projektet e Bashkimit Evropian. Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë javës së qëndrimit në Salzburg të Austrisë, është takuar edhe me Dekanen e Fakultetit të Turizmit dhe Inovacionit, prof. Eva Brucker, si dhe me drejtorin e Shkollës së njohur të Turizmit në Salzburg, mag. Leonhard Wörndl. Rektori Hajrizi ka vizituar edhe infrastrukturën e shkollës së turizmit, si praktikë e standardeve ndërkombëtare. Rektori i UBT-së prof.dr Edmond Hajrizi, vlerëson se Austria dhe Salzburgu janë modele, në bazë të të cilave duhet të punojë edhe Qendra e UBT-së në Kosovë.

Gjatë vizitës në Austri

Rektori Hajrizi bashkëpunon me partnerët në projektin Erasmus +për studime të përbashkëta

Rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi, bashkë me drejtorin e Institutit për Zhvillim të Arsimit dhe çështjeve akademike në UBT, Bujar Gallopenin, morën pjesë në takimet e partnerëve të projektit evropianë Erasmus + për studimet e përbashkëta Master në Shkencat Politike, në Austri. Përveç përgatitjeve të këtij programi, gjatë kësaj kohe, programi i dizajnuar nga projekti do të kalojë përmes vlerësimit të akreditimit. Rektori Hajrizi tregon se akreditimi do të realizohet nga Agjencia e Akreditimit

dhe e Sigurimit të Cilësisë së Austrisë. Ai shtoi se kjo është hera e dytë në Evropë i një vlerësimi të përbashkët për studime të përbashkëta. Pas akreditimit, pritet që një vendim i tillë të konfirmohet edhe nga agjencitë e vendeve përkatëse, në këtë rast edhe nga Kosova. Sipas rektorit, studentet të cilët do të regjistrohen në këtë program, do të kenë mundësi të marrin diplomë të përbashkët nga disa Universitete Evropiane dhe Regjionale.

Zgjerohet bashkëpunimi me universitet hungareze

UBT me marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin për Teknologji dhe Ekonomi të Budapestit

UBT bashkon forcat për projekte shkencore në nivel evropian e global me Universitetin për Teknologji dhe Ekonomi të Budapestit.

Kështu, UBT dhe Universiteti për Teknologji dhe Ekonomi i Budapestit të Hungarisë kanë nënshkruar një marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi në fushën e projekteve shkencore në nivel evropian e global në mes të këtyre dy universiteteve. Rektori i UBT-së,prof.dr,Edmond Hajrizi tregon se marrëveshja përfshin bashkimin e forcave të dy universiteteve për projekte shkencore në nivel evropian e global. Universiteti për Teknologji dhe Ekonomi i Budapestit është i themeluar në vitin 1782 dhe është një ndër universitetet më të mëdha e më të njohura në Hungari. “Është nder për ne, kur bashkëpunojmë me universitete me renome dhe tradita. Me Universitetin për Teknologji dhe Ekonomi të Budapestit, bashkë do të aplikojmë në projekte shkencore evropiane, që kanë për qëllim mbështetjen e projekteve të mëdha shkencore në nivel evropian e global, të cilat do t’i punojnë shkencëtarët tanë të bashkëpunimit”, tregon rektori Hajrizi. Ai gjithashtu tregon se UBT dhe Universiteti për Teknologji dhe Ekonomi në Budapest kanë një bashkëpunime të vazhdueshëm në fushat me interes të përbashkët, si për studentët ashtu edhe për stafin pedagogjik.

Barcelonë

Rektori Hajrizi përfaqëson Kosovën në Konferencën Ndërkombëtare të Arsimit të Lartë

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ditëve të fundit ka qëndruar në Barcelonë, ku ka përfaqësuar Kosovën në një konferencë për HERE dhe misionin: “Kontributi në reformat e arsimit të lartë”. Në cilësinë e udhëheqësit të grupit të ekspertëve të arsimit të lartë të Kosovës, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit në Barcelonë, është takuar edhe me stafin e Agjencisë së EU-së.

Ai gjithashtu është takuar edhe me ekspertë dhe përfaqësuese të shumë vendeve të Evropës dhe vendeve partnere. UBT ka partneritet me më shumë se 250 universitete ndërkombëtare, ndërsa bashkëpunimi i vazhdueshëm, e ka bërë këtë institucion të arsimit të lartë të Kosovës, të jetë më seriozi në kuptimin e përhapjes së dijes akademike të studentëve në Kosovë, pa u dalluar nga universitetet ndërkombëtare.

Konferenca “Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit gjyqësor në Kosovë”

Hajrizi: Kosova duhet të bëhet kampione e drejtësisë

“Lufta e tmerrshme dhe dhuna e ushtruar ndaj popullit tonë është ende freskët në kujtesën tonë kolektive, si shkelje mizore e të drejtave të njeriut, prandaj ne sot duhet të jemi kampion në mbrojtjen e tyre”, theksoi Hajrizi

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi vlerësoi se shoqëria kosovare duhet të përkrahë, fuqizojë dhe shtojë kontributin në promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ai e ka thënë këtë në konferencën “Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit gjyqësor në Kosovë”, organizuar nga UBT, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të shtunën.

“Lufta e tmerrshme dhe dhuna e ushtruar ndaj popullit tonë është ende freskët në kujtesën tonë kolektive, si shkelje mizore e të drejtave të njeriut, prandaj ne sot duhet të jemi kampion në mbrojtjen e tyre”, theksoi Hajrizi.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale të drejtësisë në vend, Hajrizi njoftoi se institucioni të cilin ai e drejton, ka themeluar Institutin Kosovar për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit.

“UBT po mundohet ta përkrahë dhe fuqizojë kontributin në promovimin e të drejtave të njeriut, me qëllim të krijimit të një shteti të së drejtës”, përfundoi rektori Hajrizi.

Ish-ombudspersoni i Kosovës, Marek Antoni Nowicki vlerësoi se problemi më i madh në Kosovë është mosrespektimi i kufirit mes sistemit gjyqësor dhe atij ekzekutiv.

“Gjyqtarët dhe politikanët duhet t’i shmangin të gjitha llojet e lidhjeve mes tyre, në mënyrë që t’i shmangen ndikimeve dhe presionit të mundshëm”, theksoi Nowicki, për të shtuar se, “institucionet e drejtësisë dhe gjykatat nuk duhet të ekzistojnë vetëm nëpër ligje, por edhe në praktikë”.

Avokati i Popullit në Kosovë, Hilmi Jashari, duke treguar përvojën dhe vështirësitë e të qenit Ombudsperson, tha se institucionet gjyqësore dhe prokuroriale kanë probleme të theksuara e sistematike të natyrave të ndryshme, prandaj sipas tij, nevojitet qasje sistematike për zgjidhjen e tyre. “Ligjet janë garanci mbi të cilat duhet të varet dhe ndërtohet mënyra jonë e jetesës”, shtoi Jashari.

Përfaqësuesi i Institutit për Drejtësi i Kosovës, Betim Musliu ngriti shqetësimin se në Kosovë mungon vullneti për të krijuar një sistem gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm.

“Sistemi ynë gjyqësor është i brishtë, jofunksional dhe i varur nga politika”, vlerësoi Musliu, teksa shtoi se, “të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë para ligjit, por jo edhe gjatë zbatimit të tij”.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi potencoi se ligjet e Kosovës sigurojnë pavarësinë e gjyqësorit, por sipas tij, kjo pavarësi nuk është shumë reale.

“Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit tonë gjyqësor nuk

është edhe aq reale, pasi që ndikohet në mënyrë indirekte nga politika”, tha Idrizi. Ai foli për nevojën e madhe për ndryshime dhe për të metat e gjyqësorit.

“Mënyra e përzgjedhjes së gjyqtarëve, forma e financimit, mungesa e vullnetit dhe llogaridhënies”, sipas Idrizit, “janë vetëm disa nga të metat dhe ngecjet e sistemit tonë gjyqësor”.

Duke shpalosur qëllimin e Institutin Kosovar për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit, ligjëruesja e UBT-së, njëherësh edhe udhëheqëse e panelit të diskutimit, Gjylbehare Bella - Murati, tha se ideja është që të krijohet një frymë hulumtuese brenda këtij institucioni akademik.

“Gjykata dhe gjyqtarët duhet të jenë mbrojtës të së drejtave të njeriut”, theksoi Murati, pasi që sipas saj, “Kosova ka shumë për të ofruar për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njerëzve”.

Përfaqësuesja e UNDP-së, Virxhina Dumnica vlerësoi se pavarësia dhe paanshmëria e sistemit gjyqësor në Kosovë është mbi të gjitha nevojë dhe detyrim.

“Pavarësia e gjyqësorit nuk është privilegj, por obligim që rrjedh nga nevojat e qytetarëve”, tha ajo.

Tutje, duke përmendur standardet mbi të cilat bazohen dhe respektohen të drejtat e njeriut në Kosovë, Dumnica tha se besimi i qytetarëve vjen para të gjitha elementeve të tjera.

“Besimi i publikut në gjyqësor, është parakusht për profesionalizimin e tij”, përfundoi ajo.

Profesoresha e fakultetit Juridik në UP, Remzije Istrefi tha se qytetarët e kanë humbur besimin në funksionin e sistemit gjyqësor, dhe kjo sipas saj, “për shkak të mosgatishmërisë së njerëzve kompetentë për të detektuar njerëzit e ndikuar nga politika”.

Ajo tha se një pjesë e fajit për këtë sistem e ka edhe sistemi edukativ në Kosovë, i cili, sipas Istrefit, “nuk po arrin të ndërtojë njerëz të pavarur dhe të paanshëm”.

Përfaqësuesi i organizatës “ÇOHU”, Genc Nimoni solli



Avokati i Popullit në Kosovë, Hilmi Jashari, duke treguar përvojën dhe vështirësitë e të qenit Ombudsperson, tha se institucionet gjyqësore dhe prokuroriale kanë probleme të theksuara e sistematike të natyrave të ndryshme, prandaj sipas tij, nevojitet qasje sistematike për zgjidhjen e tyre. “Ligjet janë garanci mbi të cilat duhet të varet dhe ndërtohet mënyra jonë e jetesës”, shtoi Jashari

disa nga hulumtimet dhe gjetjet e fundit të kësaj organizate, rezultatet e të cilave shpalosin mangësi në gjyqësorin e Kosovës, si dhe shkelje të të drejtave të njeriut, duke vënë theksin tek veriu i Kosovës.

“Në veri të Kosovës është pjesa ku gjyqësori i Kosovës nuk ka arritur ta shtrijë tërësisht ndikimin e vet”, tha Nimoni, për të shtuar se, “në këtë pjesë shkelen të drejtat elementare të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtën e pronës”, vlerësoi Nimoni.

Konferenca i mbylli punimet pas një debati panelistë-pjesëmarrës, ku u diskutua mbi institucionet paralele në veri të Mitrovicës, për afatet kohore të trajtimit të rasteve korruptive, për rastet e monitorimit të personave të korruptuar, krahasimin e performancës së policisë me atë të gjyqësorit, buxhetin e ulët etj.

Profesori i UBT-së, dr. Nol Deda, në një intervistë për UBT - Radio Campus

Shqetësim për cilësinë e ajrit në Kosovë – propozohen masa

“Nëse taksa doganore për futjen e automjeteve më të reja në Kosovë do të ishte më e ulët e për ato të vjetrat më e lartë, atëherë kjo do të bënte që tregu i Kosovës të freskohej me automjete të reja brenda 10 vjetësh”, ka thënë Deda

Profesori i UBT-së, dr. Nol Deda, në një intervistë për UBT - Radio Campus, ka thënë se, si krejt qytetarët, edhe në UBT janë të shqetësuar me ndotjen e ajrit në Kosovë. Ai ka propozuar masa që do ta ndryshonin gjendjen.

Pasi është pajtuar se automjetet janë ndotësit më të mëdhenj, ka radhitur si ndotës edhe cilësinë e derivateve djegëse, hedhjen e sulfurit në karburante për ta shtuar sasinë, termoelektranat në Obiliq etj.

Për shkaktarin e parë të ndotjes - automjetet, Deda ka theksuar se në territorin e Kosovës 80 për qind e veturave, që hyjnë nga të gjitha vendet e botës janë 17 vjet të vjetra.

Në këtë plan, sipas Dedës, Ministria e Financave duhet ta ndryshojnë sistemin e doganimit të automjeteve.

“Nëse taksa doganore për futjen e automjeteve më të reja në Kosovë do të ishte më e ulët e për ato të vjetrat më e lartë, atëherë kjo do të bënte që tregu i Kosovës të freskohej me automjete të reja brenda 10 vjetësh”, ka thënë Deda, sipas të cilit me këtë projekt, Kosovës do t’i zvogëlohej buxheti për 25 milionë euro, porse do të shpëtoheshin shumë jetë

njerëzish. Po ashtu, ka thënë se do të zvogëloheshin aksidentet dhe qytetarët nuk do të helmoheshin nga helmet toksike, të liruara nga automjetet e vjetra. Deda konsideron se situata aktuale e ndotjes së ajrit i obligon qytetarët që të ndërmarrin masa.

“Qytetarët duhet ta kenë parasysh se në momentin që niveli i ndotjes e kalon dyfishin e nivelit të paraparë, ata duhet të vënë maska në gojë”, ka spikatur ai, duke kritikuar institucionet e vendit se nuk merren shumë me këto problem.

“Mungojnë emisione të caktuara, e, qytetarët e Kosovës nuk kanë se nga kush të informohen për gjendjen alarmante”, ka shtuar Deda për të shtuar se matjet e bëra së fundi nga Ambasada Amerikane, kanë dhënë të kuptohet se cila është gjendja reale.

“Nëse qytetarët e mësojnë të vërtetën edhe reagimi do të jetë më i madh dhe do të merren masat e mjaftueshme”, është shprehur ai, për të shtuar se po të bëheshin matjet e duhura të nivelit të ndotjes së ajrit nga ekspertët, Prishtina

do të dilte qyteti me nivelin më të lartë të ndotjes, “jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë”.

Si njohës i problemit, Deda bën me dije se është në proces miratimi i ligjit mbi automjetet nga Kuvendi i Kosovës. Por, gjëja kryesore, gjithnjë sipas Dedës, është kontrollimi i hyrjes së automjeteve nga doganat.

“Me këtë masë automjeti nuk do të listohej më si ndotësi më i madh i ajrit në vend”, ka shtuar Deda.

Si masë tjetër parandaluese e ndotjes së ajrit, Deda e konsideron veprimin ligjor që nëpër qendrat e qytetit të ndalohet qarkullimi, pothuajse i tërësishtëm i automjeteve, të krijohen hapësira për lëvizjen e këmbësorëve dhe çiklistëve, të rregullohet sinkronizimi i semaforëve etj.

“Për rregullimin e problemit duhet kosto shtesë, vullnet dhe grup ekspertësh”, ka saktësuar Deda, duke zënë ngoje edhe rregullimin e infrastrukturës për shfrytëzimin e trolejbusëve, të cilët në vend të derivateve e shfrytëzojnë energjinë elektrike.

Studentët përfitojnë nga bashkëpunimi me kompanitë kosovare

Bashkëpunimi UBT - “Nartel” përforcon punën praktike të studentëve të UBT-së

“Lufta e tmerrshme dhe dhuna e ushtruar ndaj popullit tonë është ende freskët në kujtesën tonë kolektive, si shkelje mizore e të drejtave të njeriut, prandaj ne sot duhet të jemi kampion në mbrojtjen e tyre”, theksoi Hajrizi



Gjithnjë e më shumë po shtohet numri i studentëve të UBT-së që po angazhohen në internship ose në punë praktike në kompani të ndryshme. Kjo, falë bashkëpunimit të mirë që institucioni ka me organizata dhe kompani lokale e ndërkombëtare.

Së fundmi, studentët e Fakultetit të Arkitekturës në UBT, Atdhe Rexhaj, Naile Fejzullahu dhe Arlinda Dragusha, janë pranuar në punë praktike në kompaninë ndërtimore “Nartel”, në Prishtinë.

Në këtë kompani, ata do të merren me veprimtarinë e ndërtimtarisë ose më saktë do të mbikëqyrin punët që nga fillimi e deri tek finalizimi i tyre.

Studenti Atdhe Rexhaj ka thënë se është mundësi e mirë për ta që të jenë pjesë e një kompanie të tillë.

“Fakulteti i Arkitekturës në UBT po aplikon standardeve më të larta, sidomos në projektim, planifikim dhe menax-

him të projekteve. Ne po aftësohemi për të punuar dhe po dalim suksesshëm në ekonominë e tregut, në sektorin publik e privat”, ka theksuar Rexhaj.

Sipas tij, UBT mbetet të jetë një Institucion inovativ i arsimit të lartë në Kosovë dhe në rajon dhe se po ofron programe studimi sipas standardeve cilësore ndërkombëtare.

“Në kuadër të kësaj praktike, ne do të kemi mundësinë të shohim e praktikojmë punët të cilat do të zhvillohen brenda kësaj kompanie. Andaj, kjo është mundësi e mirë që përmes teorisë dhe tashmë praktikës, studentët të aftësohen dhe të kenë përparësi në tregun e punës”, ka thënë Rexhaj, sipas të cilit këso mundësi ofron vetëm UBT-ja.

UBT është institucion i arsimit të lartë në Kosovë, i përkushtuar në zhvillimin e programeve akademike, të kombinuara me hulumtime shkencore, në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me institucionet shtetërore

Studentët e SHKI-së, praktikantë në MAPL

Studentët Blend Reçica dhe Enis Krapu kanë filluar intership në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), si praktikantë të IT-së

Gjithnjë e më shumë po shtohet numri i studentëve të UBT-së që po angazhohen në internship ose në punë praktike në kompani të ndryshme. Kjo, falë bashkëpunimit të mirë që institucioni ka me organizata dhe kompani lokale e ndërkombëtare.

Së fundmi, studentët e Fakultetit të Arkitekturës në UBT, Atdhe Rexhaj, Naile Fejzullahu dhe Arlinda Dragusha, janë pranuar në punë praktike në kompaninë ndërtimore “Nartel”, në Prishtinë.

Në këtë kompani, ata do të merren me veprimtarinë e ndërtimtarisë ose më saktë do të mbikëqyrin punët që nga fillimi e deri tek finalizimi i tyre.

Studenti Atdhe Rexhaj ka thënë se është mundësi e mirë për ta që të jenë pjesë e një kompanie të tillë.

“Fakulteti i Arkitekturës në UBT po aplikon standardeve më të larta, sidomos në projektim, planifikim dhe menaxhim të projekteve. Ne po aftësohemi për të punuar dhe po dalim suksesshëm në ekonominë e tregut, në sektorin publik e privat”, ka theksuar Rexhaj.

Sipas tij, UBT mbetet të jetë një Institucion inovativ i arsimit të lartë në Kosovë dhe në rajon dhe se po ofron programe studimi sipas standardeve cilësore ndërkombëtare.

“Në kuadër të kësaj praktike, ne do të kemi mundësinë të shohim e praktikojmë punët të cilat do të zhvillohen brenda kësaj kompanie. Andaj, kjo është mundësi e mirë që përmes teorisë dhe tashmë praktikës, studentët të aftësohen dhe të kenë përparësi në tregun e punës”, ka thënë Rexhaj, sipas të cilit këso mundësi ofron vetëm UBT-ja.

UBT është institucion i arsimit të lartë në Kosovë, i përkushtuar në zhvillimin e programeve akademike, të kombinuara me hulumtime shkencore, në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Shkencat Politike

Studentët përforcojnë njohuritë profesionale politike

Erza Kqiku, Lirikosovare Bllaca dhe Gresa Shaqiri, kanë marrë pjesë në Akademinë “Elita”, në Prishtinë, për aftësim profesional në fushën e politikës

Studentet e vitit të dytë në Fakultetin e Shkencave Politike në UBT, Erza Kqiku, Lirikosovare Bllaca dhe Gresa Shaqiri, kanë marrë pjesë në Akademinë “Elita”, në Prishtinë, për aftësim profesional në fushën e politikës.

Akademia në fjalë ka për qëllim përgatitjen e kandidatëve në profesionin e politikanit, për të ushtruar profesionin e analistit politik, gazetarit politik dhe në përgjithësi, trajnohen grupe për politikën.

Me këtë rast, studentja Erza Kqiku ka thënë se ky trajnim që është mbajtur dhe u shërben studentëve e kandidatëve në përgjithësi për t’u specializuar në fushën e politikës. Sipas saj, akademia i ka përgatitur ata për tregun e punës dhe për tregun politik, si dhe u shërben si model për krijimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre.

“Kemi arritur të shohim shumë modele për karrierën politike, prandaj konsideroj se akademia na ka përgatitur për të marrë përsipër detyra të rëndësishme publike, shtetërore, si dhe për të kandiduar për një post zgjedhor”, theksoi Kqiku.

Tutje, ajo ka thënë se e mira e kësaj akademie është se pjesëmarrësit certifikohen me titullin “Njohës i Politikave”, që të mund të ushtrohet në çdo institucion.

Akademia Profesionale “Elita” është qendër për formim profesional, e cila përgatit kandidatët për profesionet e tyre, në këtë rast për fushën e politikës, me anë të leksioneve dhe praktikës aftëson të interesuarit, për një karrierë të suksesshme.

Ligjërata “Zhvillimi i Sektorit të Telekomit në Kosovë

Studentët e UBT-së përfitojnë njohuri për funksionimin e kompanive të mëdha



Në UBT, të enjten, është mbajtur pjesa e dytë e serisë së forumeve në formë debati për lidhshmëri, ndërmarrësi dhe inovacion, udhëhequr nga Shpend Balija - drejtor ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë dhe ligjërues në UBT.

Referuesi i parë në debat ishte Alban Kastrati, njëri nga menaxherët e IPKO-s, më temë: “Zhvillimi i Sektorit të Telekomit në Kosovë”. “Ideja është që studentët të marrin sa më shumë informata praktike se si funksionon një biznes apo kompani.

“Shtyllat kryesore të një kompanie janë misioni, vizioni dhe vlerat, të cilat duhet t’i kuptojmë mirë, t’i fusim në funksion dhe t’i zhvillojmë sa më shumë”, ka thënë ai, duke u kërkuar studentëve që të fitojnë sa më shumë aftësi profesionale, “që të krijojnë bizneset tuaja, ose t’i ndihmoni bizneset”. Në fund, ai ka shtuar se mundësitë për internship për studentët e UBT-së janë të hapura gjithnjë.

Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë dhe ligjërues në UBT, Shpend Balija, ka thënë se po përpiqen që praktikën në industri t’ua sjellin studentëve.

“Meqenëse kemi studentë të biznesit dhe të teknologjisë, ne po mundohemi që të sjellim industrinë më afër studentëve tanë, për të krijuar mundësi indirekte dhe interaksion me kompani, të cilat operojnë në Kosovë”, tha ai.

Balija theksoi se sa i përket sistemit të telekomit janë vetëm dy kompani që operojnë. “Është një treg mjaft interesant dhe siç e dini, me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë gjërat po ndryshojnë. UBT ka marrë hapa të sigurt në ndërlidhjen e sistemit të arsimit me teknologjinë, dhe studentët janë të përgatitur për tregun e punës”, ka përfunduar ai, teksa të dy referuesit kanë debatuar me të pranishmit.

Alba Merovci

Studentja e UBT-së në Televizionin Publik të Kosovës

Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Alba Merovci, me përfundimin e vitit të tretë të studimeve është punësuar në Radio Televizionin e Kosovës, i vetmi transmetues publik në vend.

Merovci ka theksuar se falë UBT-së për përgatitjet profesionale, studentët e këtij drejtimi janë sistemuar dhe janë të gatshëm për tregun e punës.

“Pas mbarimit të ligjëratave në ‘Media dhe Komunikim’, unë u angazhova dhe u bëra pjesë e Radio Televizionit të Kosovës (RTK). Ëndërr e secilit për të punuar në një medium prestigjioz, i cili përveç shikueshmërisë gëzon edhe besueshmërinë e publikut”, ka thënë ajo.

Ndërkaq, Merovci ka shprehur falënderime të veçantë për gjithë stafin e UBT-së, posaçërisht profesorëve me të cilët kanë ndarë tre vjet së bashku, duke shkëmbyer diturinë dhe eksperiencat e tyre me përkushtim maksimal.

Sikurse në drejtime të tjera ashtu edhe në drejtimin e gazetarisë, UBT vazhdon të sistemojë në treg gazetarë të rinj, entuziastë dhe të suksesshëm për punën që e bëjnë.



“UBT po e kompletion gjithnjë e më shumë infrastrukturën me objekte e laboratorë unikat”: Armend Muja, drejtor për çështje akademike në UBT

Suksesi i studentes së Medias dhe Komunikimi

Fatbardhë Kiqina fiton çmimin prestigjioz në garën e organizuar nga UNICEF Innovations Lab Kosovo

Gara është mbajtur në kuadër të punëtorisë “PONDER”, për ngritjen e nivelit të menduarit kritik, që është organizuar gjatë muajit tetor të vitit të kaluar, me ç’rast studentja Kiqina u përzgjedh në mesin e 300 të rinjve që kishin aplikuar

Studentja e vitit të dytë në Media dhe Komunikim në UBT, Fatbardhë Kiqina është shpërblyer me çmimin “Artikulli më i mirë informativ”, në Garën e kritikëve të rinj, organizuar nga UNICEF Innovations Lab Kosovo.

Gara është mbajtur në kuadër të punëtorisë “PONDER”, për ngritjen e nivelit të menduarit kritik, që është organizuar gjatë muajit tetor të vitit të kaluar, me ç’rast studentja Kiqina u përzgjedh në mesin e 300 të rinjve që kishin aplikuar.

Kiqina tha se çmimi i fituar është shpërblim i punës dhe mbështetjes së madhe që profesorët e gazetarisë e bëjnë me studentët e këtij drejtimi.

“Sukseset vijnë vetëm atëherë kur dashuria e madhe për profesionin bashkohet me mbështetjen dhe angazhimin e profesorëve, të cilët shërbejnë jo vetëm si model dhe shembull në aspektin profesional, por edhe në atë jetësor”, u shpreh ajo.

Dekani i Fakultetit të Medias dhe Komunikimit në UBT, prof. dr Ferid Selimi tha se të konkurrosh me një ose më tepër punime në një garë me një mori krijuesish dhe të dalësh ndër fituesit e parë të çmimeve të ndara në atë garë është një satisfaksion i krejt asaj që ke bërë ose që bën.

“Kur një studente, përkatësisht Fatbardha, që mbase fillet e para të studimit të gazetarisë dhe të mendimit kritik i ka nisur në UBT, arrin një sukses, s’ka sesi të mos na gëzojë edhe neve që japim mësim ose që i kemi dhënë mësim”, theksoi Selimi, i cili duke folur në cilësinë e ligjëruesit, potencoi se “është një kënaqësi e veçantë kur dëgjon për sukseset e një studenti që e ke njohur, e njeh ose që mbase ke qenë pjesë e ndërtimit dhe mendimit të tij”.

Tutje, Selimi, duke i inkurajuar studentët që të punojnë për të arritur profesionalizmin, tha se sukcesi është sa i studentes, po aq edhe i UBT-së, sepse sipas tij, UBT i ka krijuar kushte, që ajo të zhvillojë talentin e saj si në të shkruar ashtu edhe në të gjykuar.

“UBT ofron kushte dhe kuadro të përgatitura, për studentët, prandaj porosia ime për

të dhe për të gjithë studentët është që të mos ndalen së punuari, sepse kriteri i vetëm, i pari e i fundit për t’u bërë i suksesshëm në jetë, është ai i të punuarit”, përfundoi dr.Selimi.

Edhe ligjëruesi në Fakultetin e Medias dhe Komunikimit, Ganimet Klaiqi tha se çmimi që studentja Fatbardhë Kiqina e ka fituar tregon se në UBT, të gjithë ata që duan të arrijnë rezultate, kanë mundësi të mrekullueshme.

“Fatbardha, ndërkaq, si edhe shumë të tjerë, e ka po atë synim, që të bëhet një gazetarë e devotshme - paraqitjen reale të informacioneve. Fatbardhës i uroj shumë suksese, ndërsa shpreh dëshirën që raste të këtilla të na përsëriten, aq më tepër kur UBT-ja gradualisht po shndërrohet në akademi të gazetarisë në rajon dhe më gjerë”, tha Klaiqi duke shkruar se “ajo është një shembull për perspektivën e gazetarisë, që duhet ndjekur edhe nga të tjerët”.



“Çmimi i fituar është shpërblim i punës dhe mbështetjes së madhe që profesorët e gazetarisë e bëjnë me studentët e këtij drejtimi”: Fatbardhë Kiqina

Hana Qerimi

Studentja ambicioze e UBT-së, ndërmarrëse e suksesshme



Hana Qerimi sot është një nga ndërmarrëset e reja në tregun e biznesit në Kosovë

Hana Qerimi është studente e UBT-së, e cila ka përfunduar suksesshëm studimet themelore në fakultetin për Menaxhim Biznesi dhe Administrim. Në kohën e studimeve në UBT, ajo ka punuar fillimisht në kompaninë “3CIS”, ku ka menaxhuar projekte dhe programe globale për afër 6 vjet.

Ajo sot është një nga ndërmarrëset e reja në tregun e biznesit në Kosovë. Rreth dy vjet më parë, Hana ka hapur “Shkollën Digjitale”, që është institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, si dhe është shkolla e parë e hapur në Prishtinë dhe Ferizaj, ku ofron kurse të teknologjisë informative për fëmijët e moshave të reja dhe që mbledh rreth 600 nxënës.

Sipas saj, planprogrami me të cilin funksionon kjo shkollë, është planprogram i përpiluar nga organizata “Code” si dhe “Massachusetts Institute of Technology”, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo theksoi se mbështetjet e mirë dhe të vazhdueshme, kanë edhe nga

korporatat si Microsoft dhe Google.

“Është planprogram i dedikuar për mësimin e fëmijëve, i cili i plotëson të gjitha standardet e nevojshme, është inkuadruar si planprogram i rregullt në shkollat fillore të Amerikës dhe Britanisë së Madhe. Pas përfundimit të leksioneve teorike e praktike, në fund fëmijët certifikohen me titullin Junior Programmer”, ka bërë të ditur ajo. Tutje ajo shtoi se nevoja për hapjen e kësaj shkolle, ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së një planprogrami të tillë në shkollat fillore të Kosovës.

“Gjatë këtyre niveleve fëmijët mësojnë konceptet bazë të programimit dhe njohuri të përgjithshme të teknologjisë informative. Fëmijët mësojnë logjikën e koncepteve të programimit, si algoritmet, programet, ndërtimin e robotëve, aplikacioneve mobile, elektronike”, ka thënë ajo. Derisa qëllimi kryesor i kësaj shkolle është zhvillimi i gjeneratave të reja në fushën e teknologjisë informative, si dhe zhvillimi i programeve teknologjike.

Flet Besnik Qehaja

Mësimdhënës në UBT dhe doktorant në Universitetin Corvinus në Budapest

“Në vitin e dytë të studimeve në nivelin bachelor, kam fituar mundësinë e internshipit në UBT, kurse pas saj, me financimin e UBT-së vazhdova nivelin master dhe atë të doktoratës. E gjithë merita për suksesin tim, shkon për UBT-në, respektivisht për rektorin e këtij institucioni, prof. dr Edmond Hajrizi”

Ish-studenti i UBT-së, tash asistent në disa lëndë në drejtimin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Besnik Qehaja, në një intervistë, tha se UBT i ka ndihmuar të kuptojë anën shkencore, si dhe e ka mbështetur në ngritjen e nivelit akademik. Arritjen e tij, Qehaja ia ka atribuuar rektorit të UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizit, i cili sipas tij, i mbështet të gjithë studentët, tek të cilët shih potencial.

UBT News: Si keni vendosur të studioni në UBT?
Qehaja: Pas kthimit tim nga Zvicra, vendosa të studioj në UBT, pasi që ishte institucion me reputacion dhe ma rekomanduan studentët që tashmë ishin pjesë e UBT-së. Krahas kësaj, gjithmonë kam pasur dëshirë të studioj në drejtimin e Shkencave kompjuterike, për shkak se puna ime ishte e lidhur me këtë drejtim.

UBT News: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?
Qehaja: Ngjarja me rëndësishme gjatë periudhës së studimeve ishte kur qysh në vitin e dytë më rekomanduan për internship brenda UBT-së, dhe po ashtu në ato ditë mora pjesë edhe në konferencën e Durrësit, me ç’rast ishte hera e parë që, si student arrita të jem pjesë e një konference të tillë.

UBT News: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?
Qehaja: Përfitimet janë të mëdha, sidomos në pjesën teorike, pasi që në pjesën praktike veç isha i përgatitur. Gjatë studimeve, përkushtimi dhe bashkëpunimi rezultoi në marrjen e një bagazhi të madh të dijes.
UBT News: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-

së, internship apo forma të tjera të angazhimit?
Qehaja: Në vitin e dytë të studimeve në nivelin bachelor, kam fituar mundësinë e internshipit në UBT, kurse pas saj, me financimin e UBT-së vazhdova nivelin master dhe atë të doktoratës. E gjithë merita për suksesin tim, shkon për UBT-në, respektivisht për rektorin e këtij institucioni, prof. dr Edmond Hajrizi
UBT News: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?
Qehaja: Me përkushtim dhe interesim të madh, sidomos në nivelin bachelor, pasi që shumë shpesh kam ndjekur ushtrime dhe tutorim nga dy herë për një lëndë, për të vetmen arsye që dija dhe mundësia që më është dhënë, të shfrytëzohet.
UBT News: A jeni duke punuar dhe ku?
Qehaja: Me mundësinë që më është dhënë nga UBT, tash e pesë vite jam pjesë e UBT-së dhe jam shumë i privilegjuar që punoj në institucionin, i cili ma ka treguar rrugëtimin drejt suksesit, pikërisht për këtë arsye punoj me përkushtimin më të madh dhe ndjej përgjegjësi ndaj punës që e bëj.
Alumni: Çfarë pune bëni?
Qehaja: Unë jam asistent për lëndët që kanë të bëjnë me Rrjetet Kompjuterike, si dhe jam pjesë e stafit të brendshëm në kuadër të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, me ç’rast kontribuoj shumë në pjesën administrative



Studimet themelore dhe bachelor në UBT, doktoratën, falë UBT-së, në Universitetin Corvinus në Budapest: Besnik Qehaja

për studentët dhe fakultetin.
UBT News: A jeni duke vazhduar studimet?
Qehaja: Studimet e doktoratës jam duke i vazhduar në Hungari, në Corvinus University of Budapest, falë UBT-së. Drejtimi ka të bëjë me informatikën dhe biznesin, teksa tash jam në semestrin e parë dhe deri më tash kam bërë dy publikime, që janë pranuar nga universiteti, si dhe i kam dhënë edhe dy provime, të cilat unë i mbaj në UBT dhe që më janë pranuar në Universitetin e Budapestit, ku unë po i vijoj studimet.

Ema Këpuska

UBT - mundësia më e mirë për të mësuar për t’u përgatitur për tregun e ICT-së

“Duke marrë parasysh faktin se teknologjia është gjithmonë në zhvillim dhe vajzat në Kosovë vetëm sa kanë filluar të inkuadrohen në botën e teknologjisë, mundësia për të mësuar këto risi dhe për t’u përgatitur për tregun e ICT-së, është dhënë vetëm në kuadër të UBT-së”.



“Ndikim të lartë e kanë pasur profesorët, që janë marrë me studentët për çdo problem që ata kanë hasur gjatë studimeve, duke dhënë shembuj praktikë, si dhe duke shfrytëzuar literaturën adekuate për lëndët përkatëse”: Ema Këpuska

Ish-studentja e UBT-së në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, tash pjesë e stafit akademik të këtij institucioni, Ema Këpuska, ka treguar për përvojën dhe ndjenjën e të punuarit në një institucion të arsimit të lartë, menjëherë pas përfundimit të studimeve, me ç’rast është shprehur se ndihet e privilegjuar që i është dhënë mundësia të ndihmojë studentët e tjerë, përmes orëve shtesë të tutorimit.
UBT News: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Këpuska: Vendimi për të studiuar në UBT ka ardhur për shkak të dëshirës të madhe për t’u marrë me probleme inxhinierike dhe për të qenë në hap me zhvillimet moderne teknologjike.
Duke marrë parasysh faktin se teknologjia është gjithmonë në zhvillim dhe vajzat në Kosovë vetëm sa kanë filluar të inkuadrohen në botën e teknologjisë, mundësia për të mësuar këto risi dhe për t’u përgatitur për tregun e ICT-së, është dhënë vetëm në kuadër të UBT-së.
UBT News: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?
Këpuska: Dita e diplomimit është njëra nga ngjarjet më të rëndësishme që kam përjetuar gjatë studimeve në UBT. Në këtë ditë, ëndrra për të përfunduar studimet në një institucion të njohur ndërkombëtarisht, si dhe për të dalë nga këtu si një person i kualifikuar për industri në fushën e shkencës, është bërë realitet.
UBT News: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?
Këpuska: Gjatë studimeve në UBT, unë si studente kam përfituar shumë në lëmi të ndryshme. Duke filluar prej zgjerimit të dijenive në fusha të caktuara, si dhe përgatitje profesionale nga një numër i madh i profesorëve. Në këtë aspekt, secili nga profesorët është munduar të na bëjë studimet më atraktive dhe të na përgatisë për të ardhmen. Nga UBT-ja kam përfituar shumë, duke nënkuptuar këtu edukimin profesional, si edhe edukatën e punës.
UBT News: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?
Këpuska: Si alumni i UBT-së, apo si një studente që ka

përfunduar studimet në këtë institucion, më janë ofruar shumë internshipe (punë praktike) nga kompani të mëdha. Njëra ndër kompanitë që kam punuar në kuadër të UBT-së, ka qenë kompania PECB. Gjithashtu, kam marrë pjesë në shumë projekte që më kanë konsideruar si kandidate shumë të fortë, duke marrë parasysh faktin që kam një prapavijë të fortë edukative.
UBT News: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?
Këpuska: Rezultatet e mira gjatë studimeve janë arritur falë bashkëpunimit me profesorët, si dhe punës në grupe me studentë të tjerë, të angazhuar për të arritur sukses. Ndikim të lartë e kanë pasur profesorët, që janë marrë me studentët për çdo problem që ata kanë hasur gjatë studimeve, duke dhënë shembuj praktikë, si dhe duke shfrytëzuar literaturën adekuate për lëndët përkatëse.
Motivimi më i madh gjatë këtyre viteve të studimit për mua ka qenë puna e palodhshme e profesorëve për të na përgatitur për të ardhmen në fushën e shkencës, atmosfera e ofruar për studime dhe përpjekjet personale për t’u aftësuar për një karrierë me prosperitet në të ardhmen.
UBT News: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?
Këpuska: Po, jam punësuar në UBT.
UBT News: Çfarë pune bëni?
Këpuska: Unë jam e angazhuar në UBT për tutorim në lëndën “Baza e të dhënave”, ndërkaq gjithashtu jam pjesë e ekipit zhvillues.
Në rolin e tutorimit kam punë të ndryshme, siç janë: ndihma e ofruar nga unë për asistentët e lëndës gjatë ushtrimeve, si dhe ushtrimet shtesë me studentët që kanë pasur probleme në kuptimin e terminologjisë dhe punëve praktike.

Jonida Xhema

Më e mira e gjeneratës, e angazhuar në UBT

“Një prej ngjarjeve më të rëndësishme për mua, ishte fjalimi në Ceremoninë e Diplomimit. Ky moment kishte rëndësi për mua pasi që, duke qenë studentja më e dalluar e gjeneratës, isha zgjedhur të mbaja fjalimin para kolegëve, profesorëve dhe familjarëve”.

Jonida Xhema, si pjesë e intershipit të UBT-së nga fakulteti i MBE-së, në një intervistë ka folur për vitet e studimit në UBT, për mundësitë, përvojat dhe rezultatet e arritura gjatë kësaj kohe. Ndër tjerash, ajo ka treguar për ndjenjën e të qenit studentja më e dalluar e gjeneratës së saj, ku në Ceremoninë e Diplomimit kishte mbajtur edhe fjalim falënderues.

UBT News: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Xhema: Vendimi për të studiuar në UBT nuk ishte i vështirë për mua, pasi që kam njohur disa persona që ishin duke studiuar në UBT dhe prej tyre kisha kuptuar mundësitë e mëdha që kjo e fundit kishte për studentët e saj, duke përfshirë kualitetin e programeve të studimit, intershipet, udhëtimet studimore, ligjëratat e ndryshme tematike, si dhe studimet jashtë vendit.

UBT News: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Xhema: Bashkëpunimi me kolegët në projekte, prezantime, si dhe debate të ndryshme kanë ndikuar që koha gjatë studimeve në UBT të jetë shumë e rëndësishme.

Vlen të theksohet se një prej ngjarjeve më të rëndësishme për mua, ishte fjalimi në Ceremoninë e Diplomimit. Ky moment kishte rëndësi për mua pasi që, duke qenë studentja më e dalluar e gjeneratës, isha zgjedhur të mbaja fjalimin para kolegëve, profesorëve dhe familjarëve. Ishte një ditë shumë e veçantë, ku kisha rastin të falënderoja UBT-në për të gjitha mundësitë që më kishte ofruar mua dhe kolegëve gjatë viteve të studimit, për përgatitjen teknike dhe ndërpersonale, për atë që na priste pas studimeve, si dhe për faktin që ishte bërë si një shtëpi e dytë për ne.

UBT News: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Xhema: Programet e studimit në UBT më kanë ndihmuar në dy aspekte. Së pari, ana teknike të cilën UBT-ja e ka ofruar, materialet, si dhe kualiteti i lartë i programit të studimeve, kanë ndikuar që të jem më se e përgatitur për tregun e punës. Së dyti, interaktiviteti në mes profesorëve dhe studentëve, projektet dhe seminarët e ndryshme si dhe prezantimet, kanë ndikuar në përvetësimin e aftësive ndërpersonale, si dhe në zhvillimin e aftësive komunikuese.

UBT News: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, intership apo forma të tjera të angazhimit?

Xhema: Nga mundësitë që ofron UBT-ja për udhëtimet studimore, studimet jashtë vendi apo format tjera të angazhimit, kam pasur mundësinë të jem pjesë e një prej forumeve më të rëndësishme evropiane, Forumi Evropian në Alpbach. Kjo ishte një prej ngjarjeve më të rëndësishme gjatë studimeve të vitit të dytë, ku duke pasur një notë mesatare të lartë, isha zgjedhur nga UBT-ja që të marrë pjesë në Forumin Evropian në Alpbach (EFA). Bursa të cilën kisha fituar nga UBT-ja më mundësoi që të jem pjesë e këtij forumi të shkencës, politikës, biznesit dhe kulturës, i cili është themeluar më 1945. Ky Forum Evropian kishte rëndësi për mua pasi që kam krijuar lidhje ndërkombëtare me persona nga vende të ndryshme të Evropës. Tema të ndryshme, ligjëratat nga njerëz të suksesshëm të Austrisë, debate të gjata me persona nga vende të ndryshme të Evropës, vizita në disa prej vendeve më të bukura të Alpbach-ut si dhe njohuritë që fitova gjatë këtij forumi, ishin gjërat që e bënë këtë, njërin prej përvojave më të mira gjatë tri viteve të studimeve. E gjithë kjo eksperiencë që fitova nga ky Forum Evropian, ishte falë UBT-së.

UBT News: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Xhema: Rezultatet që kisha gjatë tri viteve të studimeve ishin falë punës së madhe, interesimit që kam shfaqur, si dhe mundësive që UBT-ja ka ofruar.

Kam shfaqur interesim për aktivitetet e ndryshme që UBT-ja ka ofruar, ligjëratat e ndryshme tematike, si dhe kam marrë pjesë në projekte që nuk ishin vetëm pjesë e lëndëve përkatese. Rezultatet e mira, poashtu, ishin për shkak të programit që UBT-ja ofron për studentë duke pasur qasje në seminare, projekte, detyra të ndryshme dhe prezantime.

Ligjëratat tematike të mbajtura nga persona të rëndësishëm në Kosovë dhe jashtë saj ndikuan në zgjerimin e njohurive të mia, si dhe në shfrytëzimin e këtyre njohurive, për të pasur rezultate më të mira gjatë studimeve.



“Ligjëratat tematike të mbajtura nga persona të rëndësishëm në Kosovë dhe jashtë saj ndikuan në zgjerimin e njohurive të mia, si dhe në shfrytëzimin e këtyre njohurive, për të pasur rezultate më të mira gjatë studimeve”: Jonida Xhema

Nuk duhet harruar se puna e pandalshme, si gjatë ligjëratave, ashtu edhe jashtë tyre, ka ndikuar në rezultatet pozitive që kisha gjatë studimeve të nivelit bachelor.

UBT News: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Xhema: Pas studimeve kam filluar ‘internship-in’ (praktikën) në UBT, e orientuar kryesisht në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi.

Si praktikante, ndihmoj në disa aktivitete që lidhen me koordinimin e Fakultetit MBE, si dhe me regjistrimin dhe analizën e vijueshmërisë së studentëve të këtij fakulteti në ligjëratat.

UBT News: A jeni duke vazhduar studimet?

Xhema: Pas përfundimit të studimeve të nivelit bachelor, kam vazhduar studimet master në UBT. Jam në drejtimin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, ku më vonë jam e interesuar për Marketing dhe Shitje. Vendimi për të vazhduar studimet e nivelit master në UBT, ishte për shkak të kualitetit të lartë të programeve të studimit që UBT-ja ofron për studentët e saj, studimeve jashtë vendit, udhëtimeve studimore, si dhe angazhimeve tjera që kanë rëndësi në jetën studentore.

Zgjerohet bashkëpunimi ndërkombëtar

UBT bën marrëveshje bashkëpunimi me “Staffordshire University” të Anglisë

Falë krijimit të imazhit të shkëlqyeshëm të partneritetit të UBT-së me universitetet ndërkombëtare, studentët e nivelit Master të UBT-së, do të mund të fitojnë bursa semestrale nga Universiteti “Staffordshire University” i Anglisë, në kuadër të Programit Erasmus +. UBT ka bërë marrëveshje bashkëpunimi me këtë universitet. Sipas rektorit të UBT-së, prof. d. Edmond Hajrizi, marrëveshja përfshin edhe shkëmbimin e përvojave të stafit akademik, si dhe do të rrisë ndërkombëtarizimin me universitetet angleze. Kjo marrëveshje është mundësuar nga “Erasmus+ International Credit Mobility” si dhe financohet nga Erasmus UK.

Mbikëqyrur nga profesorët e Universitetit të Shkencave të aplikuara “Van Hall Larenstein” të Holandës

U mbajt punëtoria njëjavore “Dizajni i hapësirës në Kampusin e UBT-së”

Me një atmosferë pune dhe plot dinamikë, të premtën në UBT Campus, në Lipjan, ka përfunduar punëtoria njëjavore “Dizajni i hapësirës në Kampusin e UBT-së”. Në përmbyllje të punëtorisë, e cila gjatë një jave është tutoruar nga profesorët e Universitetit të Shkencave të aplikuara “Van Hall Larenstein” të Holandës, Ad Koolen dhe Jan Roozenbeek, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, ka inkurajuar studentët për aktivitetin e tyre. Ai u shpreh krenar dhe i motivuar për të investuar edhe më shumë. “Nga rezultatet tuaja, të treguara në këtë punëtori, jam motivuar akoma më shumë për të sjellë në UBT investime dhe modele të reja të dobishme”, u tha Hajrizi studentëve. Rektori vlerësoi se fokusi i kësaj punëtorie ka qenë tek marrja e ideve, për të reflektuar mbi nevojat dhe dëshirat e studentëve. “Ne kemi për qëllim që të krijojmë një baraspeshë mes interesimit të studentëve dhe nevojës për të ndërtuar diçka unike dhe të shfrytëzueshme”, shtoi Hajrizi. Gjatë kësaj punëtorie, studentët punuan në realizimin e projekteve, që kishin të bënin me përpunimin e një dizajni të hapësirës së Kampusit të UBT-së.

Projektet inovative përfshijnë shfrytëzimin e resurseve të energjisë së ripërtëritshme , për të reduktuar koston e harxhimeve, pastaj rregullimin e parkingjeve, mënyrën e ndarjes së mbeturinave për riciklim, krijimin e hapësirave rekreative dhe sipërfaqeve të gjelbëruara etj. Profesorët Koolen dhe Roozenbeek u shprehën të impresionuar nga njohuritë dhe angazhimi i studentëve. “Gjatë kësaj punëtorie, studentët kanë qenë shumë të angazhuar, bashkëpunues dhe ndihmues”, theksoi profesori Roozenbeek. Ndërkaq, duke folur për UBT-në, profesori Koolen tha se ky institucion po i përgatit studentët për funksionimin dhe integrimin e arkitekturës dhe llojeve të ndryshme të energjisë, në shfrytëzim të përditshëm. “Studentët e UBT-së nuk mendojnë vetëm për vizatimet e mira, por edhe për ekonominë, funksionimin, si dhe aspektet sociale të integritetit të projekteve e të ideve të tyre në jetën e përditshme”, përfundoi Koolen. Pas prezantimeve të studentëve, nën përcjelljen e rektorit Hajrizi, profesorët holandezë vizituan objektin e ri të UBT-së, i cili është në fazën e ndërtimit.

UBT kontribuon për komunitetin

Studentët e UBT-së ndihmojnë krijimin e brendit të Vushtrrisë

Njomza Sylja e Muhamet Jashanica janë dy studentë të Departamentit të arkitekturës në UBT, të cilët ditëve të fundit kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në krijimin e brendit të komunës së Vushtrrisë. Studentët UBT-së i janë bashkuar organizatës “Qendra kosovare për hulumtime urbane”, duke dhënë kështu kontributin maksimal për brendin e Vushtrrisë. Studentët e angazhuar thonë se UBT është institucioni arsimor, që krijon mundësi për secilin për të shfaqur talentin dhe profesionalizmin. “Jam ndier shumë mirë që kam pas mundësi të japë kontributin tim në krijimin e brendit të qytetit tim. Studimet në UBT na kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë për ta shfaqur përvojën tonë “, tregon studentja Njomza Sylja. Po aq i kënaqur me UBT-në është edhe studenti tjetër i angazhuar për brendin e Vushtrrisë. “Gjatë studimeve në UBT kemi arritur të mësojmë mënyra të prezantimit, se si një prezantim të paraqitet suksesshëm. Gjërat e mësuara i kemi zbatuar në praktikë, në krijimin e këtij brendi. Andaj UBT është vend që krijon mundësi të shumta, që studenti t’i tregojë aftësitë në fusha të ndryshme”, thotë Muhamet Jashanica. Edhe profesoresha Sadije Deliu-Kelmendi, tregoi se studentët e UBT-së kanë dhënë një kontribut të madh në krijimin e brendit të komunës së Vushtrrisë. Ajo thotë se studentët kanë marrë pjesë në secilën punëtori, duke qenë të devotshëm dhe kreativë.

Konferenca e dytë “Albanian Security Forum” në Tiranë

UBT-CERT prezanton aktivitetet në Konferencën e dytë “Albanian Security Forum”

Përfaqësuar nga menaxheri Atdhe Buja dhe Betim Gashi, UBT CERT, ka marrë pjesë me Konferencën e dytë “Albanian Security Forum”, hapjen e të cilës e ka bërë ministrja e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Mimi Kodheli. Konferenca është organizuar nga kompania BiZZ SHPK. Në emër të UBT CERT-it, në konferencë u paraqit menaxheri, Atdhe Buja, i cili prezantoi punën dhe angazhimin që po bën ky CERT i UBT-së, i cili është i certifikuar edhe ndërkombëtarisht. Sipas organizatorëve, konferenca kishte për qëllim të nxjerrë në pah peizazhin e kërcënimeve aktuale, strategjitë, metodat e zgjidhjeve, menaxhimin dhe trajtimin e rreziqeve të bazuar në triptikun: Teknologji – Njerëz – Procese. Po ashtu, kishte në fokus çështje të rëndësishme me të cilat përballen profesionistë në fushën e sigurisë – por edhe më gjerë, në jetën politike dhe sociale – të tilla si sfidat e reja të epokës së kimit kibernetik dhe kërcënimet teknologjike (drone, survejimi AV, etj.) por edhe rrjedha e madhe e emigrimit në rajon, format e reja të terrorizmit si dhe krimi i përditshëm. Menaxheri i UBT-CERT-it, Atdhe Buja, ndërkaq, ka thënë se UBT si institucion i arsimit të lartë në Kosovë, ka themeluar UBT-CERT, që merret me trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe rasteve, qe kanë të bëjnë me aspektin e sigurisë kibernetike.

“Kontributi ynë shfaqet përmes programeve të edukimit, në aspektin e kërkimit dhe zhvillimit, të ofrimit të strategjive dhe politikave në aspektin e sigurisë dhe privatësisë”, ka thënë ai, për të shtuar se UBT-CERT është në kuadër të CSP-së , një institucion brenda UBT-së. “Jemi bazuar në modelin akademik të Agjencisë evropiane për rrjet dhe siguri të informacionit”, ka shtuar Buja me sqarimin se UBT - CERT ka bashkëpunim me CERT-e të tjera qeveritare, si dhe me CERT-in nga Shqipëria. “Synojmë anëtarësimin ndërkombëtar në organizata të mëdha evropiane e botërore, si organizata “FIRST”. Kemi ngritur një platformë dhe kemi krijuar një sistem për pranimin dhe regjistrimin e incidenteve të sigurisë kibernetike, ku përmes platformave online mundësojmë vetëshërbim, si dhe kemi sistemin e ndërgjegjësimit për siguri kibernetike, ku shpërndajmë informacion për komunitetin dhe studentët për lëshimet e sigurisë kibernetike”, ka thënë ndër të tjera Buja. Nga kjo pjesëmarrje UBT-CERT ka krijuar kontakte me shumë institucione qeveritare dhe private në Shqipëri. “Të gjithë u zotuan për bashkëpunim dhe zgjerim të partneritetit, si me “Protik”, “tech-360grade”, studentë të Shkencave Kompjuterike e të Informacionit në Tiranë, “Bizz SHPK” etj.

Në Kampusin e UBT-së, në Lipjan

Profesorët nga Gjeneva ligjëruan temën: “Arkitektura dhe urbanizimi nga Gjeneva në Prishtinë”

Gjatë kësaj ligjërate, profesorët e arkitekturës, Sigfrido Lezzi, Christophe Piguet dhe Arnaud North, nga Gjeneva, prezantuan sfidat, vështirësitë dhe përgjegjësitë e këtij profesioni

Në Kampusin e UBT-së, në Lipjan u mbajt ligjërata tematike: “Arkitektura dhe urbanizimi nga Gjeneva në Prishtinë”, organizuar nga UBT dhe Shoqata e Miqësisë Franko-Shqiptare.

Në hyrje, dekani i Arkitekturës në UBT, prof. dr Lulzim Beqiri tha se sjellja e përvojave të arkitektëve ndërkombëtarë ofron një ndihmë të madhe për studentët e UBT-së.

“Studentët tanë kanë nevojë që të njihen me arkitekturën dhe mënyrën organizimit e të ndërtimit të objekteve nëpër vendet evropiane dhe mbi të gjitha, të mësojnë prej tyre”, u shpreh Beqiri, për të shtuar se, “UBT tenton vazhdimisht të mbajë lidhje në fushën akademike e kulturore me viset frankofone”.

Presidenti i Shoqatës Franko-Shqiptare, Tahir Shabani,

ndërkaq, tha se qëllimi i tyre është që ta ndërkombëtarizojnë çështjen e Kosovës, në mënyrë që të hapin rrugë dhe mundësi të reja për studentët.

“Njohja me mënyrën e trajtimit të fushave të ndryshme nëpër vende të ndryshme, ndikon në marrjen e përvojave të reja për studentët tanë”, theksoi Tahiri.

Gjatë kësaj ligjërate, profesorët e arkitekturës, Sigfrido Lezzi, Christophe Piguet dhe Arnaud North, nga Gjeneva, prezantuan sfidat, vështirësitë dhe përgjegjësitë e këtij profesioni.

“Puna e arkitektëve kërkon durim, pasion dhe dinamikë të punës”, vlerësoi profesori Lezzi.

Ata treguan që, në Gjenevë ka një numër të madh të objekteve të lashta dhe të pashfrytëzuara.

“Qëllimi i planeve tona është që t’i shfrytëzojmë ndërtesat e vjetra, përmes konceptit arkitekturor dhe t’i fusim ato në shfrytëzim të të gjithëve”, potencoi profesori Piguet.

Duke shfaqur projektet e tyre arkitekturore, që kryesisht kishin të bënin me planifikimin e ndërtimit të shtëpive të të moshuarve dhe spitaleve, ata prezantuan para studentëve detajet e ndërtimit, planet, organizimin e punës, hapësirën, dhomat, pamjet, shëtitoret, klinikën mjekësore, si dhe tërë infrastrukturën përcjellëse brenda objekteve përkatëse, të dizajnuara prej tyre.

Ligjërata tematike e profesorëve Lezzi, Piguet dhe North, përfundoi me një debat, në të cilin u angazhuan profesorët dhe studentët e arkitekturës, të interesuar për të ditur më tepër në lidhje me stilin e ndërtimit zviceran.

Në shumë drejtime të studimit

UBT ruan primatin e liderit në rajon - përgatit studentët për tregun e punës

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë i Universitetit për Biznes e Teknologji (UBT), duke pasur programet studimore më të harmonizuara në rajon, përmes të cilës është ndërlidhur pjesa teorike me atë praktike, po vazhdon ta ruajë primatin e liderit në rajon, duke i përgatitur studentët për tregun e punës.

Ligjëruesi në këtë fakultet, PhD Cand. Besnik Qehaja, thotë se kushtet maksimalisht të mira për studim në UBT, me laboratorë bashkëkohorë e praktikë, po ua bëjnë atyre shumë më të lehtë përgatitjen e studentëve për tregun e punës në të ardhmen.

Ai thekson se, që në semestrin e parë, studentët fillojnë me ushtrime praktike, duke u aftësuar për pjesën harduerike të kompjuterëve.

Kështu për shembull, në Lëndën Bazat e Teknologjisë Informative, studentët gjatë ushtrimeve praktike, mësojnë në detaje për të gjitha pjesët harduerike, montimin e atyre pjesëve në shtëpiza kompjuterike si dhe funksionalizimin e tyre.

Në këtë kuptim, Qehaja flet në superlativ për laboratorët e UBT-së.

“Janë vërtet laboratorë bashkëkohorë, që ofrojnë hapësira të mjaftueshme për studentët”, ka vijuar ai, krenar me faktin që UBT është lider rajonal në Shkenca Kompjuterike dhe në Sisteme të Informacionit.

Menaxher i Proogramit ë SHKI, PhD Cand. Blerton Abazi, flet për ndërlidhjen e mësimdhënies me nevojat e tregut dhe të industrisë.

“Ne i ofrojmë studentët më tregun e punës, përmes mësimit praktik, që bëhet në hapësirat më të mirë dhe në laboratorët më të pasur në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit”, është shprehur Abazi, sipas të cilit nëpërmjet ushtrimeve praktike synohet që njohuritë e fituara gjatë studimeve t’u ndihmojnë për t’u përballur me probleme dhe sfida reale, të cilat mund t’u paraqiten në ambientet e punës. Se laboratorët për studentët e Shkencave Kompjuterike janë me standarde të larta dhe kanë hapësirë të mjaftueshme, e ka vërtetuar edhe studenti në këtë drejtim, Lend Muhaxheri.

“Puna praktike vazhdon shumë mirë. Kemi kurse laboratorike pas ligjëratave dhe kemi hapësirë shumë të mirë për ta përvetësuar lëndën”, ka thënë Muhaxheri për të shtuar se me këtë po u krijohen lehtësira të mëdha për profesionin e zgjedhur. Ai falënderon tutorët dhe asistentët për angazhimin e madh.

“Asistentët dhe tutorët na ndihmojnë shumë për zhvillimin dhe avancimin e punës praktike dhe besoj se do të jemi të gatshëm për qasje më të lehtë në tregun e punës”, ka thënë Muhaxheri.

Edhe studenti i vitit të parë në SHKI të UBT-së, Agan Gashi, e ka të njëjtën përshtypje. Madje, ai thotë se para se të regjistrohej në UBT e kishte marrë vesh për kushtet e mira që ofron ky universitet, me laboratorë dhe me hapësirë tjetër studimi.

“Kushtet janë shumë të mira. Ligjëratën që na e shpjegon profesori e praktikojmë në laboratorë me asistentët, dhe përnjëherë e zhvillojmë edhe pjesën praktike”, ka theksuar Gashi.

Zgjerohet bashkëpunimi me universitetet nga Shqipëria

UBT e UPT nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi ndëruniversitar

Rektori i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), prof. dr. Edmond Hajrizi, ka nënshkruar, të mërkurën, marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT).

Nënshkrimin nga UPT-ja e ka hedhur prof.dr. Florian Nepravishta, dekan i Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) në këtë universitet.

Marrëveshja është nënshkruar në UBT, ndërsa në ceremoninë e nënshkrimit merrnin pjesë edhe rektori i UPT-së - prof. dr. Andrea Maliqari; zv.rektori - prof. asoc. Akli Fundo; dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) - prof.

asoc. Gëzim Hasko; zv. dekani i FAU - dr. Gjergj Islami; përgjegjësi i DA - Daniel Qamo dhe përgjegjësi i DRTA-së - Endrit Tuzi.

Marrëveshja e bashkëpunimit do të jetë pjesë e një përfitimi të përbashkët, në fusha të ndryshme, në interes të dy universiteteve.

Objektivat kryesorë të kësaj marrëveshjeje janë për promovimin kulturor, edukimin, shkëmbimin e mësimdhënies dhe bashkëpunimit maksimal të mundshëm ndërmjet dy institucioneve etj.

Fushat që përfshihen në marrëveshje parashohin vizitat

bashkëpunuese ndërmjet stafëve akademike, administrative dhe të studentëve; shkëmbimi i materialeve në edukim, kërkim shkencor; publikime dhe informime akademike; trajnime të përbashkëta teknike dhe administrative; zhvillim të përbashkët në shkëmbime kursesh, praktikash apo programesh mësimore; udhëheqje të përbashkëta doktoratash etj.

Përfaqësuesit e këtyre dy universiteteve, siç u theksua, do të specifikojnë bashkëpunimin në nivel fakultetesh të dy universiteteve.

Profesori në UBT, dr. Nexhat Balaj, ekspert i fushës së gjelbërimeve & hortikulturës urbane

Balaj: Gjelbërimi - shpëtim i qytetarëve nga ajri i ndotur

Cilësia e ajrit në Kosovë, veçanërisht në kryeqytet, vazhdon të mbetet shqetësim i qytetarëve dhe i ekspertëve që merren me çështje të ambientit.

Profesori në UBT, dr. Nexhat Balaj, njëherësh ekspert i fushës së gjelbërimeve & Hortikulturës urbane, në një intervistë dhënë Radio Campusit, ka thënë se roli i sipërfaqeve të gjelbra urbane ka ndikimin më të madh në cilësinë e mjedisit, posaçërisht në qytetet e mëdha. Në këtë segment, ai thotë se pemët urbane, pos efekteve sociale, ekonomike, estetike, ndikojnë edhe në pastrimin e ajrit nga ndotësit, të cilët tashmë janë shumë të qartë. Ndaj thekson se përkundër shtimit të sipërfaqeve të gjelbra, nga viti 2000, Kosova është shumë larg standardeve ndërkombëtare.

“Gjelbërimi në Prishtinë është rreth 2 m² për kokë banori dhe aktualisht është norma më e ulët e hapësirave të gjelbra në kryeqytetet evropiane”, ka vijuar ai, duke treguar se sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) kufiri minimal është 9 m² hapësirë e gjelbër për kokë banori.

“Gjermania, Japonia dhe vende të tjera kanë miratuar standarde deri 40 metra katrorë (m²) sipërfaqeve të gjelbra për kokë banori, në qendrat urbane, që tregon se edhe në Kosovë duhet të ndërmerren masa.

Gjelbërimi, sipas tij, krijon ekuilibër midis dyoksidit të karbonit dhe oksigjenit, për një jetë të qëndrueshme të njeriut. “Investimet në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, përveç karakterit estetik, që zbukurojnë gjithnjë e më shumë qytet-

et tona, përmirësojnë edhe cilësinë e ajrit në kryeqytet dhe gjetiu”, ka thënë Balaj, sipas të cilit me termin “sipërfaqe të gjelbra urbane” nënkuptohen parqet urbane, lulishtet, drunjatë përgjatë rrugëve dhe shesheve, shkurret dekorative etj. Shton se bimët ulin ndjeshëm temperaturat dhe rrezatimin termik, pastrojnë ajrin nga dyoksidi i karbonit, gazrat dhe pluhurat e dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe e pasurojnë atë me oksigjen; zbusin zhurmat në zonat industriale dhe pranë rrugëve automobilistike, si dhe ulin temperaturat gjatë verës.

Profesor Balaj nxjerr edhe shifra shkencore që vërtetojnë se gjelbërimi është një nga rregullatorët e ajrit.

Behar Neziraj, fitues i çmimit të ekspozitës “Student Review”

Studenti i UBT-së fiton çmimin për veprën më të mirë të arkitekturës 2015-2016

Behar Neziraj është fitues i çmimit të ekspozitës “Student Review”, në kuadër të aktivitetit “Java e Arkitekturës së Prishtinës”. Puna e studentit të UBT-së Behar Neziraj u shpall si vepra më e mirë për vitin akademik 2015-2016. Ekspozita “Student Review”, që është edicioni i 4-të në kuadër të Javës së Arkitekturës në Prishtinë, ekspozon veprat më të mira të prodhuara nga studentët e shkollave të arkitekturës në Kosovë. Ekspozita “Student Review” është më e madhja në rajon, në të cilën janë ekspozuar më shumë se 400 vepra. Sivjet për punimin më të mirë, student i UBT-së, Neziraj, ka fituar çmimin e parë, prej 500

eurosh, nga sponsori kryesor “KNAUF-Kosova”. Punimi i dytë më i mirë i përket Korab Perteshit, që ka fituar një çmim prej 400 eurosh për kurse të specializuara arkitekturë CAD nga ArchiEDU, teksa çmimi i tretë i ka takuar Ibrahim Beqiri, prej 300 eurosh për shtypjen e 3D nga Formon. Punimet e tjera, që vlen të theksohen janë: Asdren Spahija, Besmir Ajeti, Egzon Bajraktari dhe Fjolla Sillovinja nga FNA-UP; Bledar Kabashi, Agron Berisha, Arbenita Mehmeti, Besnik Morina, Dion Zeqiri, Diellza Limani, Elisa Maxhuni, Getoar Sadiku dhe Krenar Krasniqi nga AAB; Dren Nishliu, Ibrahim Kollari, Egzon Nikçi, Qendrim Begisholli, Labinot Haxha dhe Gojart Grainca nga UBT.

Vizitë e studentëve të Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji

Studentët e UBT-së u njoftuan për përpunimin e drithërave nga “M&Sillosi”

Studentët e vitit të parë të UBT-së të Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji, kanë vizituar fabrikën për përpunimin e drithërave “M&Sillosi, Devolli Corporation“, në fshatin Xërxë të Rahovecit. Vizita studimore u mundësua nga profesorët e UBT-së, Namik Durmishi dhe Gafurr Xhabiri, në kuadër të lëndës “Lënda e parë me origjinë bimore”, të mirëpritur edhe nga menaxhmenti i fabrikës. Gjatë kësaj vizite, studentët u njohën nga afër me procesin e prodhimit dhe të përpunimit të drithërave, për mënyrën e shfrytëzimit të tyre, u njoftuan me menaxhmentin e fabrikës, ndarjen e punëve, pajisjet teknologjike, laboratorët, analizat që kryhen nga kjo kompani etj. Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT është akredituar sivjet nga Agjencia Kosovare e Akreditimit, ndërsa ka grumbulluar një numër të madh studentësh, të interesuar për këtë fushë të re dhe shumë të kërkuar në Kosovë.

Shkollat profesionale

UBT hap shkollë profesionale - shton mundësitë për ata që duan të profilizohen

UBT-ja, si institucion i arsimit të lartë në Kosovë, po dëshmon gjithnjë e më shumë se është e përkushtuar që t’i ofrojë të gjitha modelet e studimit në vend. Kjo po vërtetohet edhe me hapjen e Shkollës profesionale, për të cilën nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve janë akredituar 5 profile profesionale: Teknologji e Informacionit (IT) dhe komunikim, Asistentë administrativ, Gjuhë angleze, Programim, Administrim i rrjeteve dhe Sistemet kompjuterike. Kështu, UBT-ja vazhdon të mbetet institucioni, pothuajse i vetmi në Kosovë e rajon, i cili ofron programe bashkëkohore sipas standardëve cilësore ndërkombëtare, duke përfshirë edhe profilet profesionale. UBT me akreditimin e shkollës profesionale përmbushë gati të gjitha nevojat e arsimit të lartë. Presidenti i UBT-së, prof. Dr, Edmond Hajrizi thotë se studentët e UBT-së kanë

të gjitha mundësitë për mësimnxënie, se atyre u janë ofruar mundësi të shumta, si ta zëmë përvoja studimore jashtë vendit, infrastrukturë moderne etj. Ka thënë gjithashtu se me hapjen e shkollës profesionale, UBT, është bërë e hapur për të gjithë ata që duhen të fitojnë dije. “Studentët dhe të gjithë të interesuarit, tani në UBT, mund të gjejnë gjithçka që kërkojnë. Ne vazhdimisht po punojmë për përpushjen e nevojave të studentëve tanë, si trajnime profesionale në fusha të ndryshme. Tash me shkollën profesionale është plotësuar hallka e nevojave të studentëve dhe të gjithë të interesuarve”, tha rektori Hajrizi, sipas të cilit Shkolla profesionale e kësaj natyre po krijohet për herë të parë në një institucion të arsimit të lartë në Kosovë. Rektori i UBT-së shtoi se konkursi është i hapur vazhdimisht dhe do të kenë mundësi që të aplikojnë të gjithë të

interesuarit. “Studentët të cilët përfundojnë trajnimin - shkollën profesionale të UBT-së, do të aftësohen nga stafi profesional, si dhe do të certifikohen dhe do të kenë mundësi që të qasen më lehtë në tregun e punës”, tregon rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi. Rektori Hajrizi shtoi se profilizimi i të rinjve në Kosovë është një mundësi e mirë për kualifikimin e fuqisë punëtore, rritjen e punësimit tek të rinjtë dhe zhvillimin e vendit në përgjithësi. “Atëherë, ata që përfundojnë këtë shkollë profesionale, do të janë potencial i mirë edhe për tregun e Evropës, si dhe për investitorët e huaj që vijnë në Kosovë, sepse ata janë shumë të interesuar për punëtorë të kualifikuar”, përfundoi rektori.

Ekspertë të fushave të ndryshme flasin para studentëve të UBT-së

Në UBT filloi seria e debateve për ndërmarrësi dhe inovacion

Në UBT, ashtu siç ishte paralajmëruar, ka filluar seria e debateve për lidërsip, ndërmarrësi dhe inovacion. Debatin e parë e ka hapur vetë rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, sipas të cilit, UBT është e angazhuar të mbajë kontakte të vazhdueshme me industrinë dhe tregun e punës. “Interaktiviteti mes industrisë dhe universiteteve është shumë i rëndësishëm, i nevojshëm dhe i pashmangshëm, sepse UBT përgatit kuadro karshi kërkesave të tregut”, theksoi Hajrizi. Duke i inkurajuar studentët e MBE-së për pjesëmarrje aktive në forume, debate e diskutime të organizuara, rektori shtoi se kërkesat dhe nevojat e industrisë lidhen me kualitetin dhe zhvillimin e personalitetit të studentëve. “Studentët janë potenciali, që e ka në dorë të ardhmen tonë dhe bashkë me të, edhe ekonominë e vendit”, vlerësoi Hajrizi. Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, njëherësh edhe ligjërues në UBT, Shpend Baloja tha se qëllimi i UBT-së është që përmes forumeve dhe debateve, studentët të marrin njohuri në lidhje me mundësinë e krijimit të bizneseve personale, pas diplomimit. “Studentët tanë kanë aftësi dhe potencial që të menaxhojnë biznese dhe të japin kontribut në industri”, përfundoi Baloja. Kryeshefi ekzekutiv i kompanisë “Sigal Uniqa Group Austria”, Mal Berisha, njeherësh

bartës i mëhershëm i shumë detyrave diplomatike, përfshirë edhe detyrën e ambasadorit në Mbretërinë e Bashkuar, tha se UBT është produkt i Kosovës, mirëpo sipas tij, pa të shteti do të ishte i mangët. Me shumëllojshmërinë e fakulteteve, me bagazhin e madh të sukseseve, me suksesin e alumnit dhe të studentëve aktualë, UBT ka treguar se është një pasuri e pamohueshme e këtij vendi”, theksoi Berisha. Në paraqitjen e tij, ndër tjerash ai foli për rolin e diplomacisë ekonomike, ndërlidhjen e saj në fushën e biznesit, për resurset dhe mundësitë që ofrojnë Kosova e Shqipëria për investitorët e huaj, për formën e krijimit dhe menaxhimit të bizneseve, për mënyrat e plotësimit të nevojave në tregun e punës etj. Duke folur për karrierën dhe sfidat nëpër të cilat ka kaluar gjatë jetës së tij, ai i inkurajoi studentët se me punë dhe vullnet mund të arrihet gjithçka në jetë. “Duhet të jeni ju ata që vendosni për të ardhmen tuaj dhe të qenit të suksesshëm, me përpjekje dhe punë të jashtëzakonshme”, përfundoi Berisha. Pos suksesit në biznes, pra, Mal Berisha ka shërbyer edhe si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, si Konsull i Përgjithshëm i Shqipërisë në Stamboll, si drejtues i çështjeve rajonale në MPJ-në e SHBA-ve, si dhe ka udhëhequr edhe misione të tjera diplomatike.

UBT pjesë mbështetëse e donacionit të “RoMed” për Spitalin e Prizrenit

Spitali Rajonal i Prizrenit ka 30 shtretër më shumë, falë një donacioni nga Klinika gjermane “RoMed” nga qyteti Bad Aibling, afër Rosenheimit në Gjermani.

Drejtesit e Spitalit të Prizrenit, që kanë pranuar donacionin, kanë falënderuar donatorin, spitalin RoMed dhe organizatorin e kësaj ndihme humanitare, humanistin dhe aktivistin e Shoqatës “Nëna Tereze” të Mynihut, Haqif Gashi, si dhe presidentin e UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, i cili mori përsipër të gjitha shpenzimet e transportit.

Mjeku nga Kosova Haqif Gashi, i cili ka vite që është i angazhuar në këtë klinikë, është i njohur për aktivitete humanitare edhe në Afrikë, ku me grupe mjekësh vullnetarë kryejnë aktivitete humanitare në vendet e varfra.

Në Kosovë, humanisti Haqif Gashi ka ndihmuar edhe herë të tjera. Janë disa raste kur ai bashkë me shoqatën “Nëna Tereze” në Mynih, kanë organizuar mjekimin e fëmijëve nga Kosova në Gjermani, kur trajtimi i tyre ka qenë i pamundur në Kosovë.

Ndërkaq, në vitin 2013 ai kishte sjellë në QKUK 110 shtretër spitalorë dhe shumë aparate mjekësore si donacion. Gjithashtu, 10 shtretër si donacion kishin shkuar edhe për spitalin e Tepelenës në Shqipëri.

Vlera e donacionit për spitalin e Prizrenit kalon rreth 60 mijë euro. Donacion është mbështetur edhe nga drejtuesit e Spitali RoMed, Hr. Marburger dhe Dr. Pfeiffer.



UBT-CERT nënshkroi memorandum bashkëpunimi me CERT-in nacional të Maqedonisë



Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe menaxheri i UBT-CERT, Atdhe Buja, në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit në fushën e sigurisë kibernetike, kanë zhvilluar takim me përfaqësuesit e CERT-it nacional të Republikës së Maqedonisë, me ç’rast u prit nga drejtori i Agjencionit për Komunikime Elektronike, Sasho Dimitrijoski, si dhe nga stafi i përbërë prej Aleksandar Acev e Jasmina Stojcheva.

Me qëllim të forcimit dhe rritjes së bashkëpunimit mes dy institucioneve, u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi, në të cilin u përfshinë ngritja e nivelit të sigurisë kibernetike në të dy vendet, krijimi dhe realizimi i projekteve të përbashkëta, përkrahja e analizës dhe zgjidhjes së incidenteve të sigurisë kibernetike etj.

Duke i falënderuar përfaqësuesit e CERT-it maqedonas për përkrahjen dhe ofrimin e bashkëpunimit, rektori UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se institucioni të cilin ai e drejton i jep rëndësi të madhe zhvillimit të sigurisë kibernetike, me qëllim të ndërgjegjësimit të gjeneratave të reja për këtë fushë.

“Ne si institucion i arsimit të lartë, gjithmonë e kemi pasur parasysh përgjegjësinë tonë për të gjeneruar kompetenca edukimi dhe dije në këtë fushë”, theksoi Hajrizi.

CERT-i nacional i Republikës së Maqedonisë shprehu gatishmërinë për të ndihmuar UBT-CERT-in dhe Republikën e Kosovës në rrugën e anëtarësimit në mekanizmat ndërkombëtarë për siguri kibernetike, me ç’rast, në këtë rrafsh, ofroi edhe bashkëpunim në realizimin e konferencës së tyre vjetore në këtë fushë, që do të mbahet në maj të këtij viti.

UBT-CERT është divizioni i parë me licencë ndërkombëtare për siguri kibernetike në Kosovë.

Kryeredaktori i gazetës “Blic” foli para studnetëve të UBT-së

Politika nuk mund të funksionojë pa një mekanizëm të madh mbështetës komunikues

Studentët e vitit të tretë të drejtimit Media dhe Komunikim në UBT, kanë dëgjuar ligjëratë tematike më titull “Mediat dhe politika”, nga analisti politik, njëherësh edhe kryeredaktori i gazetës “Blic”, Adrian Çollaku.

Në kuadër të kësaj ligjërate, Çollaku ka thënë se politika, sidomos në vendet e rajonit që kaluan një proces tranzicioni, nuk mund të funksionojnë pa një mekanizëm të madh mbështetës komunikues.

Ai tha se politika është e koncentruar për të ndikuar në media, në mënyrë që të krijohet opinionimi mbështetës në realizimin e programeve të tyre politike e shtetërore.

“Roli i mediave është shumë i rëndësishëm, sidomos në fushata elektorale, sepse gjatë kësaj periudhe partitë politike e kandidatët fokusohen tek mediat e rrjetet sociale, për të ndikuar në ndryshim ose formim të bindjeve partiake”, është shprehur Çollaku.

Tutje, ai vlerësoi se lidhshmëria e medias me politikën ndikon që kjo e para të publikojë vetëm aspektet pozitive të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, madje sipas tij, financimi politik ka ndikuar jashtëzakonisht që media të ndryshojë politikën editoriale.

“Kemi shpesh bashkëjetesë në mes mediave dhe politikës, publikohen vetëm aspektet pozitive të institucioneve, por jo edhe ato negative”, ka thënë Çollaku, për të shtuar se “elita shoqërore dhe ekonomike në Kosovë është shumë e heshtur për të ndikuar në opinion, në krahasim me vendet që janë në demokraci që një kohë të gjatë”.

Duke i këshilluar studentët për mënyrën e të bërit gazetari, ai konsideroi se përmes sistemit



të edukimit, rritet edhe cilësia e lexuesve, e që për këtë proces përgjegjësinë kryesore e kanë institucionet vendore.

Në fund të ligjëratës, studentët parashtruan pyetje në lidhje me profesionalizmin e mediave kosovare, ndikimin e rrjeteve sociale në ushtrimin e profesionit të gazetarisë, për etikën e gazetarëve, për dallimin e mediave vendore nga ato ndërkombëtare etj.

Konferenca më titull “Paqendërtimi në Kosovë- Transformimi i kushteve të konfliktit për paqe të qëndrueshme”,

Serbia, faktor rrezikues i paqes në Ballkan

Në kuadër të konferencës u promovua edhe libri i titulluar “Ndërtimi liberal i paqes”, i autorit Ramadan Ilazi.



Në UBT, të premten u mbajt konferenca më titull “Paqendërtimi në Kosovë- Transformimi i kushteve të konfliktit për paqe të qëndrueshme”, në kuadër të së cilës u promovua edhe libri i titulluar “Ndërtimi liberal i paqes”, i autorit Ramadan Ilazi.

Në konferencë u trajtuan faktorët destabilizues dhe cenuesit kryesorë të procesit të paqendërtimit në Kosovë dhe më gjerë, me ç’rast panelistët u pajtuan se shteti i Serbisë është njëri ndër rrezikuesit e përhershëm të paqes në Ballkan.

Rrektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se situata aktuale e krijuar në Kosovë e ka krijuar një pasiguri të madhe brenda instancave më të larta shtetërore, por edhe në popull.

“Gjendja e krijuar e ka luhatur sigurinë e përgjithshme dhe ka shkundur rrënjët e paqes së brishtë në vendin tonë, të ndërtuar ndër vite”, tha Hajrizi.

Duke folur për angazhimin e UBT-së në këtë fushë, ai theksoi se institucioni të cilin ai e drejton, po mundohet që përmes debateve dhe publikimeve të ndryshme, të ndikojë në vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin e gjeneratave të reja për zhvillimet aktuale.

“Organizimi i kësaj konference dhe promovimi i këtij libri, është rezultat i dëshirës për të gjeneruar dije dhe për të kontribuar në ngritjen e vetëdijes së studentëve tanë për proceset e rëndësishme nëpër të cilat po kalon vendi ynë”.

Politologu, njëherësh edhe ligjërues në UBT, prof. dr Behlul Beqaj, duke numëruar faktorët potencial të rrezikimit të paqes, vlerësoi se Ballkani përbën një rrezik të përhershëm për shpërthimin e konflikteve të mundshme. “Provokimet e Serbisë, BE-ja me standardet e saj të dyfishta, stigmatizimi i Kosovës si vend prodhues i radikalizmit islamik, dështimi i dialogut dhe niveli aktual i korrupsionit në vend, janë disa nga faktorët që kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes”, vlerësoi Beqaj, për të shtuar se “institucionet duhet të insistojnë në zbatimin e plotë e marrëveshjeve të arritura në Bruksel, si dhe të diskutohen faktorët e paqes”.

Analistja dhe aktivistja e shoqërisë civile, Besa Luzha tha se mungesa e komunikimit dhe pamundësia e një jete të përbashkët mes kosovarëve dhe serbëve të Kosovës, si dhe mungesa e informacioneve për gjenezën e konfliktit ka bërë që sipas saj, secila palë të krijojë të vërtetën e vet

mbi bazat e diskursit të tyre nacionalist.

“Institucionet dhe qytetarët duhet të kenë njoftim të thuktë dhe objektiv mbi arsyet e konflikteve sepse vetëm atëherë krijohet mendimi kritik dhe e drejta objektive për të gjitha palët e përfshira në konflikt, e kjo mundësohet përmes procesit të njohjes dhe të pranimit”, potencoi Luzha.

Njohësi i fushës së paqendërtimit, njëherësh edhe autor i librit të botuar, Ramadan Ilazi vlerësoi se mungesa e procesit të ballafaqimit të mirëfilltë me të kaluarën do të jetë rrezikues i vazhdueshëm i procesit të vendosjes së paqes mes Kosovës dhe Serbisë.

“Qytetarët e Kosovës janë të ndrydhur mes kërkesës për drejtësi dhe nevojës për paqe, ndërkaq Serbia nuk është e gatshme për ballafaqim me të kaluarën e vet”, tha Ilazi, për të vijuar se “zgjidhja është tek realizimi i një konsensusi politik, por edhe popullor”.

Duke folur për nevojën e botimit të një libri të tillë, i cili është i pari i këtij lloji në gjuhën shqipe, autori tha se libri “Ndërtimi liberal i paqes” është përmbledhje pedagogjike e debateve akademike dhe e literaturës mbi procesin e paqendërtimit.

“Ky libër është i dominuar nga doktrina liberale dhe duhet të shërbejë si udhërrëfyes i shumë debateve të studiuesve brenda vendit, pasi që aleanca liberale e garanton sigurinë e Kosovës”.

Përfaqësuesja e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Donika Emini theksoi se brenda instancave shtetërore mungon koordinimi mes institucioneve kyçe për ruajtjen dhe ndërtimin e paqes në vend.

“Mungesa e koordinimit mes Ministrisë së Punëve të Brendshme, FSK-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme reflekton në mungesën e strategjisë dhe bashkërendimit të veprimeve mes tyre”, tha Emini, për të shtuar se zgjidhjen e sheh tek “koordinimi i brendshëm dhe hartimi i një udhërrëfyesi, sepse pa këto, Kosova nuk do ta ketë mundësi të ndërtojë paqe dhe as të anëtarësohet në BE”. Konferenca i mbylli punimet me një debat, i cili u orientua në gjetjen e mënyrave për shtrirjen e pushtetit në tërë vendin, në rreziqet e mundshme të një konflikti të armatosur mes Kosovës dhe Serbisë, në ndryshimin e politikës së jashtme të SHBA-së karshi Kosovës pas zgjedhjes së Trump-it për president, në shtrirjen e aktivitetit rus në Ballkan, në gjendjen e shqiptarëve nëpër shtetet e tjera etj.

Profesori nga Dessau i Gjermanisë vizitoi Kosovën

Studentët e UBT-së dëgjojnë ligjëratë për arkitekturë

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit hapësinor kanë dëgjuar ligjëratë tematike për aplikimin e njohurive në fushën e arkitekturës nga Stephan Pinkau, profesor në Shkollën profesionale të arkitekturës “Bauhaus”, pjesë e Anhalt University, në qytetin Dessau të Gjermanisë.

Gjatë kësaj ligjërate, studentët u informuan përmes shembujve me mënyrën e projektimit dhe të përdorimit të fasadave, si materialet më adekuate për shkëmbim energjetik, të cilat përdoren në Gjermani.

Krahas kësaj, ai i njoftoi inxhinierët e rinj edhe me rëndësinë dhe me punën e kryer në kuadër të projektit Tempus, pjesë e të cilit ishin UBT, Universiteti i Prishtinës, Universiteti Polis, Universiteti i Podgoricës dhe Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”. Projektin Tempus, ndër tjerash përfshin edhe hartimin e kurrikulave për programin e energjisë eficiente.

Në fund të ligjëratës, studentët patën mundësi të komentojnë dhe të shtrojnë pyetje në lidhje me mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij drejtimi, por edhe të marrin njohuri të reja mbi fushën e arkitekturës dhe përdorimin e saj në Gjermani.

Përpos ligjëratës tematike me studentët e nivelit bachelor, profesori Pinkau organizoi dhe udhëhoqi edhe një ligjëratë dhe punëtori me studentët e nivelit master, me ç’rast është trajtuar tema më titull “Eficienca e energjisë”.

Gjatë punëtorisë, studentët kanë pasur mundësi të bëjnë eksperimente në objektet përreth UBT-së, përmes aplikimit të njohurive teorike dhe praktike në fushën e energjisë eficiente, të fituara gjatë ligjëratës.



Në UBT u promovua libri “Menaxhimi dhe zgjidhja e konflikteve rajonale dhe ndërkombëtare”

Profesori Zejnullahi: Dialogët janë baza e zgjidhjes së konflikteve

Historikisht, luftërat kanë sjellë humbjen e jetëve të njerëzve në tërë botën, prandaj është qenësore që të jepet mesazhi se konfliktet nuk duhet të zgjidhen përmes luftës, por përmes dialogut, ndërkaq shembujt e trajtuar në këtë libër tregojnë se është shumë më mirë që të bisedohet për shkaqet, sesa të luftohet për to.

Këtë konstatim e ka nxjerr ligjëruesi në UBT, prof. dr. Veton Zejnullahi, me rastin e promovimit të librit të tij “Menaxhimi dhe zgjidhja e konflikteve rajonale dhe ndërkombëtare”, në UBT, në të cilin ishin të pranishëm personalitete të shquara, politikanë, analistë, familjarë e miq të autorit, profesorë dhe studentë.

“Ky libër i dedikohet mbi 3.6 miliardë viktimave që humbën jetën në 14.513 luftëra nëpër të gjitha vendet e botës, përjetimet e të cilëve janë sjellë në libër përmes fotografive, që shërbejnë si përjetësim i momenteve”, tha Zejnullahi.

Sipas autorit, libri trajton numrin dhe shkaqet e konflikteve, duke e vënë theksin tek zgjidhja e konflikteve, në të cilët ishin të përfshirë edhe shqiptarët.

“Shkaqet që sjellin konfliktet janë të shumta dhe të ndryshme, duke filluar nga kolonizimi, ndarja e territoreve, droga e konfliktet në baza racore, por theksi është i vendosur tek konfliktet nga të cilat pësuan dhe u prekën drejtpërdrejt shqiptarët”, vlerësoi Zejnullahi.

Rектори i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se siguria dhe vendosja e paqes janë faktorë tejet të rëndësishëm për vendosjen e një rendi të drejtë funksionues në botë, prandaj sipas tij, UBT po mundohet që përmes publikimeve të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe në gjenerimin e vlerave shtesë në fushën e dijes.

“UBT është potencial për promovimin e vlerave dhe dijes, përmes përkrahjes së autorëve, të cilët kanë përvojë dhe shprehin vullnetin dhe dëshirën për të dhënë kontribut në fushat që i përkasin”, theksoi Hajrizi, i cili duke folur për rëndësinë e publikimit të librit “Menaxhimi dhe zgjidhja e konflikteve rajonale dhe ndërkombëtare”, shtoi se “ky libër

është gjenerim i njohurive akademike për format paqësore të zgjidhjes së konflikteve në botë”.

Recensenti i librit, prof. dr. Hekuran Rapaj tha se ky libër përbën një analizë ndryshe të menaxhimit dhe zgjidhjes së konflikteve rajonale e ndërkombëtare.

“Nëpërmjet një guximi intelektual, Zejnullahi sjell një botim interesant, që vjen si një risi e veçantë për bibliotekat, për studentët dhe për studiuesit e shkencave politike, historisë albanologjisë, diplomacisë e marrëdhënieve ndërkombëtare”, vlerësoi ai.

Duke folur për biografinë dhe kontributin e autorit, Rapaj tha se Zejnullahi është përpjekur në vazhdimësi të prekë drejtpërdrejt në thelbin e çështjeve të mëdha, prej të cilave kanë buruar edhe konfliktet.

“Autori ka dhënë kontribute të rëndësishme dhe origjinale akademike, përmes pjesëmarrjes në konferenca e sesione të rëndësishme shkencore dhe hulumtues, duke qenë se është një njeri këmbëngulës, kurajoz dhe i pandalshëm në punën e tij”, potencoi Rapaj.

Dr. Sc. Nusret Pllana tha se libri është i një rëndësie të veçantë për faktin se, sipas tij, trajton në mënyrë të detajuar konfliktet që ndryshuan rrjedhën e historisë, duke e vënë theksin tek lufta çlirimtare e UÇK-së.

“Libri trajton kushtet dhe rrethanat nëpër të cilat kanë ndodhur konfliktet e ndryshme në botë, por mbi të gjitha paraqet një rikujtim të njohjes ndërkombëtare të luftës çlirimtare të UÇK-së nga vendet evropiane”, tha Pllana, i cili e vlerësoi lart kontributin e autorit të librit të promovuar.

“Zejnullahi mbetet jo vetëm njohës shumë i mirë i fushës, por edhe luftëtar shembull për çlirimin e trojeve të okupuara nga Serbia”, u shpreh ai.

Ky organizim u përmbyll me një debat, në të cilin profesori Zejnullahi iu përgjigj pyetjeve të të pranishmëve.



Pas plotësimit të të gjitha kushteve teknike, të përcaktuara nga Instituti C++ (C++ Institute)

UBT akreditohet si Akademi e Autorizuar e Institutit të programimit C++

Akademia Ekzekutive e UBT-së për Zhvillim Profesional është akredituar si Akademi e Autorizuar e Institutit të programimit C++, pas plotësimit të të gjitha kushteve teknike, të përcaktuara nga Instituti C++ (C++ Institute).

Në bazë të kësaj, studentët e UBT-së, por edhe të interesuarit e tjerë në fushën e shkencës, do kenë mundësi të ndjekin trajnime dhe të marrin certifikata të njohura ndërkombëtarisht në gjuhën programuese C++.

Instituti C++ është e njohur si organizatë udhëheqëse në botë, duke ofruar një të cilësi të lartë të mësimin të gjuhëve programuese C dhe C++, por edhe certifikimit, përmes mundësisë së shfrytëzimit të shkathtësive të individëve në mijëra qendra testimi, të cilat janë të qasshme dhe të sigurta

në tërë botën.

Instituti C++ bashkon një komunitet të përkushtuar të profesionistëve, specialistë e entuziastë të programimit, pastaj institucionet e arsimit dhe trajnimit, organizata, kompani dhe grupe vullnetarësh, të cilët përpiqen për të zhvilluar dhe për të përmirësuar cilësinë në këtë fushë, për përsosjen e teknikave të vlerësimit, si dhe për popullarizimin e programeve në gjuhët C dhe C++.

Instituti në fjalë, u krijua për të nxitur mësimin e gjuhëve përkatëse programuese, përmes ofrit të një kornize të përgjithshme globale, me qëllim të rritjes, zhvillimit dhe mbështetjes së karrierës profesionale në C dhe C++, për edhe në teknologjitë e tjera të ngjashme të programimit.



UBT dhe komuna e Pejës nënshkruan marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi

Rектори i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka vizituar komunën e Pejës, ku është prituri nga kryetari i kësaj komune, Gazmend Muhaxheri.

Me këtë rast, rektori Hajrizi dhe kryetari Muhaxheri kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve, e cila përfshin bashkëpunimin në fusha të ndryshme, në veçanti kontributin që do ta ofrojë UBT në zhvillimin e komunës së Pejës.

Me këtë rast rektori Hajrizi ka theksuar se marrëveshja e nënshkruar është në interes të përbashkët të UBT-së dhe komunës së Pejës. “Kjo marrëveshje bashkëpunimi siguron programe të përbashkëta bashkëpunimi në zhvillimin dhe implementimin e programeve për zhvillim ekonomik dhe

industrial, si dhe planifikimin urban të Komunës së Pejës dhe aktiviteteve të tjera në interes të përbashkët”, tha Hajrizi.

Ndërsa kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri shprehu gatishmërinë e komunës që ai drejton për të mbështetur projektet e përbashkëta që do të iniciohen nga të dy institucionet.

Rектори Hajrizi, dekani i fakultetit të Arkitekturës, Lulzim Beqiri dhe profesori i Fakultetit të Arkitekturës, Kujtim Elezi, kanë diskutuar edhe për projektin e Modernizmit në Pejë, projekt ky i ngjashëm me atë që UBT sapo e ka finalizuar në komunën e Ferizajt.



Studentët njihen me punën praktike në transmetuesin publik

Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim vizituan Radiotelevizionin e Kosovës

Studentët e vitit të parë të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, kanë vizituar RTK-në, të vetmin transmetues publik në vend, me ç’rast u pritën nga redaktori i redaksisë së programeve argëtuese, Xhevdet Sfarça. Sfarça i njoftoi studentët rreth historikut dhe sfidave të RTK-së, pastaj me mënyrën e funksionimit e të organizimit të këtij mediumi, si dhe me ambientet e punës. Duke folur për rëndësinë e vizitave studimore nëpër medime, ai u tha studentëve se vizitat që po i bëjnë nëpër media, u ndihmon atyre që të shohin nga afër natyrën e punës,

organizimin, si dhe ndarjen e detyrave ditore nëpër redaksitë e ndryshme. “Është një ide shumë e mirë që në planprogramin e tyre mësimor, Fakulteti i Medias dhe Komunikimit ka paraparë edhe vizitat në medie e institucione të ndryshme, për të parë nga afër se si punohet në sektorin e informimit dhe të komunikimit me publikun”, theksoi Sfarça. Studentët e këtij drejtimi edhe më parë kanë vizituar shtëpi mediale, teksa edhe më tutje ata do të vazhdojnë të vizitojnë medime televizive, portale e gazeta vendore.



Studentët e Dizajnit të Integruar vizituan ndërmarrjen “S//Sprint”

Studentët e vitit të parë në Fakultetin Dizajn i Integruar në UBT, kanë vizituar ndërmarrjen prodhuese të veshmbathjeve në Kosovë, “S//Sprint”, që konsiderohet si prodhuesi më i specializuar i veshjeve sportive, njëkohësisht njihen për rroba cilësore në treg. Studentët janë pritur nga përfaqësuesja e kompanisë, Xufe Sopa, e cila ka bërë të ditur se ndërmarrja punon me standarde evropiane, si dhe ofron produkte të modës së fundit. Ajo ka theksuar se kompania sjell risi të ndryshme në

veshmbathje gjatë tërë vitit dhe jo vetëm në sezone. Studentët janë njohur rreth procesit të prodhimit në tërësi, duke filluar nga modelimi, prerja, qepja, hekurosja, kontrolli i cilësisë e paketimi i tyre. Po ashtu, ata kanë parë edhe teknologjinë e makineritë që përdoren, veçanërisht për qëndisje dhe stampim. Në kuadër të vizitave studimore studentët do të vizitojnë edhe prodhues të tjerë tekstilësh e ndërmarrje të tjera.



Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë vizituan Termokosin

Studentët e vitit të dytë dhe të vitit të tretë të Fakultetit Inxhinieri e Energjisë në UBT, vizituan ngrohtoren e qytetit të Prishtinës “Termokos”, të shoqëruar nga ligjëruesit e UBT-së, Pranvera Dobruna dhe Nexhat Balaj. Gjatë kësaj vizite, studentët u pritën nga drejtori i Prodhimit në Termokos, Gani Kelmendi, i cili i njoftoi me procesin e tërësishëm të kogjenerimit, me teknikat që i shfrytëzoi kjo ndërmarrje për zëvendësimin e sistemit të vjetër për djegien e mazutit me sistemin e ri, bazuar

në teknologjinë e re, pastaj për planet për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes nëpër lagje të reja të qytetit, si mundësi potenciale për rritjen e vendeve të punës etj. Gjatë pyetjeve të parashtruara nga studentët për mënyrën e funksionimit të Termokosit, gjithashtu ata u rekomanduan zyrtarëve të kësaj ndërmarrjeje, që Termokosi të fillojë të punojë në bazë të temperaturave që mbretërojnë jashtë, e jo në bazë të datës së parapërcaktuar për sezonin e ngrohjes, pavarësisht temperaturave.

Studentët e UBT-së vizituan Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinarisë

Studentët e vitit të parë në Fakultetin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, në vazhden e vizitave studimore, kanë vizituar Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinarisë së Kosovës, ku kanë qëndruar në Laboratorin e Mikrobiologjisë. Gjatë kësaj vizite, studentët kanë parë se si menaxhohet dhe se si kontrollohet cilësia e produkteve ushqimore në aspektin mikrobiologjik. Krahas kësaj, ata janë njohur edhe me procedurat e punës në laboratorin e AUV-it, duke filluar nga marrja, ruajtja, përgatitja, si dhe analizimi i mostrave. Në anën tjetër, përfaqësuesit e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, kanë bërë të di-

tur për studentët se në këtë agjenci zhvillohen dhe implementohen politikat e Qeverisë së Kosovës, në sferën e sigurisë dhe kualitetit të ushqimit, si dhe në sektorët e shëndetit të kafshëve dhe mirëqenies së tyre. Tutje, ata kanë thënë se është duke u zbatuar strategjia e mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, në atë mënyrë që, sipas tyre, siguria dhe kontrolli i ushqimit, të në pajtim me politikat e hartuara. Në fund të kësaj vizite, studentët e këtij fakulteti patën mundësinë të bëjnë pyetje, ndërkaq ata do të vizitojnë edhe biznese tjera, për të parë nga afër procesin e punës së tyre.

Studentët e UBT-së vizituan Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës

Në kuadër të vizitave të rregullta që u bëhen institucioneve publike, të hënën, studentët e vitit të parë të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, kanë vizituar Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ata janë pritur nga shefi i Kabinetit të MPJ-së, Bashmir Xhemaj dhe u.d. e drejtoreshës së Divizionit për Komunikim Publik, Bukurie Bajraliu. Xhemaj dhe Bajraliu i njoftuan studentët me mënyrën e funksionimit të Ministrisë, sfidat, vështirësitë, menaxhimin për komunikimin, rolin e rrjeteve sociale si dhe me ambien-

tet e punës. Xhemaj theksoi se ky lloj aktiviteti do të ndikojë shumë pozitivisht në avancimin e profesionit. “Programi i UBT-së i drejtimit Media dhe Komunikim, është i dizajnuar në mënyrë adekuate për studentët e këtij drejtimi. Ky drejtim pos që i plotëson kushtet për t’u bërë gazetarë të mirë, ju mundëson të depërtoni edhe në fusha të komunikimit, siç është Marrëdhënia me Publikun”, vlerësoi ai.

Tutje, duke shkëmbyer përvoja dhe këshilla të frytshme me studentët, Xhemaj i njoftoi ata për mundësinë e praktikës në Ministrinë e Punëve të Jashtme. “Jemi të hapur që në mesin tonë të pranojmë studentë entuziastë, siç jeni ju”, përfundon ai. Studentët iu bënë disa pyetje nikoqirëve dhe u ndanë të kënaqur me përvojën e fituar

Studentja e UBT-së në RTV “Dukagjini”

Studentja në Media dhe Komunikim të UBT-së, Erza Brahushi, në përfundim të vitit të tretë të studimeve është punësuar si gazetare në RTV “Dukagjini”. “Ishte viti i tretë i studimeve kur mu dha mundësia që të jem pjesë e RTV ‘Dukagjini’, si gazetare e re”, ka thënë

Brahushi, teksa ka shtuar se suksesin në vendin e punës e mbështet në disiplinë, seriozitet, përkushtim dhe në dashuri për profesionin. Ajo, suksesin kryesor për punësim ia atribuon UBT-së. “Falë UBT-së, ishte më e lehtë që të hyja sa më shpejt në

tregun e punës. Profesorët, me ligjëratat dhe eksperiencat e tyre, më mësuam shumë gjëra, të cilat po më hyjnë shumë në punë”, ka vijuar Brahushi, sipas të cilës për një student i cili dëshiron t’i arrijë qëllimit e tij në jetë, “UBT është zgjidhja e duhur për studiuesit”.

Suksesi i madh i studentit të UBT-së

Studenti i UBT-së gjen mangësi në Instagram, shpërblehet nga kompania

Studenti i vitit të parë në Shkenca Kompjuterike në UBT, Benjamin Gecaj është futur në listën e personave që do të pranojë shpërblim nga kompania “Instagram”, kjo pasi që ai ka arritur të gjejë mangësi në këtë rrjet social.

Gecaj është i vetmi student shqiptar nga miliona përdorues të Instagram-it, që ka arritur të përmirësojë gabimet e kësaj platforme, andaj si shpërblim ai do t'i marrë 25 mijë dollarë.

Ai ka theksuar se Instagram është platformë që ka tipare dalluese, por gjithsesi sipas tij nuk ka qenë e vështirë që të gjejë mangësi në sigurinë e përdoruesve.

“Për disa muaj rresht kam testuar mangësitë dhe gabimet e Instagram-it dhe kam raportuar tek kompania, me ç'rast si kundërpërgjigje ata më aprovuan testimet, si dhe më kanë shpërblyer me një shumë të konsiderueshme të të hollave, që pres t'i marrë ditëve në vazhdim”, tregoi Gecaj, i cili duke shpjeguar mënyrën e realizimit të kësaj pune, shtoi se ka arritur që me llog-

ari të rrejshme, të mbyllë shumë llogari të përdoruesve.

Vlen të theksohet se Gecaj këtë vit akademik është transferuar nga kolegji AUK, me ç'rast ai ka vlerësuar se UBT është institucion i përkushtuar ndaj studentëve që e konsideron si një ndër asetet më të çmuara.

“UBT dallon nga gjitha institucionet e tjera arsimore, në rend të parë ofron shumë mundësi për studentët, po ashtu ofron programe bashkëkohore studimi, sipas standardeve më cilësore ndërkombëtare”, theksoi ai, duke shtuar se “UBT është institucion inovativ i arsimit të lartë në Kosovë dhe në rajon dhe u bëj thirrje të gjithë atyre që dëshirojnë t'i vazhdojnë studimet, të bëhen pjesë e UBT-së”.

Ndërkohë në UBT ka filluar transferimi i studentëve nga universitetet dhe kolegjet e tjera, për përfundim të studimeve, ku dhe janë shpallur procedurat e aplikimit, derisa vetëm këto ditë, mbi 100 studentë kanë aplikuar për transferim në UBT.



Në përgatitje për garën ndërkombëtare të programimit, ACM ICPC

Në UBT u mbajt gara e parë e programimit në Kosovë

Fituesit e garës janë Hakan Shehu, Agon Shkodra, Enis Halimi dhe Kolos Pukaj

Në UBT është mbajtur gara e parë e programit kompjuterik, me ç'rast garuesit kanë përdorur shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në fushën e programimit, duke shfrytëzuar algoritme dhe teknika të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në këtë fushë.

Fituesit e garës janë Hakan Shehu, Agon Shkodra, Enis Halimi dhe Kolos Pukaj.

Ky aktivitet është mbajtur me qëllim të zgjedhjes së studentëve, të cilët do të marrin pjesë në olimpiadën ndërkombëtare të programimit “ACMP ICPC”, në Porto të Portugalisë, në nëntor të këtij viti.

Organizatori i këtij organizimi, Muhamed Retkoceri tha se

gara është mbajtur me qëllim të identifikimit të studentëve të shkathtë dhe të interesuar në zgjidhjen e problemeve të programimit, të cilët më pas synohet të përgatiten për garën ndërkombëtare të programimit, ACM ICPC.

“Kjo është një mundësi e jashtëzakonshme për të treguar talentin si student dhe është një përvojë e papërsëritshme gjatë studimeve”, theksoi Retkoceri, për të shtuar se “gara është zhvilluar përmes platformës “HackerRank”.

Radhitja e kandidatëve është bërë për nga numri i detyrave të sakta të zgjidhura, kohëzgjatja e postimit të zgjidhjes dhe numrit të tentimeve të gabuara për zgjidhje, ndërkaq vlerësimi i saktësisë së zgjidhjeve është bërë automatikisht nga

sistemi, kurse tabela e pikëve të kandidatëve është shfaqur drejtpërdrejt në projektor, përgjatë tërë garës.

Në fund, përformuesit më të mirë të kësaj gare do të shpërblehen gjatë një ceremonie, e cila do të organizohet për këtë qëllim.

Vlen të theksohet se, UBT është instituti i parë akademik nga Kosova e Shqipëria, që është anëtarësuar në ACM ICPC, në mesin e qindra universiteteve nga e gjithë bota. Ky program kompjuterik paraqet njërin nga mundësitë më të mira të ndikimit të teknologjisë në shoqëri.

Partneritet ndërkombëtar i UBT-së

Studentët e UBT-së përfitojnë nga bursat e programit Erasmus+

Partneriteti i UBT-së me mbi 250 universitete prestigjioze dhe institucione ndërkombëtare po shërben si shteg nëpër të cilin po kalojnë studentët e UBT-së, për të përjetuar ndjenjën e të qenit pjesë e universiteteve më të njohura botërore, karshi studentëve nga e tërë bota.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, studenti i vitit të tretë në drejtimin e Shkencave kompjuterike në UBT, Ardit Podrimaj ka qenë përfitues i bursës së programit Erasmus+, për

vijimin e studimeve në Universitetin NOVA, në Lisbonë të Portugalisë, ku do të qëndrojë edhe për një semestër.

Podrimaj tha se qëndrimi dhe studimi në Portugalinë është përvojë unike në aspektin shkencor e social.

“Studimi në Portugalinë paraqet një përvojë interesante dhe të dobishme për të formuar shprehje të punës së sistemuar, si dhe ndikues për formimin e shoqërive të reja me njerëz të kombësive të ndryshme”, u shpreh ai, teksa shtoi se “suk-

seset janë rezultat i dëshirës së madhe për të mësuar, si dhe fryt i bashkëpunimit të ngushtë me profesorët dhe pjesën tjetër të stafit të UBT-së”.

Duke folur për planet e së ardhmes, Podrimaj tha se dëshiron të kthehet në UBT për përfundimin e temës së diplomës, si dhe më pas planifikon të punësohet në ndonjë kompani ose të fillojë biznesin e tij personal.

Aktiviteti ndërkombëtar

Autorë nga UBT, pjesë e rëndësishme e librit “The Challenges of European Governance in the Age of Economic Stagnation, Immigration and Refugees”

Profesori në UBT, dr.Ridvan Peshkopia është autor i një kapitulli të një libri të rëndësishëm, publikuar në vitin 2016 nga Lexington Books, Rowman and Littlefield.

Ai është autor i kapitullit të titulluar “Revisiting EU Membership Conditionality from a Consociationalist Approach: Refining Concepts and Redesigning Tasks”, që është pjesë e librit “The Challenges of European Governance in the Age of Economic Stagnation, Immigration and Refugees”, edituar nga Henry Frank Carey.

Pjesë e këtij libri janë edhe autorë të tjerë nga UBT. Kapitulli i librit, i titulluar “Challenges and Double-Standards in EU’s Peacebuilding Project in Kosovo”, ka për bashkautor

mësimdhënësin në UBT, Alban Lauka dhe studentët e programit Master Argjita Grapçi, Besnik Muja, Agon Gashi, Besim Karaqa, Makfire Azemi, Milot Rexhepi, Edon Kalludra, Mirlinda Gashi dhe Endi Hasanaj.

Në libër janë të përfshirë edhe autorë të tjerë të njohur nga shumë institucione ndërkombëtare akademike.

Më shumë për librin: <https://rowman.com/.../The-Challenges-of-European-Governance-...#>.

Bashkëpunimi me universitetet nga Polonia

UBT arrin marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Wroclawit

UBT ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Ęroclaë-it për Shkencë dhe Teknologji nga Polonia. Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se marrëveshja e bashkëpunimit paraqet një hap drejt një përfitimi të ndërsjellë, në fusha të ndryshme dhe në interes të dy universiteteve. “Objektivat kryesore të kësaj marrëveshjeje janë shkëmbimi i përvojave në metodat e mësimdhënies, shkëmbimi i stafit akademik për qëllime të ligjëratave, seminareve etj.”,

tha rektori Hajrizi. Ai tha se fushat që përfshihen në marrëveshje parashohin bashkëpunime në projekte të përbashkëta të hulumtimit, shkëmbimin e informacioneve shkencore dhe teknologjike, koordinimin e studimeve hulumtuese, shkëmbimin e rezultateve shkencore në fushat e definuara, publikimin e rezultateve të këtyre fushave, organizimin e konferencave, seminareve dhe simpoziumeve të përbashkëta e të tjera. Përmes arritjes së këtij bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy

universiteteve, parashihen edhe vizitat bashkëpunuese ndërmjet stafeve akademike, administrative dhe studentëve, në mënyrë që të krijohen mundësi më të mira për studentët, të cilët vijnë studimet e nivelit master dhe doktoraturë. Universiteti i Ęorclaë-it është themeluar në vitin 1702, i cili në fokus të studimeve i ka kërkimet shkencore. Vlen të theksohet se në këtë universitet kanë studiuar e diplomuar nëntë fitues të Çmimit Nobel.

Rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi takon ministren Hikmete Bajrami

Zgjerohet bashkëpunimi i UBT-së me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka takuar ministren e Tregtisë dhe të Industrisë, Hikmete Bajrami. Në takim u bisedua lidhur me forcimin e bashkëpunimit midis UBT-së dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me ç’rast palët kanë biseduar lidhur me zhvillimin e kapaciteteve për punësim, turizëm, ndërmarrësi etj. Rektori Hajrizi e njoftoi ministren Bajrami edhe me drej-

timet, qendrat e ndryshme hulumtuese, inkubatorët dhe laboratorët që gjenden në kuadër të UBT-së. Gjithashtu, Hajrizi shtoi se UBT ka gjeneruar vende të reja të punës dhe se deri tashti në UBT kanë punuar mbi 1000 punëtorë. “UBT ka për qëllim që të kontribuojë në fusha të ndryshme, që kanë për qëllim përmasimin e jetës së qytetarëve të Kosovës. Andaj, bashkëpunimet e tilla ndërmjet insti-

tucioneve të arsimit dhe institucioneve të qeverisë janë të mirëseardhura dhe shumë frytdhënëse”, tha rektori Hajrizi. Nga ana tjetër, ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Hikmete Bajrami shprehu gatishmëri e ministrisë për të bashkëpunuar me UBT-në.

Drejtimi i ri dhe shumë i kërkuar në UBT

UBT përgatit infermierët e së ardhmes

Sistemi shëndetësor në Kosovë përballet me shumë probleme, ndër to edhe me mungesë të kuadrove profesionale e posaçërisht për infermierë të shkolluar, andaj kjo ka bërë që UBT të akreditojë këtë program që aktualisht i plotëson të gjitha kushtet profesionale, si dhe siguron një qasje të balancuar në aspektin e teorisë dhe praktikës. Programi Bachelor i Infermierisë, në UBT, aktualisht është i orientuar të ofrojë shërbime profesionale, me qëllim që studentët e këtij drejtimi të përgatiten për tregun e punës gjithmonë duke iu ofruar leksione, punë praktike e trajnime të shumta. UBT posedon edhe kabinetet e infermierisë, që janë të pajisura edhe me aparatura moderne, salla adekuate për mësimdhënie, si dhe profesor vendorë e ndërkombëtarë, prandaj, kjo ka bërë që mbi 400 studentë të regjistrohen gjatë vitit

akademik 2016/2017. Dekani i Fakultetit të Infermierisë, Fitim Alidema ka bërë të ditur se studentët po ndjekin leksionet ndërkohë edhe ushtrimet laboratorike në kampuset e UBT-së, duke shtuar se pjesën e praktikës profesionale studentët do të fillojnë në semestrin pranveror në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë të udhëhequr nga profesorët dhe asistentët. Sipas tij, nëpërmjet praktikës së infermierisë, ndër të tjera studentët do të përgatiten për shërbime të infermierisë në masat preventive, rehabilituese, lehtësuese për individët dhe grupet e shoqërisë. “Llamba fototerapike, aparati për frymëmarrje, oxisat pulsoximetri, cato aparati për narkozë dhe cicero aparati i narkozës, janë disa nga aparaturat moderne që gjenden në UBT, e që janë në shërbim të studentëve të infermierisë”, ka thënë

Alidema duke shtuar se në punën praktike studentët do të informohen për së afërmi si bëhen intervenimet në rastet urgjente, duke filluar me dhënien e frymëmarrjes artificiale. UBT ka bashkëpunim dhe në partneritet me më shumë se 250 universitete botërore, andaj ai konsideroi se programi i Infermierisë është i harmonizuar me rregullat e Bashkimit Evropian si dhe ofron mundësi transferi dhe njohje në Evropë. Vlen të theksohet se studentët e kualifikuar në programin e Infermierisë në UBT kanë mundësi për të punuar në shërbimin shëndetësor, ofrimin e shërbimeve të infermierisë tek fëmijët, adoleshentët, të rriturit dhe të moshuarit me shërbime akute, kronike, somatike ose sëmundje psikiatrike.

Studenti i UBT-së lehtëson pajisjen me patentë shofer

Të interesuarit për pajisje me patentë shofer, tash e tutje do ta kenë shumë më lehtë të mësojnë në këtë fushë, për faktin se një student i Fakultetit të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, ka arritur që në mënyrë elektronike t’i grumbullojë të gjitha llojet e të dhënave në një aplikacion të vetëm. Studenti Alban Sahiti, njëherësh bashkëthemelues i kompanisë “TENTON” për zhvillim dhe programim të softuerëve, aplikacioneve mobile dhe ueb faqeve të ndryshme, për kompani dhe institucione brenda e jashtë Kosovës, ka zhvilluar një aplikacion për t’u ofruar ndihmë shoferëve të rinj, në të cilin përfshihen teste elektronike, literaturë e nevojshme, ilustrime me video për mënyrën e sjelljes në komunikacion, dokumentet e nevojshme për regjistrimin e lejes, si dhe gjetjen e autoshkollave nëpër të gjitha qytetet e Kosovës. Duke treguar për synimet e tij, Sahiti theksoi se aplikacioni “Autoshkolla” është dizajnuar me qëllim që të lehtësojë procedurat dhe metodën e të mësuarit nga shfrytëzuesit.

“Qëllimi i aplikacionit është që përmes një dizajni atraktiv dhe lehtësisht të pranueshëm, shoferët e rinj të përgatiten për pjesën teorike të marrjes së patentë shoferit. Të njëjtin po mundohem ta zhvilloj edhe për Shqipëri dhe për vendet e tjera të rajonit”, the ai, teksa tregoi që ky aplikacion mund të shkarkohet dhe të shfrytëzohet nga të gjithë njerëzit që përdorin llojet e telefonave të mençur, Android dhe iOS. Në UBT ndodhet shkolla më e madhe për shkenca kompjuterike, ku studiohet në bazë të metodave më të sofistikuara dhe udhëhiqet nga një staf akademik i kualifikuar dhe profesionalisht i përgatitur. Linqet për shkarkim të aplikacionit: për Android dhe iOS: <https://itunes.apple.com/app/id1193245391> <https://play.google.com/store/apps/details...>

Studentët e UBT-së, falë Programit “Erasmus +” vazhdojnë studimet në universitetet evropiane

Studentja Syzana vazhdon studimet në Universitetin Nova de Lisboa, të Portugalisë

Studentja e vitit të tretë në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Syzana Kajtazaj, është përfituese e bursës që ndahet nga Programi Erasmus+ International Credit, për studentët kosovarë. Kajtazi është duke i vazhduar studimet në Universitetin Nova de Lisboa, të Portugalisë. Studentja Kajtazaj tha se përzgjedhja e saj në mesin e shumë studentëve të tjerë që kishin aplikuar, është rezultat i punës dhe përkushtimit të përbashkët të saj dhe profesorëve të UBT-së.

“Suksesi im është fryt i punës dhe përkushtimit tim, si dhe angazhimit të vazhdueshëm të profesorëve, për të ndërtuar studentë dhe profesionistë në aspektin akademik”, theksoi ajo dhe shtoi se UBT i përkrahë studentët e përkushtuar, që kanë potencial, përmes bursave. “Pastaj përfitojnë mundësinë për studime jashtë vendit, për praktika dhe vende të reja të punës etj”, theksoi ajo. Duke treguar për përvojën e marrë gjatë muajve sa po studion në Universitetin NOVA, kjo studente vlerësoi se ka arritur të përmirësohet në aspektin profesional dhe në atë

komunikues. “Studimi në këtë universitet më ka bërë ta shoh veten se sa jam e aftë dhe se në cilat pika duhet të përmirësohem në aspektin akademik, ndërsaq falë kësaj përvoje, jam bërë më e hapur në komunikim me të tjerët”. Muajt në vijim, Kajtazaj planifikon të kthehet në UBT, për të përfunduar studimet e nivelit bachelor, si dhe për të vazhduar me tutorim në lëndën e matematikës, punë të cilën e kishte bërë para se të shkonte në Portugali.

Shtohen studentët e angazhuar në intership

Është shtuar numri i studentëve të UBT-së, që janë angazhuar për intership ose punë praktike në kompani të ndryshme gjatë semestrit dimëror të këtij viti akademik. Kjo është bërë falë bashkëpunimit të mirë të UBT-së me kompanitë dhe organizatat lokale e ndërkombëtare.

Drejtori i Qendrës së Karrierës në UBT, Halil Bashota ka thënë se ky proces ka për qëllim që studentët të kenë mundësi të ndërldhin procesin akademik me praktikën profesionale, dhe të fillojnë të mendojnë për karrierën e tyre.

Sipas tij, UBT është institucion që do të arrijë të realizojë në përpikëri intershipin e studentëve në të gjitha programet e studimit, për të gjithë studentët që dëshirojnë të kenë karrierë në të ardhmen.

“Çdo vit ka ngritje të numrit të intershipit si dhe numrit të kompanive me të cilët realizojmë intershipin e studentëve, si rezultat i bashkëpunimit të mirë dhe rezultateve që studentët arrijnë të marrin në UBT”, ka thënë

Bashota duke shtuar se fakultetet që prijnë me intership, kryesisht janë fakultetet e akredituara në fillim, si: Arkitektura, SHKI, MBE, SI, Juridiku etj.

Ai, po ashtu ka bërë të ditur se Qendra e Karrierës në UBT shpall vazhdimisht pozita të reja të publikuara, qoftë përmes qendrës, qoftë përmes portaleve të tjera të punësimit, me të cilat njoftohen studentët.

“Studentët e kanë fazën e aplikimit, dhe pasi të kryejnë këtë fazë, ata i nënshtrohen një testi apo intervistimi, varësisht nga specifikat, përkatësisht kërkesave të industrisë”, ka thënë Bashota.

Internshipi ka për qëllim që çdo student në UBT të ketë mundësinë që të fillojë intershipin më së largu në semestrin e pestë/gjashtë të studimeve.

Studentët duhet të konsultohen me Qendrën e Orientimit në Karrierë dhe Internship për gjetjen e mundësive për një gjë të tillë.



Suskesi i studentit të UBT-së në New York

I diplomuari në UBT, i punësuar në kompaninë amerikane “Architects Rule”

Ish-studenti i Arkitekturës në UBT, Ledri Mahmuti është duke punuar në kompaninë amerikane “Architects Rule”, me seli në New York, në të cilën ai është i angazhuar si arkitekt i ri, duke u inkuadruar në projekte të shumta ndërtimi.

Duke treguar për planet e së ardhmes, Mahmuti tha se koha e kaluar në SHBA, ka qenë një përvojë e mrekullueshme për të.

“Jam shumë i lumtur që më është dhënë mundësia të vazhdoj punën në New York, por pas marrjes së përvojës së nevojshme dhe përfundimit të studimeve master, planifikoj të kthehem në vendlindje, për të shfrytëzuar dhe për të transmetuar përvojën dhe njohuritë tek të tjerët”, thotë ai.

Tutje, Mahmuti vlerësoi se UBT ka merita të mëdha për suksesin e arritur.

“Programi bachelor i Arkitekturës në UBT, ka qenë i përbërë nga një staf shumë profesional në punën e tyre, ku prej tyre kam mësuar për bazat e dizajnit arkitektonik, jam përgatitur për punë, si dhe për avancim në karrierë”.

Para se të shkonte në Amerikë, Mahmuti ka qenë i punësuar në firmën “Learch3D”, në Prishtinë, vend që sipas tij, i ka dhënë mundësinë e parë për të zbatuar në praktikë, njohuritë teorike të fituara në UBT.



Ekspertët e kompanisë “Mabetex” mbajnë ligjëratë tematike për studentët e UBT-së

Përgjegjësi i marketingut të kompanisë “Mabetex – Konstrukione Metalike”, në Ferizaj, Gëzim Mustafa, i shoqëruar edhe nga drejtori i kësaj kompanie, Feti Selmani, mbajti ligjëratë tematike për studentët e nivelit master, të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT.

Gjatë kësaj ligjërate, u trajtua tema mbi menaxhimin dhe

produktet, me ç’rast u shpjeguan format e menaxhimit të kompanive dhe marketingut të produkteve.

Mustafa tha se Inxhinieria e ndërtimit ka nevojë të përhershme për marketing cilësor, duke e njohur konkurrencën në këtë fushë.

“Menaxhimi dhe marketingu janë elemente të rëndësishme

që ndikojnë në mënyrën e shfaqjes së një kompanie apo produkti deri tek konsumatorët”, theksoi ai, teksa i informoi studentët mbi risitë e fundit në fushat publicitare, duke dhënë edhe disa shembuj të suksesshëm të kompanive kosovare, në tregun e brendshëm, por edhe atë jashtë Kosovës.

Studentët dhe stafi i UBT-së dhurojnë gjak

Dhjetëra studentë si dhe stafi akademik e administrativ i UBT-së i janë përgjigjur aksionit “Dhuro gjak, shpëto një jetë”, organizuar sot në kampusin e UBT-së, në Lipjan.

Aksioni është organizuar në bashkëpunim me Qendrën e Transfuzionit të Gjakut të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Dozat e gjakut të mbledhur në UBT, do t’i shërbejnë QKUK-së, në raste emergjente të kërkesave për gjak.

Gjatë këtij organizimi gjak kanë mundur të dhurojnë të gjithë ata që janë në gjendje të mirë shëndetësore, derisa aksioni në fjalë do të vazhdojë në gjitha qendrat e UBT-së në Kosovë.



Festivali Ndërkombëtar i Akualetit

Artistët ndërkombëtarë, të impresionuar me organizimin dhe energjinë pozitive të FNA-së

Artistët ndërkombëtarë, të cilët ishin pjesë e edicionit të parë të Festivalit Ndërkombëtar të Akualetit (FNA), thanë se ndihen të impresionuar me mënyrën e organizimit të festivalit, me mikpritjen e UBT-së, si dhe me dëshirën, interesimin, kureshtjen, durimin dhe energjinë pozitive, që e kishin studentët e UBT-së, përgjatë gjithë kohës sa zgjati ky festival.

Atanur Dogan, President i IWS-së

Pa asnjë mëdyshje mund të them që jam mahnitur me atë se çfarë kam parë këtu.

Ka qenë një kohë shumë e shkurtër për organizim të një festivali kaq të madh dhe prapë kemi arritur të shohim një organizim shumë të bukur. Lirisht mund të them që, askush nuk mund ta bëjë një gjë të tillë për vetëm dy muaj, duke përfshirë këtu mbledhjen e artistëve nga e tërë bota, planifikimin e udhëtimeve tona, sidomos për ata që kanë ardhur nga kontinente të ndryshme.

Falë këtij organizimi, të gjithë kolegët tanë, tani do të jenë më të guximshëm sepse ata po marrin shembull për organizim të shpejtë dhe të suksesshëm në Kosovë.

Ne kemi shume plane, që po shpresojmë t'i realizojmë gjatë kësaj vere në UBT, sepse me aq sa kam parë, ky institucion është më i miri për organizimin e ngjarjeve të tilla të artit, si dhe për të bashkëpunuar. Në këtë aspekt, më duhet ta veçoj rektorin e UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, i cili është një njeri shume mendje hapur, energjik dhe po e përçon këtë energji edhe tek ne. për të ndërtuar gjëra të bukura për popullin tuaj dhe për botën.

Si president i IWS-së, jam duke udhëtuar përreth botes, duke qenë se i kemi krijuar degët tona në shumicën e vendeve të botes. Gjatë kësaj kohe, kam parë që shumë shtete janë stabilizuar dhe kanë shume para, në këtë mënyrë po krijojnë njerëz përtacë, por Kosova është e mrekullueshme dhe ka energji në çdo vend. Këtu po bëhen shumë ndërtime dhe njerëzit janë shumë energjikë, produktivë, kureshtarë, të talentuar, komunikues dhe i duan shumë aventurat. Ky është avantazhi i shtetit dhe popullit tuaj sepse këta të rinj do e ndërtojnë të ardhmen e këtij vendi.

Gjatë këtij edicioni, kam vendosur ta pikturoj heroin e popullit tuaj, Adem Jasharin sepse e çmoj dhe e respektoj tejet mase figurën e tij, duke qenë se ai e bëri realitet ëndrrën e të gjithë shqiptarëve, për të ndërtuar një shtet të pavarur, të lirë dhe paqësor, teksa ai e bëri këtë duke e sakrifikuar veten dhe familjen e tij. Për të gjitha këto arsye, unë ndihem i nderuar dhe i privilegjuar që pata rastin ta pikturoj një figurë kaq madhështore të kombit shqiptar.

Në Kosovë, tani jetojnë njerëz të feve dhe kombësive të

ndryshme, që po jetojnë se bashku dhe në paqe e harmoni me njeri-tjetrin. Kjo është mënyra se si duhet të funksionojmë të gjithë dhe bota duhet të marrë shembull nga ju.

Youmee Park, kryetare e IWS-së së Koresë Jugore

Jam shumë e lumtur që e pata mundësinë të vij në Kosovë, si pjesë e IWS-së dhe shpresoj që në të ardhmen e afërt ta përcjellim festivalin edhe në Korenë Jugore.

Gjatë këtij organizimi si tërësi, kam qenë pjesë e këtij festivali të organizuar në Hong Kong, në Shanghai, në Shqipëri, dhe së fundmi në Kosovë.

Ana më pozitive e këtij organizimi është njohja dhe lidhja e bashkëpunimit me artistë të tjerë. Do të doja shumë që të jem pjesë prapë pjesë e organizimeve të tilla sepse ka qenë një kënaqësi dhe një përvojë shumë e bukur për mua.

Kosovarët janë njerëz shumë të shoqërueshëm dhe të buzëqeshur.

Ky festival ishte shumë i bukur dhe më pëlqeu shumë qëndrimi në Kosovë, si dhe mënyra se si studentët ishin shumë të interesuar dhe të vëmendshëm në përcjelljen e punës sonë.

Amit Kapoor, kryetar i IWS-së së Indisë

Unë kam ardhur nga India dhe atje ka shumë lëvizje të njerëzve. është një vend shumë i zënë dhe i zhurmshëm, kurse unë gjithmonë dëshiroj të pikturoj vende të qeta të qyteteve, prandaj këtu kam dashur që përmes pikturave të iki nga qyteti dhe turmat e njerëzve, sepse me sa më pak gjëra të ketë, aq më tepër detaje mund të shfaqësh. Është një vend shumë i bukur dhe njerëzit këtu janë shumë të mirë dhe mbështetës.

Kam parë që studentët janë shumë të mirë në profesionet e tyre, mbi të gjitha janë shumë të durueshëm. Është e mrekullueshme të shohësh se si ata janë në gjendje të të shikojnë për orë të tëra, derisa e përfundon tërë pikturën. Është hera ime e parë këtu dhe tashmë e dua këtë vend. Koha e kaluar në Kosovë ka qenë shumë e mirë sepse pata mundësinë të njihem me artistë, me studentë dhe staf të këtij institucioni të mrekullueshëm.

Rahul Chakraborty, artist nga India

Jam shumë i nderuar që pata mundësinë të jem këtu, si pjesë e IWS-së, mbi të gjitha sepse është vizita ime e parë jashtë Indisë dhe jam shumë i privilegjuar të jem në mesin e mjeshtërve më të mirë të akualetit në mbarë botën. Si temë të punës sime në këtë festival e kam marrë qytetin e Prizrenit sepse dy ditë më parë e kemi vizituar këtë qytet, para se të vinim në Prishtinë.

Gjatë këtij festivali kam pasur mundësinë të takoj njerëz të mëdhenj të artit dhe gjithçka ishte fantastike. Ky vend më ka mbushur me emocione dhe me pasion, prandaj mund të them që jam kënaqur shumë përgjatë këtyre ditëve.

Njerëzit këtu janë shumë inspirues dhe do të doja shumë që të vija prapë në këtë shtet sepse ky vend ka shumë potencial njerëzor, si me artistë, ashtu edhe me ide.

Selma Todorova, artiste nga Bullgaria

Ky është edicioni i parë dhe si i tillë mund të them që është një organizim i mirë. Njerëzit këtu janë shumë mikpritës, sikurse edhe të gjithë njerëzit e tjerë të Ballkanit.

Kam qenë edhe herë të tjera në Kosovë dhe jam takuar me shumë artistë të njohur, të gjithë janë shumë të mirë dhe të veçantë.

Për mua është fat i madh të jem në mesin e artistëve më të njohur të akualetit.

Procesi i dëgjimit dhe shikimit të punës së këtyre artistëve, mund t'i ndihmojë artistët e rinj kosovarë të përmirësohen dhe të krijohen edhe më tutje.

La Fe, kryetar i IWS-së së Tajlandës

Për këtë edicion kam zgjedhur ta pikturoj trëndafilin sepse shumë i pranueshëm për syrin dhe mund të gjendet kudo dhe të shfrytëzohet për shumëçka.

Ndihem shumë i nderuar dhe i lumtur që isha pjesë e këtij organizimi dhe pata mundësinë të njihem me artistë të mëdhenj botërorë.

Kosova dhe njerëzit e saj janë shumë të bukur dhe vazhdimisht të buzëqeshur, prandaj më pëlqeu shumë të kaloja kohë këtu.

Krasi Todorov, artist nga Bullgaria

Mua më pëlqen shumë që të pikturoj atë që ma thotë mendja për momentin sepse arti kurrë nuk është i njëjtë. Nëse i kthehesh për të dytën herë një pikturë, gjithmonë do të dëshirosh të ndryshosh diçka, prandaj unë kurrë nuk i kthehem dy herë të njëjtës vepër arti.

Në art gjithçka lidhet me energjinë, me zemrën dhe me mendimet, prandaj unë gjithmonë i koordinoj këto, para se të filloj të pikturoj.

Ky festival është i klasit botëror dhe jam i nderuar që pata mundësinë të marrë pjesë në të.

Kishte shumë studentë dhe njerëz të dashuruar pas artit, kështu që ishte një mundësi e mirë për t'u prezantuar para tyre.

Linda Doll, kryetare e IWS-së së SHBA-ve

I kam pikturuar një tematikë të vetme në tri fletë të ndryshme sepse, si profesoreshë kam dashur që studentët ta shohin procesin e pikturimit të një pikturë të tillë, në mënyrë që, kur ata t'i kthehen punës sime, ta kujtojnë se si e kam pikturuar atë dhe hapat e ndryshëm nëpër të cilët kam kaluar.

Ishte një ngjarje e mrekullueshme dhe jam e nderuar që më kanë ftuar. Për studentët ka qenë një mundësi shumë e mirë, ku ata kanë pasur mundësinë të shohin shumë njerëz dhe punën e tyre, në mënyrë që më pas të vendosin se çka duan, çfarë dëshirojnë të bëjnë dhe çka duan të thonë ata me punën e tyre.

Gjatë këtij edicioni, të rinjtë patën mundësinë të shohin shumë mënyra të të punuarit dhe ishte një ndihmesë e madhe për ta që ta gjejnë veten e tyre, në mënyrë që jo vetëm të kopjojnë idetë e të tjerëve, por të inspirohen dhe ta zbulojnë inspirimin brenda tyre. Pra, ata panë këtu se secili artist është ndryshe dhe për secilin ekzistojnë rregulla të caktuara, ku të njëjtat thyhen prej një artisti tjetër.

Për neve që ishim pjesëmarrës këtu, patëm mundësinë të shohim një vend të bukur, njerëz të bukur dhe të gjithë ne jemi të nderuar dhe të lumtur që ishim këtu.

Puna e artisteve ishte e mrekullueshme, secili prej tyre ishte unik, aq sa e kanë dhënë përshtypjen që këtu nuk po shohim pikturë, por zëra të ndryshëm.



Edhe një sukses i studentëve tanë

Banka Ekonomike e Kosovës menaxhohet nga një ish-studente e UBT-së

Arritjet e saj në aspektin profesional janë fryt i punës dhe angazhimit të vazhdueshëm, por sipas saj, ndonëse rrugëtimi drejt suksesit nuk ka qenë i lehtë, në UBT e ka gjetur mbështetjen e nevojshme

Ish-studentja e UBT-së në MBE, Merita Gjyshinca-Peja, tashti e 3 vjet është duke e mbajtur postin e kryeshefes ekzekutive në Bankën Ekonomike, teksa njëkohësisht është duke i mbaruar edhe studimet e doktoratës për Menaxhment Strategjik dhe Udhëheqje në IEDC Bled School of Management, në Slloveni.

Arritjet e saj në aspektin profesional janë fryt i punës dhe angazhimit të vazhdueshëm, por sipas saj, ndonëse rrugëtimi drejt suksesit nuk ka qenë i lehtë, në UBT e ka gjetur mbështetjen e nevojshme.

“Balancimi i kohës kushtuar familjes, punës dhe studimeve në një universitet me shumë kërkesa në procesin akademik, siç është UBT, nuk ishte aspak e lehtë, mirëpo falë përkrahjes së familjes, guximit, vendosmërisë dhe fleksibilitetit, të cilin e ofron UBT, unë e kalova këtë kapitull, për të vazhduar me rrugëtimin tim drejt realizimit të ëndrrave të mia”, tha Gjyshinca - Peja.

Duke treguar për sfidat personale drejt përm-

bushjes së qëllimeve të saj, ajo i inkurajoi të rinjtë, e në veçanti gjininë femërore, që asnjëherë të mos dorëzohen përballë vështirësive të natyrave të ndryshme, gjatë zhvillimit dhe ngritjes profesionale.

“Për disa arsye objektive, edhe pse shumë i vogël në moshë, djali im ishte pjesëmarrës me mua në disa nga ligjëratat e mbajtura gjatë vitit të kaluar në Slloveni. Me këtë, dëshiroj t’i inkurajoj të gjithë, e në veçanti vajzat e gratë, që ta sfidojnë veten, të jenë të përkushtuara në arritjen e qëllimeve të tyre në shkollim dhe në zhvillim profesional”, theksoi ajo, nën arsyetimin se, “një shoqëri me shumë gra udhëheqëse, është potencial i fuqishëm për një mirëqenie më të begatë shoqërore”.

Ajo vlerësoi se e ardhmja e suksesshme e studentëve të UBT-së, është e sigurt dhe e pakontestueshme, pasi që sipas saj, ata që studiojnë në këtë institucion, i kanë hapur vetes rrugë drejt një të ardhme të shkëlqyer.



“Inkurajoj të gjithë, e në veçanti vajzat e gratë, që ta sfidojnë veten, të jenë të përkushtuara në arritjen e qëllimeve të tyre në shkollim dhe në zhvillim profesional”: Merita Gjyshinca-Peja

Studentët, të dalluar në shumë fusha

Arbër Berisha i UBT-së zë vendin e parë në emisionin Oxygen

Në emisionin Oxygen Show, studenti i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Arbër Berisha zuri vendin parë, me ç’rast edhe u shpërblye me një shumë të hollash nga organizatorët e këtij emisioni.

Arritjet e tij, studenti Berisha ia atribuon UBT-së, sipas të cilit, njëra ndër arsytet që ka qenë i përgatitur për kuizin e Oxygen-it, ka qenë UBT-ja dhe kjo pasi që, temat e trajtuara gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve kanë qenë të shumëllojshme.

“Nga administratorët e UBT-së kam mësuar se si t’i drejtohem publikut dhe kamerave, në përgjithësi secili njeri që është pjesë e stafit të UBT-së, është shumë i përgatitur për punën që e kryen”, vlerësoi Berisha.

Oxygen Show është një emision i përjavshëm, i pasur me humor, me muzikë, me mysafirë të zgjedhur, si dhe me pjesën e kui zit, si pjesë integrale e emisionit që përmban pyetje nga lëmi të ndryshme.



Fakulteti i Mekatronikës ofron dije që mundëson karrierë të suksesshme

Aplikimi i standardeve ndërkombëtare si dhe zbatimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies, ka bërë që studentët e UBT-së, të zhvillojnë shumë aftësitë praktike, madje të bëhen edhe të kërkueshëm në tregun e punës.

Diedon Llabjani është student në vitin e tretë, në Fakultetin e Mekatronikës në UBT. Ai së fundmi është pranuar si praktikant në “Shkollën Dixhitale” në Prishtinë, me mundësi punësimi në të ardhmen. Aty do ta mbajë pozitën e ndihmësit të instruktorit për robotikë dhe elektronikë dhe do të zhvillojë kryesisht aktivitete robotike me qarqe të thjeshta, manovrimet me lego robotë, etj.

Llabjani ka theksuar se njohuritë metodologjike dhe teorike të përfituara në kurset e studimit në UBT, do t’i zhvillojë edhe në “Shkollën Dixhitale”, sepse, sipas tij, UBT-ja u ka ofruar edukim profesional në Menaxhim të Mekatronikës.

“Në programin Menaxhim i Mekatronikës unë kam përfutur njohuri të menaxhimit të proceseve inxhinierike dhe menaxhimit strategjik që në të ardhmen të jem një ndërmarrës i suksesshëm. Gjithçka që kam mësuar në UBT, do të mundohem ta aplikoj në këtë shkollë, duke u mundësuar perspektivë të lartë në fushën e elektronikës dhe robotikës për brezat e ardhshëm”, ka thënë Llabjani.

Ai tutje shtoi se do të vazhdojë që të gjenerojë ide të reja inovative, sepse, sipas tij, është e rëndësishme për industrinë e inxhinierisë në përgjithësi si dhe për shoqërinë. Po ashtu, ai tha se ky program studimi që e ofron UBT-ja ka për qëllim të nxjerrë kuadro profesionale, të cilët janë të përkushtuar për një karrierë të suksesshme.



Profesori i historisë në Universitetin Kentucky të SHBA-së mbajti ligjëratë në UBT

Olster: Fitorja e Trump-it ishte e pritshme

Zgjedhja e Donald Trump-it për president të Amerikës, ndonëse për shumë ekspertë ka qenë një befasi, për shumë të tjerë ka qenë e pritur, dhe në këtë drejtim kanë qenë ndikues një mori faktorësh, disa prej të cilëve nuk janë marrë në konsideratë as nga vetë kandidatja Clinton. Tendenca dhe premtimet për rregullimin e sistemit bankar dhe për rregullimin e sistemit të bizneseve tjera, polarizimi i pasurisë, borxhi kombëtar, përmirësimi dhe nivelizimi i jetesës për të gjitha shtresat e popullsisë, si dhe paraqitja e vazhdueshme e Trump-it nëpër mediat vendore e ndërkombëtare, madje edhe atëherë kur kanë qenë kundër tij, në një mënyrë kanë ndikuar që ai sot të jetë në postin ku është tani. Këtë konstatim e ka bërë profesori i historisë në Universitetin Kentucky të SHBA-së, David Olster, gjatë ligjëratës tematike të quajtur “Befasia e nëntorit për dikë: Zgjedhja e Donald Trump-it dhe kufijtë e urtësisë konvencionale”. të mbajtur për studentët e UBT-së, në kuadër të serisë së përjavshme të debateve, të cilat po organizohen në UBT. “Familjet dhe njerëzit amerikanë, zakonisht shpenzojnë më tepër të ardhura, se sa që fitojnë, sidomos shtresa e mesme, shumica e të cilëve mbijetojnë përmes borxheve, por edhe përkundër kësaj, Clinton më tepër u angazhua në nivelin

shoqëror, se sa në atë ekonomik”, vlerësoi ai, teksa shtoi se “ndër gabimet më të mëdha të kandidatës Clinton, ishte mbështetja dhe tendenca për të vazhduar sistemin politik të Obama-s, prej të cilit votuesit ishin ndjerë të mashtruar”. Duke numëruar faktorët që e bënë fitues Donad Trumpin, Olster tha se rol të madh në këtë mes kanë luajtur edhe mediat, të cilat sipas tij, i kanë dhënë vazhdimisht hapësirë të madhe, qoftë edhe duke folur negativisht për të. “Çdo ditë, çdo orë, mediat nuk diskutuan vetëm atë se çfarë Trump thoshte, por në mënyrë indirekte dhe të pakontrolluar reklamnin edhe çështjet, në të cilat ai ishte i përqendruar, pra në një farë forme mediat transmetonin atë që amerikanët kishin dëshirë të dëgjonin, duke e lënë tërësisht nën hije kandidaten tjetër”, prandaj sipas tij, “kjo është edhe arsyeja se pse Clinton harxhoi mbi 1.2 miliardë dollarë në fushatën e saj presidenciale, përkundër Trump-it, i cili harxhoi më pas se gjysmën e këtyre parave”. David Olster ka qenë president i Asociacionit për Studime Bizantine për Amerikën Veriore, është autor i disa librave, i shumë artikujve shkencorë, i recensioneve etj., si dhe pjesëmarrës i rregullt në konferenca ndërkombëtare shkencore, teksa aktualisht është edhe profesor vizitor në UBT.



“Çdo ditë, çdo orë, mediat nuk diskutuan vetëm atë se çfarë Trump thoshte, por në mënyrë indirekte dhe të pakontrolluar reklamnin edhe çështjet, në të cilat ai ishte i përqendruar, pra në një farë forme mediat transmetonin atë që amerikanët kishin dëshirë të dëgjonin, duke e lënë tërësisht nën hije kandidaten tjetër”, tha Olster

Projekte të përbashkëta me komunat e Kosovës

Fillon bashkëpunimi mes UBT-së dhe komunës së Gjakovës

Rektori Hajrizi dhe kryetarja Kusari- Lila kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila ofron mundësi bashkëpunimi në fusha të ndryshme, me theks të veçantë në kontributin që do ta ofrojë UBT, për zhvillimin e komunës së Gjakovës

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, dekani i Fakultetit të Arkitekturës, prof. dr. Lulzim Beqiri dhe dekani i Inxhinierisë së Ndërtimit prof. dr. Muhamet Ahmeti, kanë pritur në takim kryetaren e komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila. Me këtë rast, rektori Hajrizi dhe kryetarja Kusari- Lila kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila ofron mundësi bashkëpunimi në fusha të ndryshme, me theks të veçantë në kontributin që do ta ofrojë UBT, për zhvillimin e komunës së Gjakovës. Duke folur për rëndësinë e bashkëpunimit me komunat e Kosovës, Hajrizi tha se kjo marrëveshje ka për qëllim sigurimin e programeve të përbashkëta të bashkëpunimit, në zhvillimin dhe implementimin e programeve për zhvillim ekonomik dhe industrial të komunës së Gjakovës, si dhe në organizimin e aktiviteteve të tjera të interesit të dyanshëm. “UBT do ta ndihmojë komunën e Gjakovës në dhënie të ekspertizës profesionale, me qëllim të arritjes së një shkalle të suksesshme të ndërtimit të kapaciteteve institucionale, në planifikim urban të Gjakovës, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta”, theksoi rektori. Në anën tjetër, kryetarja e komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari –Lila shprehu gatishmërinë e komunës, që ajo e drejton, për të mbështetur projektet e përbashkëta, që do të iniciohen në vazhdim. Iniciativën për këtë bashkëpunim e kanë filluar përgjegjësi i Zyrës së projekteve, Burim Meqa dhe prodekani i Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. Visar Krelani. Me kryetaren Kusari- Lika, rektori Hajrizi dhe dekanët e fakulteteve përkatëse, kanë diskutuar edhe për projektin e Modernizmit në Gjakovë, projekt ky i ngjashëm me atë që UBT e ka finalizuar në komunën e Ferizajt.



Ligjërata tematike “Roli i Mediave në kontekstin bashkëkohor”

Drejtori i RTK-së flet para studentëve

Drejtori i përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës, Mentor Shala ka vizituar sot kampusin e UBT-së në Prishtinë, me ç’rast për studentët ka mbajtur edhe ligjëratë tematike “Roli i Mediave në kontekstin bashkëkohor”. Shala ka thënë se aktualisht mediet përballen me një nga problemet kryesore që ka të bëjë me zhvillimin profesional të tyre, por sipas tij kjo ndodh si pasojë e çështjes së financimit si dhe tendencës për dominim në tregun medial. Drejtori Shala ka theksuar se mediet në vend e sidomos

RTK-ja, janë tërësisht në agjendën e grupeve të interesit, në veçanti të atyre politike, e që tentojnë të mbajnë një lloj kontrolli politik. “Presioni nuk është i drejtpërdrejt nga grupet e ndryshme të interesit, por edhe në këtë mënyrë transmetuesi publik dhe ato private, detyrohen që të zhvillojnë një lloj vetë censure në kuadër të raportimit të tyre, sepse në këto rrethana nuk mund të raportohet drejtë e sipas standardeve që kërkohet”, ka thënë Shala.

Shala tutje ka potencuar se RTK-ja, është në shërbim të publikut, si dhe vazhdon të jetë i pavarur nga ndikimi politik dhe komercial. Në fund studentët e pranishëm të drejtimeve Media dhe Komunikim, Shkencave Politike dhe Juridikut patën mundësinë për të bërë pyetje. Ndërkohë, Drejtori i përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës, Mentor Shala, studentëve të UBT-së gjithashtu u ka ofruar edhe mundësinë për të bërë punë praktike.

Bashkëpunimi me universitetet nga SHBA

UBT dhe Morehead State University nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi



Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi dhe përfaqësuesi i Morehead State University, në SHBA, Jorge Ortega, në cilësinë e përfaqësuesve të këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi, në kuadër të të cilit përfshihen shkëmbimi i përvojave në fushën edukimit, si dhe krijimi i mundësive për studentët.

Marrëveshja parasheh realizimin e disa aktiviteteve të përbashkëta mes UBT-së dhe MSU-së, duke përfshirë eksplorimin e mënyrës së krijimit të kampeve verore në SHBA dhe ofrimin e mundësive tjera afatshkurtra për studentët e UBT-së, pastaj mundësitë e shkëmbimit të studentëve mes këtyre dy institucioneve, realizimin e vizitave të përbashkëta studimore, si dhe ofrimin e ndihmës së ndërsjellë në fusha të ndryshme studimi, në zhvillimin e kurrikulave, si dhe në implementimin e programeve të reja të studimit.

Morehead State University (MSU), me seli në Kentucky të SHBA-ve, është njëri ndër universitetet publike më të njohura, që ofron programe universitare dhe pasuniversitare, si dhe zhvillim të programeve të doktoratës, teksa numëron mbi 11 mijë studentë aktivë, që i takojnë 31 kombesive të ndryshme dhe mbi 64 mijë alumni (ish-studentë).

Rektori Hajrizi priti rektorin Pollozhani

UBT krijon bashkëpunim me Universitetin “Nënë Tereza”, në Shkup

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi dhe rektori i Universitetit “Nëna Terezë”, Aziz Pollozhani janë pajtuar që të vendosin bashkëpunim të ngushtë mes këtyre dy institucioneve arsimore.

Sipas kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi do të shtrihet në fusha të ndryshme studimi, duke përfshirë këtu edhe krijimin e mundësive për shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik në programe të ndryshme studimi, për organizimin e trajnimeve të përbashkëta, të cilat kanë për qëllim të bëjnë ngritjen dhe avancimin e stafit të këtyre dy institucioneve, për realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe shkencore etj.

Gjatë këtij takimi, rektorët e vlerësuan të rëndësishme nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Me këtë rast u shprehën të gatshëm që të angazhohen në zbatimin e saj, në mënyrë që të përfitojnë studentët dhe profesorët e këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë.



Profesorë ndërkombëtarë në UBT

Profesori Halizak i Universitetit të Varshavës, ligjëron për studentët e UBT-së

Profesori i Universitetit të Varshavës, në Poloni, dr Marian Edëard Halizak ka vizituar UBT-në, me ç’rast mbajti edhe dy ligjëratë të ndara për studentët e nivelit bachelor e master të UBT-së, që janë pjesë e programit të Varshavës, mundësi kjo e ofruar pas fillimit të bashkëpunimit mes UBT-së dhe Universitetit të Varshavës.

Për studentët e nivelit bachelor, Halizak ligjëroi temën më

titull “Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, si teori për shtjellimin e ngjarjeve globale”, duke u përqendruar tek rëndësia e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar në kohën e globalizimit.

Ndërkaq, për studentit e nivelit master, ai ligjëroi temën “Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare”, duke e vënë theksin tek realizmi dhe liberalizmi.

Universitetit i Varshavës është themeluar në vitin 1816 dhe është institucioni më i madh i arsimit të lartë në Poloni, në të cilin kanë studiuar mbi 53 mijë studentë dhe ka mbi 6 mijë të punësuar.

Ky universitet ofron studime në 37 fusha të ndryshme studimi, i ka 18 fakultete dhe rreth 100 specializime në shkencë shoqërore, teknike dhe natyrore.

Bashkëpunimi Kosovë-Francë

UBT krijon mundësi bashkëpunimi me Universitetin francez “Polytech Annecy – Chambéry”

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, prof. dr Muhamet Ahmeti ka vizituar Universitetin “Polytech Annecy – Chambéry”, në Francë, me ç’rast është takuar me rektorin e këtij universiteti, dr Laurent Foulloy, me drejtorin për Marrëdhënie ndërkombëtare, njëherësh edhe prodekan i Fakultetit për Marrëdhënie Ndërkombëtare, dr Philippe Bolon, si dhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të këtij universiteti, teksa vizita u ndërmjetësua nga presidenti i Shoqatës Franko-Shqiptare, Tahir Shabani.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte që të hidhen hapat e parë drejt krijimit të bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve, me ç’rast përfaqësuesit e tyre shprehën gatishmëri për lidhjen e bashkëpunimit ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimeve, pjesëmarrje në programe të ndryshme, duke përfshirë Erasmus+ dhe programe tjera evropiane, pastaj

shkëmbimin e studentëve, realizimin e vizitave të përbashkëta studimore, pjesëmarrjen dhe organizimin e konferencave ndërkombëtare shkencore etj.

Këtij takimi, rëndësi të madhe i kushtuan edhe gazetaret dhe televizionet lokale franceze, të cilat takimin e paraqitën si kontaktin e parë ndëruniversitar mes institucioneve arsimore nga Franca dhe Kosova.

Universiteti “Polytech Annecy – Chambéry” është themeluar në vitin 1979 dhe numëron rreth 14 mijë studentë, mbi 1200 persona të punësuar dhe ofron studime në nivelet bachelor, master dhe doktoraturë, në katër fakultete të ndryshme, teksa aktualisht, ky institucion është i renditur në ranglistën e 50 universiteteve më të mira në botë.



Trajtesë

Disponueshmëria dhe cilësia e kapitalit njerëzor si parakusht për tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte

Prof.Dr. Nazmi ZEQRIRI



Një nga problemet ekonomike të shteteve në zhvillim, përfshirë edhe Kosovën, është se kapitali i brendshëm për investime është i pamjaftueshëm për të financuar investimet e domosdoshme që sigurojnë rritje të qëndrueshme afatgjate. Prandaj këto vende kanë nevojë të vazhdueshme për kapital shtesë, i cili mund të sigurohet përmes Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Hulumtimet e shumta tregojnë (sidomos për vendet e pazhvilluara dhe vendet në zhvillim) se IHD, përveç sigurimit të kapitalit shtesë investues, sjellin edhe përfitime të tjera për vendin mikpritës, siç është transferimi i teknologjisë, rritja e konkurrencës, rrjetëzimin e kompanive vendore dhe të huaja, promovimin e kapitalit njerëzor dhe efekte të tjera anësore pozitive.

Asnjë vend nuk është në gjendje të tërheq sasinë, cilësinë dhe llojin e dëshiruar të IHD, sikurse asnjë investitor i huaj nuk është në gjendje të investoj kapitalin e tij pa studiuar kushtet lokale në vendin mikpritës. Tërheqja e investitorëve të huaj në vendet si Kosova kërkon qasje dhe politika që janë komplekse dhe që nuk kufizohen vetëm në sferën e ekonomisë. Për të kuptuar ndërlidhjen në mes të investitorëve të huaj dhe kushteve vendore, me rëndësi është të studiohen faktorët përcaktues të vendimmarrjes nga investitorët e huaj për të bërë investime në një vend të caktuar. Ndër faktorët përcaktues që ndikojnë në vendimin për të investuar është stoku dhe cilësia e kapitalit njerëzor. Kjo bazohet kryesisht në qëndrimin se i vetmi faktor që përcakton diferencat në mes të vendeve sa i përket konkurrueshmërisë dhe produktivitetit është faktori njeri. Kështu që, investitorët janë në kërkim të tregjeve ku forca punëtore është e disponueshme dhe me shkathësi adekuate. Në rastin e Kosovës, që dominohet nga një popullsi e re, kapitali njerëzor mund të bëhet përcaktuesi kyç për tërheqjen e IHD.

Derisa në vendet e zhvilluara ka debate pro dhe kundër IHD (sidomos rreth llojit të IHD kur një investim mund të bëhet nga kapitali vendor), në vendet e pazh-

villuara dhe ato në zhvillim ekziston një pajtueshmëri rreth nevojës për IHD për të përmbushur nevojën për investime që nuk mund të realizohen përmes investimeve vendore. Si rezultat, tërheqja e IHD shpeshherë bëhet objektivi e rëndësishme në politikat ekonomike të qeverive. Debati i gjerë zhvillohet zhvillohet kryesisht rreth gjetjes së përcaktuesve që ndikojnë në tërheqjen e investitorëve të huaj. Një përcaktues i IHD që ka marrë vëmendjen e shumë hulumtuesve, padyshim është stoku dhe cilësia e kapitalit njerëzor.

Vite më parë, politikat ekonomike për tërheqje të IHD kanë konsistuar në incentivat tradicionale fiskale dhe monetare për të stimuluar investitorët e huaj. Megjithatë, si rezultat i globalizimit, zhvillimit të avancuar teknologjik, komunikues, etj., tërheqja e investitorëve të huaj, e sidomos atyre strategjik, nuk mund të shpjegohet plotësisht duke u bazuar vetëm në teorinë tradicionale ekonomike që merr parasysh përcaktuesit si: kursi i këmbimit, tatimet, institucionet, niveli i mbrojtjes dhe madhësia e tregut. Megjithatë, teoritë e fundit dhe studimet empirike (Moosa 2002; Hoti 2005; Spagat 2006; Enache 2010; Rizvanolli 2010, Zeqiri 2013) tregojnë se ka më shumë përcaktues të IHD sesa përcaktuesit tradicional dhe ky numër është në rritje. Në shumë prej këtyre studimeve, kapitali njerëzor është shumë i rëndësishëm dhe nganjëherë përcaktues kyç në tërheqjen e IHD. Në disa studime, kapitali njerëzor është i pozicionuar si parakusht për tërheqjen e IHD, në veçanti për tërheqjen e llojit të caktuar të IHD. Në këtë drejtim, në rastin e Kosovës (sikurse edhe në vendet tjera në tranzicion), në vitet e para të tranzicionit, kapitali njerëzor nuk ishte parashikuar si problem sa i përket tërheqjes së IHD. Kur filloi tranzicioni, studiues të shumtë argumentuan se niveli i kapitalit njerëzor ishte i lartë dhe nuk konsideroj si sfidë për zhvillim ekonomik dhe tërheqje të IHD. Në shumicën e studimeve, ky opinion bazohet në nivelin e arsimit të arritur të forcës punëtore, por jo edhe përshtatshmërinë e sistemit të arsimit dhe shkathësisë të fituara të të diplomuarve me kërkesat e industrisë dhe ndryshimeve dinamike që kishin ndodhur në tregun e punës.

Jo shumë vonë, u kuptua se sistemi arsimor i trashëguar, si dhe njohuritë dhe aftësitë ekzistuese që kishte forca punëtore nuk ishin në përputhje me kërkesat e reja të tregut, e në veçanti më kërkesa e investitorëve strategjik dhe investimeve të huaja dhe me orientim afatgjatë. Në shumicën e rasteve, kapitali njerëzor ishte relativisht lirë në terma nominal, por jo i përshtatshëm nga aspekti i kompetencave, njohurive, përvojës, etj. Si rezultat, shpejt u kuptua se potenciali njerëzor është përcaktues për IHD, sidomos në sektorët ku ka-

pitali njerëzor është faktori kryesor i prodhimit që krijon vlerën e shtuar. Kjo ishte shumë e evidente sidomos me IHD në sektorin e shërbimeve, të teknologjisë informatike dhe komunikuese, etj. Popullsia shumë e re e Kosovës paraqet një përparësi krahasuese sa i përket potencialit të forcës punëtore në të ardhmen e afërt. Por, në të njëjtën kohë, kjo është një sfidë e madhe për politikë bërësit që të kanalizojnë dhe të orientojnë këtë potencial drejt nevojave që ka tregu dhe interesimeve që shfaqin investitorët. Një nga brengat më të mëdha është se aftësitë dhe kompetencat e punëtorëve nuk janë në përputhje me kërkesat që ka sektori privat, duke sugjeruar kështu nevojën për ndryshime të mëtejme në sistemin e arsimit dhe trajnimit. Komuniteti i biznesit dhe institucionet akademike duhet bashkëpunojnë më tepër për të siguruar përputhshmëri në mes të aftësive dhe kompetencave të fituara nga arsimimi dhe nevojat e biznesit. Edhe pse se janë bërë hapa të mëdhenj në reformimin e sistemit arsimor, sidomos në përshtatjen e kornizës ligjore dhe kurrikulare me vendet të BE, zbatimi dhe përshtatshmëria me kushtet e ekonomisë lokale dhe më gjerë nuk është e kënaqshme. Kjo e nxitë nevojën jo vetëm për përmirësimin dhe reformimin tutje të sistemit arsimor në Kosovë, por edhe monitorimin e rezultateve që dalin nga sistemi si tërësi.

Ka ende shumë pak studime për sa i përket ndërlidhjes në mes të IHD dhe kapitalit njerëzor në Kosovë. Evidenca ekzistuese bazohet në monitorimet dhe studimet sipërfaqësore të institucioneve ndërkombëtare, të cilat nuk mjaftojnë për të kuantifikuar efektin e kapitalit njerëzor në IHD që do të ishte me interes për vendimmarrje. Anketat e fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe raporti i fundit vjetor i UNDP-së lidhur zhvillimet e resurseve njerëzore në Kosovë tregojnë se niveli i ulët i cilësisë së kapitalit njerëzor në Kosovë mbetet pengesë për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik, si dhe për tërheqjen e IHD.

Nga një hulumtim i realizuar nga Zeqiri (2013) më 2013 dhe i vëzhguar edhe në vitin 2014 me 30 kompanitë më të mëdha të huaja që kishin investuar në Kosovë, si dhe me 10 përfaqësuesit e tyre institucionale (odat ekonomike, KIESA, shoqatat, etj.), ka rezultuar se kapitali njerëzor ka qenë përcaktues i rëndësishëm me efekt pozitiv në vendimmarrjen e tyre për të investuar në Kosovë. Megjithatë, hulumtimi ka zbardhur një fakt tjetër interesant, ku rezultojnë se kapitali njerëzor ka qenë kufizues sa i përket vendimit për të zgjeruar më tutje biznesin e këtyre kompanive në Kosovë. Kjo nënkupton se Kosova posedon kapital njerëzor të mjaftueshëm dhe të lirë, por jo të cilësisë së duhur dhe të kërkuar nga biznesi, sido-

mos në disa sektorët të caktuar ku IHD ka gjasa më të mëdha të ndodhin.

Vëzhgimet, analizat e mësipërme dhe situata aktuale rreth kapitalit njerëzor dhe ndërlidhshmërisë me IHD na dërgon tek disa konkluzione dhe rekomandime të rëndësishme për vendimmarrësit dhe politikëbërësit në Kosovë:

Kapitali njerëzor padyshim duhet të trajtohet si resurs ekonomik shumë i çmuar, por edhe si sfidë për aftësinë konkurruese të ekonomisë së Kosovës. Tërheqja e investitorëve të huaj (përveç stimujve monetar dhe fiskal) duhet të shoqërohet me zhvillimin e vazhdueshëm të kapitalit njerëzor përmes krijimit të lidhjeve më të forta në mes të institucioneve arsimore dhe bizneseve. Kjo lidhje duhet të forcohet sidomos në përpilimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të kurrikulave me nevojat e bizneseve, në veçanti me bizneset e huaja. Të sigurohet rritja e fondeve publike dhe private për sistemin e arsimit dhe trajnimeve, sidomos tek pjesa e profesioneve ku mund të përfitohet një kompetencë e veçantë dhe e kërkuar nga investitorët e huaj. Rritja e fondeve duhet të përcillet me matjen e performancës së outputit arsimor.

Një fushë me rëndësi për tu mbështetur është eksporti i shërbimeve. Në këtë sektor ka mjaft “storie të suksesit” dhe replikimi i këtyre mund të ndikoj në rritjen e partneritetit në mes të kompanive lokale dhe atyre ndërkombëtare.

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIE-SA) duhet të rrisë kapacitetet e saja informuese në promovimin e kapitalit njerëzor si përparësi konkurruese, fillimisht si kosto e ultë e kapitalit dhe më tutje si aftësi specifike që ka fuqia punëtore në Kosovë.

Duhet të bëhet decentralizimi i aktiviteteve që lidhen me promovimin e IHD, sidomos duhet të rritet roli i pushtetit lokal në ofrimin e stimujve për IHD si dhe koordinim të shtuar ndërinstitucional në mes të të gjithë aktorëve që janë të përfshirë në çështjet institucionale që lidhen me tërheqjen e IHD.

Masa specifike duhet të dizajnohen për tërheqjen e kapitalit nga diaspora, e cila ka akumuluar përvojë të konsiderueshme sa i përket kapitalit njerëzor në vendet ku është e koncentruar si diasporë kosovare. Kjo mund të bëhet me rishikimin e politikave tatimore për rastet kur “stori e suksesit” të diasporës mund të jenë të “përsëritshme” edhe në Kosovë.

Si masë e përkohshme afatshkurtër dhe si shtytës fillestar mund të aplikohet subvencionimi i pagave për punësimin që bëjnë kompanitë e huaja, të cilat kanë plane të zgjerimit të biznesit të tyre në Kosovë, duke u fokusuar në sektorë që kanë përparësi krahasuese dhe potencial zhvillimor për të ardhmen.

Konferenca e Pestë Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion

Gazetat & portalet online

Safet Zejnullahu

Gazetat përballë goditjes së rrufeshme të internetit

Televizioni nuk e zhduku radion. Për ta tronditur po, e largoi nga ambientet tona të banimit, por ajo zuri vend fuqishëm në veturat tona. Parashikimi fillestar për zhdukjen e radios pas fillimit të transmetimit të lajmeve me zë dhe me pamje nuk u bë realitet. Radio u transformua, ndërroi përmbajtje dhe u bë bashkudhëtare e shoferëve.

Me të njëjtën sfidë sot po ballafaqohen gazetatat ditore dhe publikimet e printuara në përgjithësi. Të goditura rëndë nga mediat online, të mundësuar nga zhvillimi i teknologjisë, mediat e printuara janë mbështetur për muri. Kanë humbur shumë terren dhe ndodhen në mjegullnajë. Parashikimi se pas 20 vjetësh nuk do të ketë asnjë gazetë ditore të printuar në letër, ogurzi dhe i frikshëm, i ka dekurajuar pronarët. I ka shtyrë të ecin me hapa tepër të shpejtë drejt varianteve të mbijetesës së gazetave. Hapa që duken nganjëherë sikur vrap për ta nxjerrë të gabueshëm parashikimin, për ta bërë atë realitet edhe më herët.

Por, jo gjithçka duket kaq errët. Pas vrullit të ndikuar nga vala e parë e frikës nga shuarja, shumë pronarë gazetash e revistash, dhe gazetarët gjithashtu, kanë nisur të kërkojnë rrugë e mundësi që gazetat të ndjekin shembullin e radios. Të mos shuhen nga mediat online, siç nuk u shua radio pas paraqitjes së televizionit.

Tirazhi i të gjitha gazetave të printuara në Gjermani, shtet me rreth 82 milionë banorë, është rreth 21 milionë ekzemplarë. Steffen Grimberg, gazetar i TAZ-grupit dhe ekspert i medie, duke analizuar këtë tirazh, meritën më të madhe ua lë gazetave rajonale, të cilat kanë arritur ta mbajnë edhe më tej lexuesin e tyre. Këto gazeta përbëjnë rreth 75 për qind të tirazhit të përgjithshëm të gazetave të shitura në Gjermani.

Por, në këtë tirazh, ta bëjmë të qartë, vetëm rreth 1.5 milionë janë gazeta klasike ditore. Pjesën tjetër e përbëjnë tabloidët, me dominim të temave “për teh shpate” dhe të fotografisë. Në Britaninë e Madhe është një gjendje tjetër nga Gjermania. Publikimet me karakter rajonal u shuan qysh moti, në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar. Janë gazetat e mëdha me seli në Londër që shesin ende miliona ekzemplarë. Nisur nga shpenzimet e mëdha të transportit, është e qartë se gazetat në Britani të Madhe do të preken më shpejt nga ndikimi i medie online. Në Gjermani ky ndikim do të jetë më i ngadaltë.

Por, sa janë ndikuar mediat në këto shtete nga interneti dhe sa janë të rrezikuara prej tij? Është e qartë që rreziku është i madh. Derisa sot mund të gjenden ende në masë të madhe lexues të gazetave, qoftë për shkak të profesionit apo për shkak të shprehisë së leximit të së paku një gazete në ditë, sfida më e madhe do të jetë si të sigurohemi që edhe pas 20 vitesh të ketë lexues të gazetave.

Gjenerata e re, e rritur me internetin, duket e paimagjinueshme që një ditë do të heq dorë nga “bashkudhëtari i përhershëm” dhe do të nisë të lexojë gazeta.

Në këtë kanë ndikuar edhe hapat e pamenduar mirë të gazetave, të cilat, në përpjekje për të mbajtur afër vetes lexuesin, startuan me publikimin falas të gazetave në portalet e tyre online. Kjo përfundimisht ishte një autogol i madh.

Duhet të jetë përfundimisht shumë e qartë se puna e gazetarit duhet të paguhet. Dhe atë nga ai që e lexon tekstin e tij. Natyrisht, tashmë kjo do të kushtojë shumë më lirë, sepse në çmim nuk do të llogariten shpenzimet e shtypit, të transportit e të shitjes, që janë pjesë e gazetës

së shtypur në letër. Pre e këtyre shpenzimeve, sidomos të transportit fizik të ekzemplarëve ra edhe “Newsweek” (numri i fundit u shtyp në vitin 2012). Hoqi dorë nga varianti i printuar në nivel ndërkombëtar, për faktin se nuk mund të përballonte printimin në gjithë botën dhe shpërndarjen e gazetës. Ishte tepër shtrenjtë. Por, në një situatë tjetër është “The Economist”. Mbahet shumë mirë në tregun global, duke mos e ndjerë shumë peshën e ndikimit të internetit.

Ndaj, secilin rast duhet vlerësuar në mënyrë të veçantë. Jo të gjitha mediat e printuara janë mbështetur për muri.

Sipas Steffen Grimberg, përfundimisht, është e qartë se, duke u nisur nga fakti se shprehitë e vjetra nuk hiqen lehtë, në 20-30 vitet e ardhshme nuk duhet të ketë frikë për gazetatat. Por, në periudhën pas kësaj, mediat e shkruara do të kthehen në gjendjen në të cilën ishin në fund të shekullit 18 dhe në fillim të shekullit 19, kur ishin një media e re për elitën qytetare.

Shpresa – gazeta e mirë

Gazetat cilësore janë shumë të shtrenjta. Ky është një konstatim edhe i rëndë edhe shpresëdhënës për botuesit, por edhe për gazetarët profesionist. I rëndë, sepse duke kërkuar mënyra më të lira për prodhimin e lajmit, shumë nga gazeta do të rrëshqasin në joprofesionalizëm dhe do të humbin besimin e lexuesve. Shpresëdhënës për faktin se lexuesi do ta ndjejë nevojën të shpenzojë pak më shumë për të qenë i informuar dhe do të kërkojë sërish gazetën e printuar.

Jay Rosen, profesor i gazetarisë në Universitetin e Nju-Jorkut, eksperti i medias Kevin Sablan dhe Ryan Sholin, drejtor i lajmeve në “Publish2”, pajtohen se gazetaria kualitative është një rrugë për shpëtimin e gazetave, por theksojnë një varg veprimesh që duhet të bëjnë botuesit dhe gazetarët për t’ia arritur kësaj.

Si fillim, gazetarët duhet ta heqin nga mendja e tyre shtypshkronjën ku do të shtypet gazeta. Ata duhet të fokusohen në trajtimin e temave me interes, në gjetjen e burimeve, në shkrimin e lajmeve të mira e interesante. Janë botuesit ata që duhet të vendosin se në cilën platformë do të publikohet lajmi dhe në cilën formë: në gazetë, në faqen e internetit që gazeta duhet domosdoshmërisht ta ketë, në rrjetet sociale. Tek në fund vjen gazeta e shtypur. Ndërlidhja mes të gjitha këtyre është e domosdoshme.

Paul Bradshaw, lektor i lartë për gazetari online në Birmingham City University dhe këshilltar për media, thekson se gazetatat duhet të vendosin një qasje më miqësore me lexuesin. Ai po kështu këshillon që, në një periudhë të mëvonshme, gazetatat të merren me tema më të mëdha dhe, ndoshta, të mos botohen çdo ditë.

Një element tjetër, që mund të ndikojë në qasjen pozitive të publikut ndaj gazetave është edhe përmbajtja që ofrojnë gazetatat në faqet e tyre. Nëse një lajm është lexuar në mbrëmje në portale, apo ka qenë në edicione të lajmeve në televizion, cila është arsyeshmëria që gazeta ta trajtojë këtë si lajm të rëndësishëm. Misioni i gazetarit që shkruan për gazetën e printuar është të shkojë një hap më tej. Përse të mbushen dy faqe të gazetës me raportin nga zhvillimet e mbledhjes së qeverisë ose seancës së kuvendit, kur ato mund të jenë transmetuar drejtpërdrejt në televizion apo në radio apo janë trajtuar gjerësisht në portalet online. Gazeta duhet të merret me prapaskenat e këtyre zhvillimeve, që gjithnjë paraqesin interes për publikun.

Gazetat e printuara duhet t’u afrohen më shumë lexuesve. Ka vite të tëra që gazetatat i kanë hequr

faqet e letrave të lexuesve. Një numër sish i kanë zëvendësuar me komente personalitetesh të rëndësishme, të tjerat thjesht kanë hequr dorë prej tyre. Vendim i pamatur mirë.

Rubrikat e moçme, të dashura për një numër lexuesish, mund të jenë një hap pozitiv për gazetatat. Një reportazh i mirë, një udhëpërshkrim, një fejtון, një bisedë e gjatë në vazhdimë me një personazh të rëndësishëm, pavarësisht nga cila fushë, mund të jetë gjithnjë interesant për lexuesin.

Lajmi për “të panjohurin” dhe lajmi për “të njohurin”

Çka ishin lajmet para 15 vitesh. E blije gazetën në mëngjes, uleshe në një tavolinë në kafene apo në shtëpi dhe lexoje lajmet. Në faqen e parë: “Presidenti Rugova deklaroi...”; “Shefi i UNMIK-ut tha se...”. Cili ligj apo cila rregullore e re u miratua sot. Më tutje lajme nga kronika e zezë. Pak lajme nga ekonomia, nga bota. Sport, fjalëkryq, reklamat dhe përkujtimet.

Qëllimi i gazetës përmbylljen me përmbushjen e kërkesës së njerëzve për të mësuar çfarë ka ndodhur. Apo, për çfarë kanë vendosur ta informojnë redaktorët sot. Në pak rubrika gjeje dikë tëndin, që e njeh personalisht. Një pensionist, të vetmit njerëz që mund t’i njihë ishin ata në rubrikën e përkujtimeve.

Sot rrjetet sociale dhe mediat e tjera online ta krijojnë një mundësi tjetër. Janë gjithnjë e më të paktë njerëzit që nguten ta hapin Facebook-un në mëngjes, për të parë se çfarë ka thënë presidenti, kryeministri apo ndonjë ministër i qeverisë. Çfarë ligjesh janë miratuar, çfarë po ndodhë në Siri apo në Ukrainë.

Por, janë gjithnjë e më shumë, për të mos thënë të gjithë, që e hapin Facebook-un ende pa e pirë kafenë e mëngjesit për të mësuar ku paska qenë vëllai a motra ime mbrëmë, në cilin lokal paskan dalë, me kë kanë qenë e kush ka kënduar aty. Kë kishin mysafir fqinjët tanë mbrëmë, çfarë të rejash ka ndër farefis, miq e shokë. Kush çfarë ka gatur për drekë dje. Cila është receta më e re për ëmbëlsira...

Kjo e bën shumë më atraktiv Facebook-un, sepse po na jep lajme për njerëzit që i njohim, jo për njerëzit që nuk i kemi parë kurrë nga afër.

Pse e morën primatin mediat online

Mediat online morën shpejt terren ndaj gazetave të printuara për çështje shumë praktike. Mund t’i lexosh ku dhe kur të duash. Derisa kishim internet vetëm në kompjuter, gazetatat nuk u ndjenë të rrezikuara, sepse nuk mund ta merrnim kompjuterin me vete dhe të lexojmë lajme rrugës. Por, kur në treg dolën telefonat e mençur dhe lajmet i kemi me vete kudo dhe kurdo, gazetatat u gjetën në një situatë kaosi, të papërgatitura për strategjinë e cila do ta shtyjë lexuesin, që i ka lajmet në telefonin e tij të mençur në shtëpi, të dalë dhe ta blejë një ekzemplar gazete dhe ta shfletojë atë derisa pi kafën e mëngjesit.

Përpjekjet fillestare të gazetave ishin dëshpëruese. Humbën miliona euro në përpjekjet e tyre për ta mbajtur të lidhur lexuesin. Bënë hapin e madh gabim, duke e futur në faqet e tyre të internetit gazetën në format real leximi. Në garë për lexuesin, e bënë gazetën të pavlerë, e mbytën edhe motivin e fundit për të cilin duhet ta blejmë gazetën.

Mbyllja e disa gazetave të mëdha dhe kalimi i tyre vetëm në publikimet online, nga ana tjetër, ishte një goditje e rëndë për të gjitha gazetatat e tjera, që po provojnë të mbesin në treg, duke

hulumtuar alternativa të përshtatjes me ambientin e ri.

Lajmi shumë i shpejtë i bëri atraktive mediat online. Të pranueshme për lexuesin. Dhe ajo që i bën edhe më të afërta me lexuesin është interaktiviteti, gjë të cilën televizioni, radioja e as gazeta nuk mund t’ia ofrojnë lexuesit, së paku nuk e kanë bërë deri në kohën e paraqitjes së medie online.

Jim Hall, në librin e tij “Gazetaria online”, të botuar në vitin 2001, thekson lajmet e shkurta, përshtatjen me kërkesën e lexuesve, shumësinë e mundësive dhe interaktivitetin si elemente në bazë të të cilave mediat online u bënë shumë atraktive dhe dominuese të lexuesit.

Ai e cilëson interaktivitetin të barabartë me elementet thelbësore të gazetarisë – paanshmërinë, objektivitetin dhe të vërtetën.

Ç’është është interaktiviteti? Thënë thjesht, t’ia lëshosh kontrollin lexuesit.

Elemente shtesë pozitive të mediave online janë shumësia e mundësive – tekst, fotografi, video. Dhe liria e lexuesit që vet të zgjedhë çka do të lexojë apo të shikojë. Domethënë, lexuesi ndjehet se ka kontroll në mediumin që atij ia ofron lajmet. Nëse një lajm është i copëzuar në disa pjesë video, lexuesi do të zgjedhë lehtë cilën pjesë ta shikojë. Në televizion, për shembull, nuk e ka këtë mundësi. I duhet ta shikojë materialin nga fillimi deri në fund, edhe pse pjesë të caktuara nuk do të dëshironte t’i shikonte apo do t’i trajtonte si humbje kohe.

Mediat online i mundësojnë lexuesit të mos varet vetëm nga një burim, por të vizitojë media të ndryshme dhe ta përplotësojë informacionin e tij. Në rastin e gazetave, për të parë edhe qasje të tjera, ai duhet të blejë të gjitha gazetatat e ditës. Çka do të thotë kjo për gazetarët e medie online? Shumë e thjeshtë – t’ua lëshojnë kontrollin lexuesve. Kontrollin e kohës dhe të hapësirës në të cilën i konsumojnë lajmet. Të lejojnë që teksti i tyre të mund të merret dhe të publikohet në rrjetet e tyre sociale, t’i lejojnë që ata të porosisin që lajmet t’u shkojnë me e-mail, me mesazh telefoni.

Lexuesin mediat online e kanë bërë pjesë të lajmit dhe kjo është një nga arsyet e suksesit të tyre. Jo rrallë këto media e ftojnë lexuesin të dërgojë material, të bëhet pjesë e përgatitjes së lajmit. Pas kësaj, ai ka hapësirën për të komentuar dhe për ta zhvilluar e për ta zgjeruar edhe më tej lajmin me përmbajtje e elemente të reja. Jo në pak raste, media online madje lejon lexuesit të dërgojnë cilëndo pyetje që duan, për bashkëbiseduesin e caktuar, intervista me të cilin do të bazohet vetëm në pyetjet e lexuesve. Por, me gjithë përparësitë e mundësuar nga teknologjia, mediat online ende përballen me probleme e me defekte, thënë më së thjeshti, profesionale, duke vënë shpesh në dyshim praninë e gazetarisë profesionale në përmbajtjen e lajmeve të tyre.

Vrapi për lajmin e madh, pa e verifikuar atë, shpesh i nxjerr këto media në situata të palakmueshme e të padenja për mëtuesin e një gazetarie profesionale.

Nëse rregull elementar në gazetari është që në lajm të kesh, së paku, të dy anët, në mediat online ku kufi është prishur në masë mjaft të madhe. Më shumë funksionon parimi: shkruaj një herë për njëherë palë, qëndrimin e saj, siguro lexime e klikime, pastaj merre qëndrimin e anës tjetër, dhe sërish siguro lexime dhe klikime. Kjo paraqet shkallën e lartë të rrezikshmërisë. Shumë gazetarë arsyetohen se janë miliona lexues që presin, një minutë e më përpara, lajmin e radhës në median online, ndaj nuk kanë kohë të presin për të marrë edhe qëndrimet e palës tjetër. Por, kjo është shpatë me dy tehe. Audien-

ca me kërkesa mbi mesatare për lajmin e plotë do të dekurajohet nga kjo qasje, do të ndjehet e pavlerësuar.

Mundësia për të publikuar shumë më shumë fotografi se në një gazetë të printuar, si dhe mundësia për ta ilustruar lajmin me video, e pamundur kjo në gazetë, është po kështu me elemente rreziku. Dhe atë, për faktin se shumë media online gjithnjë e më tepër po i kalojnë kufijtë e fotografisë dhe videos së lejuar. Tërheqja e vërejtjes se një fotografi a një video ka në përmbajtje foto të rënda apo shënjimi me +18 kanë treguar se jo që nuk janë elemente mbrojtjeje për lexuesin të cilit, kinse, nuk i dedikohen, por janë shenja tërheqëse, sidomos për të rinjtë që janë nën këtë moshë, për të parë se çfarë qenka ajo që mund ta shohin të rriturit e nuk mund ta shohë unë.

Një prind mund të bllokojë adresa të veçanta në kompjuterin e shtëpisë, por këtë nuk ka mundësi të bëjë në telefonin e fëmijës e as në kompjuterët në internet kafe.

Të lexueshme shumë, por jo profesionale...

Në një treg të vogël sikur Kosova, nuk kishte si të ndodhte ndryshe, pos që gazetat dhe revistat të pësojnë dhimbshëm nga depërtimi i medias online. Një numër gazetash u dorëzuan menjëherë dhe kaluan në publikimet online, ndërkohë që gazetat e tjera vazhdojnë të publikohen ende si gazeta të printuara, por njëkohësisht kanë edhe variantin e tyre online, si dhe janë prezente në rrjetet sociale.

Një veprim i tillë është ndikuar nga shprehia e re e lexuesit që të lexojë gjithnjë e më shumë lajme në internet, por edhe nga fakti se media online është shumë më e lirë se media e printuar.

Media online gazetat i gjeti edhe kështu në një gjendje të rënduar e me vështirësi mbijetese. Kjo më shumë për faktin se, kryesisht, gazetat nuk mundën të ruajnë tirazhin që e kishin, ta zëmë, dhjetë vjet më parë. Atëherë fitimet vinin nga reklammat, kryesisht të institucioneve shtetërore, edhe mediat kishin më shumë të ardhura për të bërë gazeta më të mira, edhe nuk e kontrollonin aq shumë tirazhin. Kur këto reklama u limituan, gazetat provuan edhe pak variante të tjera. Reduktuan stafin në minimum dhe u fokusuan në formatin online. Mbijetojnë me pak reklama ose mbahen me të hyrat që pr-

onarët krijojnë nga të tjera biznese.

Por, ajo që mund të vërehet te gazetat është se nuk ka pasur një përpjekje të dukshme për të ndjekur kërkesat e lexuesve apo për të bërë për vete lexues të rinj.

E portalet online janë një rrëfim në vete në Kosovë. Së pari, janë aq shumë dhe deri tash u kanë bërë ballë vështirësive e kufizimeve ligjore.

Deri në vendimin e Gjykatës Evropiane që bënte përgjegjës mediat online për secilin koment të lexuesit, pjesa më e lexuar e lajmeve në këto media ishin komentet. Aty lejohej të shaje këdo që kishe dëshirë, ta etiketoje gjithashtu çdo njeri që ia kishe inat. Pa kufizim. Kur komentet u panë të rrezikshme, erdhi ndërlidhja me Facebook, për ta mbajtur sërish të hapur grykën e thesit që secili lexues të thotë çfarë të dojë.

Rrallë, pothuaj asnjëherë, mediat online nuk provuan ta vendosin interaktivitetin me lexuesin, që ta bëjnë atë pjesë të lajmit, pjesë të përmbajtjes. Të dy palët, si duket, u pajtuan që të qëndrojnë në pozicionet e tyre – editorët që të bëjnë lajme me “vegëza”, lexuesit që të mund të shajnë këdo e kurdo, pavarësisht me çka ka të bëjë lajmi. Mjafton të nxiten nga një koment dhe nëse lajmi është, ta zëmë, për sport, nëntëdhjetë për qind e komenteve të jenë për fe, politikë, korrupsion e prostitucion.

Mungesa e burimeve kredibile dhe balancimi i lajmit, duke prezantuar së paku dy palë, janë elemente që në mediat online në vend lënë shumë për të dëshiruar. Gjithashtu, pothuaj është modë vjedhja e lajmeve. Për portalet online në Kosovë është krejt e zakonshme nëse të njëjtin lajm, që ka një gabim në titull në portalin ku është publikuar fillimisht, e gjen me të njëjtin gabim në të gjitha portalet e tjera. Një mosrespekt total për lexuesin.

Çka lexojnë dhe në çka besojnë lexuesit në Kosovë?

Një anketë e autorit, që ka përfshirë 100 qytetarë të moshave, gjinive dhe përgatitjes së ndryshme profesionale, jep një pasqyrë të lexuesit rreth medias tradicionale dhe asaj moderne, shkallës së leximit dhe të besimit të lexuesit.

Lexuesit e përfshirë në anketë sipas moshës janë: 53 për qind të moshës 20-30 vjeç, 20 për qind të moshës 30-40 vjeç dhe 27 për qind të moshës mbi 40 vjeç. Për nga gjinia, 54 për qind janë femra dhe 46 për qind meshkuj, 65 për qind kanë të kryer arsimin universitar, ndërsa 35 për qind atë të mesëm dhe nuk kanë vazhduar më tej ose janë studentë. 68 për qind prej tyre jetojnë në qytet, ndërsa 32 për qind në fshat.

Të dhënat e anketës tregojnë një shkallë të lartë të qytetarëve që, me gjithë përgatitjen relativisht të lartë të arsimimit, deklarohen se nuk janë kënaqshëm të informuar me zhvillimet e fundit.

Në pyetjen “A jeni të informuar plotësisht me ngjarjet, në vend dhe jashtë, në të gjitha fushat”, vetëm 62 janë përgjigjur me “Po”, ndërsa 38 me “Jo”.

Ky fakt është shqetësues, por shpresëdhënës për median që po ankohet se nuk ka lexues. Lexues të painformuar ka, por duhet gjetur metodën për t’iu qasur atyre, duhet hulumtuar kërkesat e tyre.

E kur jemi te burimi ku i marrin informatat, ashtu siç pritej, dominon dukshëm interneti si burim i informimit.

Në pyetjen: “Cili është burimi

prej nga i merrni informatat për zhvillimet ditore”, 60 veta kanë theksuar internetin, 20 gazetat, 15 televizionin dhe vetëm 5 radion.

Dominimi i internetit është i kuptueshëm. Është një trend që po ndodh në gjithë botën. Por shqetësues këtu paraqitet fakti se gazetat tek ne e kanë humbur relativisht lehtë betejën për mbajtjen e lexuesit.

E themi këtë mbështetur edhe në përgjigjet që janë marrë në pyetjen vijuese: “Ku janë lajmet më profesionale”, ku 70 për qind e të anketuarve i çmojnë lajmet e gazetave të printuara si më profesionale, në krahasim me 30 për qind që këtë atribut ua njohin portaleve online.

E kur jemi te shprehia e blerjes së gazetave, janë moshë më e madhe, mbi 30 dhe mbi 40 vjeç ata që duket se blejnë gazeta, sado që jo edhe aq shpesh. 57 për qind nga të anketuarit kanë theksuar se blejnë gazeta, ndërsa 43 për qind jo.

Rezultatet e pyetjes “Sa shpesh blini gazetë” tregojnë një shifër më të vogël të atyre që gazetën vazhdojnë ta kenë burim të informatave. “Çdo ditë” gazeta blejnë vetëm 26 për qind, “një herë në javë” blejnë 15 për qind, “rrallë” blejnë 24 për qind, ndërsa nuk blejnë “kurrë” gazeta 35 për qind.

Në pyetjen pse i lexojnë portalet online, përgjigjet janë këto: “I kanë informatat më të sakta”, theksojnë 52 për qind e atyre që burim kryesor të informimit i kanë portalet online, “I kanë informatat atraktive” përgjigjen 31 për qind, “Janë më të shpejta se gazetat”, thonë 7 për qind, “I kanë informatat e verifikuara” thonë 6 për qind, ndërsa 4 për qind i lexojnë portalet thjesht për të pasur ndonjë informatë për zhvillimet e fundit.

Por, cilat rubrika ju interesojnë më shumë: Dominon politika me 42 për qind, e ndjekur nga sporti me 12 për qind, tema nga argëtimi lexojnë 8 për qind, lajmet nga kronika e zezë i tërheqin më shumë 8 për qind, ato nga ekonomia 7 për qind, nga shoubizi 6 për qind, nga shëndetësia 5 nga shoubizi 6 për qind, nga kultura 4 për qind, nga shëndetësia 3 nga shoubizi 6 për qind, nga teknologjia 2 për qind, nga shkenca 2 nga shoubizi 6 për qind dhe lajmet nga temat sociale 1 nga nga shoubizi 6 për qind. Llogaritë e portaleve dhe të gazetave në Facebook i lexojnë 76 për qind e të anketuarve, 24 për qind i qasen drejt portalit.

Por, përgjigjja në pyetjen e fundit të kësaj ankete duhet të jetë shqetësuese për portalet dhe mënyrën se si ato i qasen lexuesit. Të pyetur “A zhgënjeheni kur pas titullit bombastik, në lajm nuk ka asgjë interesante”, 87 për qind e të anketuarve janë përgjigjur me “Po”, derisa vetëm 13 për qind prej tyre duket se kjo nuk u bën shumë përshtypje.

Sfida e së ardhmes: Si të mësohen të rinjtë e “moshës së internetit” që të lexojnë gazeta?

të re. Gjenerata e mesme dhe ajo e gjashtëdhjetëvjeçarë, që e lexojnë gazetën se u ka mbetur shprehri nga e kaluara, edhe kështu, sipas statistikave, janë pakicë, pasi mbi gjysma e popullsisë në Kosovë janë nën moshën 30 vjeçare.

Derisa nuk shohim përpjekje, si të presim rezultat. Që të ruajnë tirazhin, edhe ashtu të vogël, gazetat duhet të bëjmë lëvizje urgjente pozitive në drejtim të pasjes brenda një ekzemplari të lajmeve për të gjitha gjeneratat.

Një titull i shkurtër dhe kuptimplotë, në vend të një titulli të gjatë, është gjithnjë më tërheqës për të gjitha kategoritë e lexuesve.

Një fotografi më e madhe është gjithnjë me tërheqëse sesa fotografitë aktuale, të shumtën të vogla dhe shpesh jokualitativisht të shtypura në letër e gazetës. Pastaj, një nxënës gjimnazi nuk do ta blejë një ekzemplar gazete në të cilën pothuaj çdo ditë në foton kryesore është presidenti, kryeministri, kryetari i kuvendit apo ndonjë nga ministrat, pa marrë parasysh sa e madhe dhe e rëndësishme është tema. Ai e do veten, një koleg, një kolege, një qytetar të zakonshëm në faqen e parë, si ilustrim të një teme që ka të bëjë direkt me të.

Thënë shkurt, gazetat duhet të lëvizin drejt hulumtimit të kërkesave të lexuesve. Magazina ditore, me dominim të lajmeve më të shkurtra dhe fotografive më të mëdha është një zgjidhje e mundshme për të ardhmen.

Gjithnjë derisa një hulumtim ka treguar se, madje edhe studentët e gazetarisë e kanë problem të numërojnë cilat janë tri ngjarjet kryesore të një jave në vend, është e qartë se as mediat online nuk janë duke e bërë punën e tyre si duhet.


Titujt me “karrem kashte”, fotografitë të shumtën e herëve joadekuata dhe tekstet me mungesë burimesh e citatesh e me përmbajtje që lë shumë për të dëshiruar në të shumtën e rasteve nuk lënë shumë për të dëshiruar. Me këto elemente, të pranishme me bollëk në shumicën e portaleve online në Kosovë, media online po tregon se cak kryesor i ka klikimet, lexueshmërinë sekondëshe, e jo përpjekjet për të bërë për vete e për të mbajtur të fokusuar të gjitha gjeneratat e lexuesve.

Profesionalizimi i portaleve është i domosdoshëm. Ky proces do të nxjerrë nga loja portalet me nga një të punësuar, që mbahen në treg me pak reklama e me të gjitha lajmet e “huazuara” nga portalet e tjera. E sotmja po tregon se një portal online, për të mbijetuar në treg, duhet të ketë një redaksi më të madhe se redaksia e një gazete ditore. Ndryshe, vendnumërimi do t’i bëjë ato gjithnjë e më shumë jotërheqëse.


Përmbyllje

Zhvillimet në gazetarinë moderne, të ndikuara nga zhvillimet e teknologjisë, ngadalë e kanë nxjerrë nga loja termin “gazetari kualitativ”, duke i lënë hapësirë “gazetarisë së mirë”, e cila po del se është e mjaftueshme për të mbajtur afër audiencën.

Cili është burimi prej nga i merrni informatat për zhvillimet ditore?



Ku janë lajmet më profesionale?



Teknologjia dhe të rinjtë – fuqi apo kërcënim?

Dr.Zhilbert Tafa



Megjithëse pika nismë e civilizimit digjital mund të lidhet me momentin e realizimit të sistemeve të para kompjuterike, rrjetëzimi midis këtyre sisteme ishte në fakt ajo çfarë bëri që teknologjia të jetë e pranishme në çdo sferë dhe pore të jetës që njohim sot. Për disa dekada të zhvillimit të saj, teknologjia informatike-komunikuese (TIK) invokoi transformime të jashtëzakonshme në shoqëri, ndërsa Interneti, si komponentë fundamentale e saj, sot numëron rreth 3,5 miliardë përdorues.

Çdo gjë pak a shumë filloi si një iniciativë e Ministrisë së Mbrojtjes së SHBA-së për krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm dhe redundat me komutim të paketave. Në fillimet e tija, ky rrjet kishte tërhequr kryesisht hulumtuesit, industrinë dhe institucionet shtetërore, mirëpo shumë shpejt u vërejt potenciali i tij më i gjerë. Kështu, në fillim të viteve të nëntëdhjeta, Interneti u lëshua për përdorim komercial, ndërsa, me rënien e çmimeve të TIK pajisjeve, numri i përdoruesve të Internetit filloi të rritet në mënyrë drastike.

Zhvillimet teknologjike vazhduan në drejtim të përmbytjeve multimediale, rritjes së shpejtësisë komunikuese, mobilitetit dhe minimizimit të dimensioneve fizike të pajisjeve. Sot, teknologjitë kompjuterike (dhe Interneti si mjedis komunikues) janë koncepte portabile të gjithë-pranishme të cilët, në çdo moment dhe nga kudo, mundësojnë kycjen në hapësirën e përbashkët digjital të veprimit dhe të informimit. Megjithëse në këtë hapësirë nuk ka kufizime të ngurta në diversitetin e përdoruesve, përdorimi i internetit është i korreluar me karakteristikat e ndryshme socio-demografike sikur se janë: moshë, gjinia, mundësitë ekonomike dhe fizike, si dhe pozicionimi gjeografik.

Sipas hulumtimeve të fundit (të vitit 2017), në shumë vende të botës, në nivelin e moshës prej 11 deri në 29 vjeçare, përdorimi i Internetit arin rreth 95 %, ndërsa në vendet e zhvilluara edhe rreth 99%. Kjo prezencë e madhe e të rinjve në botën e komunikimeve elektronike, pa dyshim, ka gjenezën në specifikat sociologjike të moshës në fjalë, sikur se janë: nevojat më të theksuara për zgjerimin e eksperiencës, informim dhe arsimim, rrjetëzimi intelektual dhe social, argëtimi etj.

Vlerat e shtuara të teknologjisë

Në pikëpamje edukative, TIK ka thyer barrierat gjeografike duke e transformuar formën fizike të shkruar të informatës në formë digjitale, portabile dhe gjerësisht disponabile. Përderisa 20 vjet më parë, burimet e literaturës shkollore, por edhe të materialeve të tjera informuese, ishin të kufizuara kryesisht në hapësirat e bibliotekave dhe të librave, ku numri i librave ishte po ashtu i kufizuar, të rinjtë sot lehtë mund t'i qasen koleksionit global të materialeve multimediale edukative dhe informuese. Ky koleksion, me ofertën e madhe të metodave pedagogjike dhe të këndvështrimeve të ndryshme informa-

tive, i mundëson të rinjve të kuptojnë materien përkatëse konform afiniteteve personale dhe po ashtu të zhvillojnë mendimin kritik. Rol të rëndësishëm këtu kanë audio dhe video përmbytjet, të cilat, me anë të vizualizimit, në masë të madhe kontribuojnë në perceptimin më të shpejtë dhe në memorizimin e koncepteve të nevojshme edukative.

Trendi i ri në TIK, i quajtur Interneti i gjërave (angl. Internet of Things), mundëson ndërfaqen dhe komunikimin e njeriut me botën fizike në kohën reale. Pajisjet e instaluar në objekte të ndryshme dhe pajisjet mobile i mundësojnë individit dhe shoqërisë informimin në kohën reale si dhe automatizimin dhe kontrollin e proceseve të ndryshme nga largësia (angl. remote control and monitoring). Përveç aplikacioneve të cilat tashmë gjerësisht implementohen, sikur se janë e-banking, orientimi në hapësirë (hartat digjitale dhe GPS), prenotimi mobil i biletave, blerja online etj., në këtë drejtim sot janë aktuale edhe aplikacionet e shtëpiive inteligjente, të qyteteve inteligjent, të shëndetësisë, etj. Praktikisht, përdoruesi mobil mundet, në çdo kohë dhe nga çfarëdo vendi, të komunikojë me hapësirën që e rrethon. P.sh. kur përdoruesi gjendet në pikën e caktuar gjeografike, ai mund (në kohën reale) të informohet në lidhje me gjendjen momentale të vend-parkimeve të lira në afërsi. Po ashtu, ai mund të jetë i udhëhequr me GPS në drejtim të rrugës më të shpejtë deri te destinacioni, duke u bazuar në gjendjen momentale të trafikut. Më tej, duke përdorur pajisje miniaturale mobile, si dhe kamera dhe IoT nyje të instaluar në pajisjet përkatëse, përdoruesi mund të monitorojë dhe të kontrollojë pajisjet shtëpiake nga largësia. Po ashtu, IoT është duke sjellë përfitime të mëdha edhe në mjekësi, ku p.sh. pacienti i cili gjendet në lëvizje, mund të jetë i monitoruar në kohën reale 24 orë nga largësia etj.

Krahas aplikacioneve të lartpërmendura, nga të cilat disa janë ende në fazën e zhvillimit, mundësia e komunikimit të drejtpërdrejtë audiovizual, të rrjetëzimit social dhe të argëtimit online, janë ndër faktorët më tërheqës për popullatën e re. Aplikacionet audiovizuale komunikuese (si p.sh. Skype), kanë mundësuar në masë të madhe përjetimin e komunikimit të afërt dhe direkt midis njerëzve nga largësia. Në anën tjetër, rrjetet sociale në masë të madhe lehtësojnë krijimin e raporteve të reja ndër njerëzore dhe, së bashku me lojërat kompjuterike, tërheqin sidomos popullatën më të re. Kështu, sipas hulumtimeve të vitit 2015, fëmijët e moshës deri në 16 vjeçare, mesatarisht kalojnë përpara ekraneve rreth 6 orë në ditë, ndërsa meshkujt adoleshent edhe deri në 8 orë në ditë. Këto shifra kanë gjithnjë trendin rritës. Për moshën më të re, disa studime tregojnë që përdorimi i kufizuar i lojërave kompjuterike, mund të kontribuojë në zhvillimin e inteligjencës, konkretisht në përmirësimin e memories, zhvillimin e kreativitetit dhe të mendimit logjik. Në anën tjetër, efektet pozitive të rrjeteve sociale kryesish pasqyrohen në qasjen efikase në informatë nëpërmes formës argëtuese, ku informata përshkohet nëpër procesin e “socializmit” të të rinjve në hapësirën virtuale.

“Efektet anësore”

Për fat të keq, pothuaj se të gjitha përparësitë e përdorimit të TIK, kanë edhe anën tjetër të medaljes. Viteve të fundit, paralelisht me përfitimet e shumta nga teknologjitë e avancuara, po identifikohen edhe shumë “efekte anësore” të përdorimit të këtyre teknologji, pasojat e së cilëve do të reflektohen gjithnjë e më tepër në të ardhmen ndërsa në këtë moment vështirë mund të kuantifikohen. Magnituda e shpërndarjes demografike në moshë, edhe në këtë pikëpamje gjendet e pozicionuar tek popullata e re. Këta pa-

soja negative janë të llojeve të ndryshme, duke filluar nga ndikimet edukative, sociale dhe psikologjike, nëpër çështjet e sigurisë, privatësisë, dhe krimi kibernetike e deri te çështjet shëndetësore. Në përputhshmëri me këtë, në drejtim të identifikimit të ndikimeve negative të TIK në shoqëri, e sidomos tek të rinjtë, tashmë janë bërë shumë studime me fokuse të ndryshme. P.sh. në domenin e pasojave socio-psikologjike, disa studime theksojnë ndikimin negativ të komunikimeve mobile në pikëpamje të afërsisë emocionale ndërnjerëzore, kualitetit të konverzacionit, nivelit të empatisë dhe të procesit të ndërtimit të aftësive sociale tek të rinjtë. Përveç masës së madhe të informatave me të cilët të rinjtë hasen çdo ditë, e që, sipas disa hulumtimeve mund të ndikojë negativisht në aftësitë e mëvonshme intelektuale, para së gjithash në aftësinë e koncentrimit, Interneti trajtohet të jetë edhe ekspozues i madh i informatave joad-ekuante për moshat e reja. Kështu, në bazë të një studimi, rreth 90% e të rinjve të moshës 8 deri 16 vjeçare, kryesisht në mënyrë të rastësishme, ka hasur në përmbytje pornografike nëpërmes të rrjeteve sociale. Poashtu, në këtë drejtim shpesh kritikohet dhuna në lojërat kompjuterike dhe ndikimi i saj eventual në ndërtimin e personalitetit të fëmijës ndërsa fenomenologjia e adiktivitetit nga TIK tashmë është profilizuar si një drejtim i posaçëm i trajtimit në psikiatrinë moderne.

Ndër kundër efektet më të mëdha të përdorimit të TIK pa dyshim mund të trajtohen edhe çështjet e sigurisë, privatësisë, të terrorizmit dhe të kriminalitetit kibernetik. Teza që “informata është fuqi”, implikon edhe pyetjen: çfarë ndodhë nëse informata (p.sh. ushtarake, e biznesit apo personale) vidhet dhe keqpërdoret, përkatësisht nëse fuqia gjendet në duar të gabuara? Krahas faktit që për çdo ditë ndërmerren masat teknike për mbrojtjen e informatës, duke qenë se ajo paraqet valutë dhe fuqi, ajo sot gjithnjë e më tepër është e sulmuar. Në njërën anë kemi kërcënime globale nga terrorizmi kibernetik dhe nga dukuritë tjera kriminalistike sikur se janë dëmtimet financiare dhe fizike, gjenerimi dhe shpërndarja e materialeve ilegale (p.sh. pedofilike) etj., ndërsa në anën tjetër kemi cenim të madh të informatës private personale. Rritja e cenimit të sigurisë (globale dhe personale) si dhe të privatësisë, është pasojë e drejtpërdrejtë e rritjes së numrit të pajisjeve, aplikacioneve dhe të përdoruesve të TIK si dhe të intensitetit të përdorimit të teknologjive moderne. Pra, trendet socio-teknologjike tërheqin me vete njëkohësisht edhe rritjen e kërcënimit në pikëpamje të sigurisë, kriminalitetit dhe të privatësisë individuale. Në nivelin individual, këtu prapë më e ndjeshme është popullata e re, në rend të parë fëmijët dhe adoleshentët por gjithashtu edhe moshat më të vjetra. Duke marrë parasysh se individit tashmë gjendet në qendër të një IoT hapësire, privatësia e tij është e kërcënuar nga dy drejtime: nga vetë individit, përkatësisht nga shkalla e ekspozimit të informatës personale në Internet dhe nga të ashtuquajturit Data Controllers (DC), përkatësisht nga pajisjet dhe aplikacionet e përdorura.

Grupi i parë i kërcënimeve vije para së gjithash nga mos informimi adekuat. Kështu p.sh. sipas disa hulumtimeve të bëra disa vite më parë, rreth 88 % e njerëzve në Facebook bënë datëlindjen publike, rreth 30 % “shoqërohen” me persona të panjohur, rreth 50% e zbulojnë vendbanimin, ndërsa një pjesë e madhe e tyre zbulon po ashtu edhe statusin emocional, qëndrimet politike, interesimet tjera e sidomos lokacionin momental (check-in). Edhe pse këta informata, në momentin e parë nuk duken të kenë kapacitet për implikime direkte negative, nëse ndërliken me informata shtesë, mund të keqpërdoren për dëmtime financiare apo

komprometim të individit. Përveç të dhënave individuale, individit mund ta ekspozojë edhe privatësinë e personave tjerë, duke përdorur fotografi të përbashkëta, video etj. Në anën tjetër, pa dijeninë e individit, gjatë përdorimit të aplikacioneve të ndryshme, përdoruesit lënë gjurmë elektronike mbi aktivitetet e përditshme të tyre, duke përfshirë në çdo moment: lokacionin, online aktivitetin, interesimet, dobësitë, sekretet, komunikimet personale, etj. Individit nuk ka kontroll mbi vendin e ruajtjes së këtyre të dhënave, kohëzgjatjen e ruajtjes së tyre dhe në nivelin e sigurisë së të dhënave të tija personale. Një pasojë direkte e ekspozimit të privatësisë në Internet mund të shpjegohet me shembullin që rreth 90 % e korporatave të mëdha botërore, përpara se të punësojnë kandidatin, bëjnë hulumtimin e gjurmëve elektronike të tija në Internet, ku njëri ndër burimet primare janë rrjetet sociale. Këtu mund të numërojmë edhe shumë lloje të tjera të cenimit të privatësisë sikur se janë: incizimet e paautorizuara, përgjimet e mesazheve dhe të bisedave telefonike, etj.

Një çështje po aq e rëndësishme, e cila po tërheq vëmendjen e studimeve të ndryshme multidisiplinare, është ndikimi i TIK në shëndetin e njeriut me theks në popullatën e re. Të rinjtë, gjë që konfirmohet nga Revista Pediatrike e Akademisë Amerikane (në vitin 2005), janë më tepër të ndjeshëm në këtë drejtim sepse strukturat biologjike (e sidomos truri), në këtë moshë, janë në faza të zhvillimit. Këta ndikime fillojnë nga fakti se përdorimi i teknologjisë ka reduktuar gjumin dhe aktivitetin fizik e që drejtpërsëdrejti ndikon në gjendjen shëndetësore të individit. Po ashtu, pozita e qëndrimit përpara ekranit kompjuterik dhe shikimi afatgjatë në ekran, mund të sjellin pasojat në lidhje me ndërtimin e sistemit skeletor si dhe pasojat oftalmologjike. Në domenin e ndikimeve negative të TIK në njeriun, dukuria e cila ka nxitur shumë polemika është edhe faktori i rrezatimit elektromagnetik. Edhe pse valët elektromagnetike, të cilat emitojnë nga pajisjet e ndryshme, si dhe me anë të së cilave realizohet komunikimi pa tela, bëjnë pjesë në kategorinë e rrezatimit jo-jonizues, efektet negative të tyre në shëndetin e njeriut janë gjithnjë e më evidente. Këta efekte kryesisht ndahen në termike dhe ato jo-termike. Duke qenë se valët elektromagnetike, e sidomos ato të frekuencave më të larta, absorbohen nga trupi i njeriut, kjo sjell rritjen e temperaturës në pjesët e trupit të cilat gjinden në afërsi të madhe me pajisjet përkatëse. P.sh. ky efekt termik tashmë është vërtetuar në shumë studime me anë incizimeve termografike të kokës së njeriut pas përdorimit të telefonit celular. Ai ka si pasojë pengesat shëndetësore sikur se janë: insomnia, kokëdhimbja, problemet në funksionin kognitiv, ndryshimet në puls e madje edhe në shtypje të gjakut. Në anën tjetër, tregohet se efekti kumulativ i ekspozimit në valë elektromagnetike, dhe i interferimit të këtyre valëve me proceset elektrike të trurit (i matur për rreth 5-10 vite), p.sh. gjatë përdorimit të telefonit celular ku pajisja gjendet e mbështetur për kokë, ndikon në dëmtimin e qelizave nervore dhe në aftësitë intelektuale të personit, e madje besohet që ndikon edhe në rritjen e probabilitetit për kancerin e trurit. Në anën tjetër, duhet theksuar se ka edhe mjaft studime të tilla të cilat ndikimin e rrezatimit nga TIK pajisjet e trajtojnë të neglizhueshëm për shëndetin e njeriut. Pavarësisht nga efektet e përmendura negative, në pikëpamje kulturologjike, përdorimi i TIK ka ridefinuar perceptimin e kohës dhe të hapësirës dhe ka sjell me vete përfitime dhe vlera të shtuara në çdo aspekt të jetës. Ngritja e vetëdijes dhe edukimit tek të rinjtë, në rrafshin e kulturës digjitale, mund të kontribuojnë në masë të madhe që TIK në duart e të rinjve të mos jetë kërcënim por fuqi.

“Gazetaria Online, etika dhe sfidat

Musa Sabedini



Përhapja e internetit, krijimi i mediave online kanë ofruar më shumë shanse për lirinë e shprehjes, gazetarinë qytetare dhe demokracinë në përgjithësi, por nga ana tjetër, kjo liri ka çuar edhe në shqetësime të reja etike, përveç shqetësimeve të vjetra, ku më të theksuarat kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, pasaktësinë e informacioneve, gjuhën e pa përshtatshme në përmbajtjen online, etj. Duke qenë se përmbajtja online krijohet nga kategori të ndryshëm individësh, jo domosdoshmërisht gazetarë, sjell për pasojë edhe shfaqjen e dilemave dhe problematikave etike, ku siç e përmendëm më lart, janë më evidente në mediat online. Çështja e etikës në gazetarinë online dhe sjellja etike në websajte, sot është një temë që ngjall debate dhe diskutime të vazhdueshme, jo vetëm për standardet etike që aplikohen, por përgjithësisht edhe për të ardhmen e gazetarisë në epokën e digjitalizimit dhe gazetarisë së internetit.

Gazetaria e keqe online dhe shfrytëzuesit e saj

Umberto Eco jo rastësisht ka thënë se Interneti u ka dhënë të drejtën e fjalës budallenjve. “Mediat sociale u kanë dhënë të drejtën e fjalës budallenjve”, janë fjalët e Umberto Eco. Struktura e internetit sipas Eco favorizon përhapjen e atyre që propagandojnë budallallëqe. Në këtë pikë sipas tij, roli i gazetave është shumë i rëndësishëm sepse “duhet të filtrojë me ekipe specialistësh informacionet që vijnë nga interneti sepse askush nga ne nuk është i aftë të kuptojë sot nëse një informacion është i besueshëm apo jo”. Për të bërë këtë sipas tij “gazetat duhet tu dedikojnë të paktën dy faqe analizave dhe kritikave mbi faqet online, njëlloj si mësuesve u duhet tu mësojnë nxënësve si të përdorin të dhënat për të ndërtuar një çështje”.

Gjuha e përdorur në mediet online po e denigron gazetarinë e mirë

Pavarësisht se interneti, mediat sociale, portalet e shumta kanë bërë një revolucion në plasimin e lajmeve të shpejta, kjo nuk do të thotë se gjithçka është në rregull me këtë shpejtësi të madhe të të informuarit. Mediet online shkaktuan revolucion edhe në Kosovë dhe ende po bëjnë një hap përpara për të qenë sa më afër lexuesit e shikuesit. Personalisht mendoj se fakti që çdo kush ka të drejtë të hap një portal dhe të mos i nënshtrohet asnjë kodi, asnjë kriteri profesional e vënë në pikëpyetje shumë besueshmërinë e tyre. Nëse shikohen portalet e vëreni në start se aty dominojnë lajme që shkruhen aty për aty në facebook. Ka personalitete të njohura, deputet e kategori tjera që janë të pranishëm pothuajse non stop në mediet online. Ajo çka është brengosëse në mediet online mbetet gjuha e përdorur. Ndoshka edhe këtu Umberto Eco e ka pasur hallin e madh. “Gjuha po e denigron edhe gazetarinë e mirë. Nga kjo gjuhë e shfrenuar më së shumti përfitojnë “budallenjtë” siç është shprehur Eco. Shkrimet që kjo kategori bënë janë të nivelit dytësor dhe në një shoqëri normale ato do të duhej të korrigjoheshin e seleksionoheshin para se të merrnin dritën e botimit. Mediat sociale mund të shfrytëzohen vetëm si pikënisje ose burim i mundshëm, por në asnjë

mënyrë të krijohen prej tyre lajme ditore serioze. Gazetaria Online duhet ta shmang këtë kategori shfrytëzuesish të cilët dinë të fyejnë, dinë të japin etiketime nga më të ndryshmet. Fjalori që përdoret nga kjo kategori si në rrjetet sociale ashtu edhe në portale të ndryshme është tejet i ulët. Aq më keq që këto fyerje përkrahen edhe nga kategori të caktuara përdoruesish. Profesionistët e pakët nëpër portale e kuptojnë fare mirë shqetësimin tim, derisa ka nga ata që as që donë ta kuptojnë sepse u përshtatet mënyra e të jetuarit në këtë lloj gazetarie. Fatmirësisht gazetatat e pakta ditore kanë hapur edhe portalet e tyre dhe kjo është një shpresë se edhe të tjerët mund të mësojnë se si të plasohen lajmet. Gazetat megjithatë dallojnë në këtë drejtim sepse kanë mundësi të gabojnë më pak ose më rrallë. Nuk dëshirojë të flas për etiken dhe respektimin e saj sepse aty ka një mal gabimesh e keqpërdorimesh nga të gjitha palët.

Humbja e ekskluzivitetit të lajmit

Me shfaqjen e mediave online çështja e ekskluzivitetit të lajmit ka hapur një debat mes gazetarëve tradicionalistë dhe atyre që mbrojnë median e re. Ekspertët kanë mendime të ndryshme në lidhje me këtë, por pavarësisht mendimeve që mbrojnë palët, një gjë është e sigurt: “De facto” nuk ka më ekskluzivitet dhe shumë gjëra tashmë kanë ndryshuar. Nëse deri para pak kohësh, marrja e një deklarate, interviste apo prononcimi nga një politikan deri diku ishte mision i pamundur për mediat e reja, por edhe për mediat jo afër tyre (politikanëve), sot mund të thuhet se të gjithë janë të barabartë në aksesin e këtyre informacioneve. Nëse më parë, kryeministri ose lideri i opozitës do të jepte një intervistë, shanset më të mëdha ishin për 2-3 mediat kryesore. Të gjithë tjerët, dhjetëra televizione, gazeta, portale, radio, etj. ishin të detyruara më vonë të merrnin intervistën apo deklaratën nga media që kishte realizuar këtë intervistë. Edhe në rastet kur jepej një deklaratë për të gjitha mediat, shumica e mediave të reja, por edhe mediave tradicionale më të vogla, nuk arrinin t’a ndiqnin deklaratën përmes gazetarëve prezent në konferencë.

Avantazhet e gazetarisë online

Shpejtësia e plasimit të lajmit, mundësia e menjëhershme për të plotësuar, korrigjuar apo hequr lajmin e pambështetur janë arsyt kryesore pse gazetaria online po përhapet kudo me shpejtësi marramendëse. Ky ndikim vërehet edhe në shtimin e numrit të reklamave dhe të botimeve tjera komerciale në portale gjë që mundëson pavarësinë e politikës së tyre redaktoriale. Gazetaria on-line ka disa përparësi thelbësore ndaj gazetarisë tradicionale: ka më pak shpenzime, si për botuesin ashtu edhe për lexuesin; merr më pak kohë për të lexuar gjërat që dëshiron lexuesi; azhurnohet gjatë 24 orëve, pra çdo orë mund t’i rifreskojë lajmet me të dhëna të reja. Një avantazh i rëndësishëm në gazetarinë online është mundësia e përpunimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të lajmit. Në këtë mënyrë, gazetari fillimisht mund të publikojë një version me pak informacione dhe më pas në varësi të informacioneve që vijnë, i njëjti lajm të përditësohet dhe pasurohet. Me këtë arrihen disa synime. E para, gazetari fiton në kohë dhe arrin ta publikojë lajmin shumë shpejt ndërsa lexuesi po aq shpejtë merr informacionet bazë për një ngjarje. Me përditësimin e mëtejshëm, portali arrin ta mbajë të lidhur lexuesin me ngjarjen në zhvillim ndërsa lexuesi arrin që vazhdimisht dhe në kohë reale të marrë informacione të reja. Kështu, edhe portali rrit audiencën, por edhe lexuesi informohet shumë shpejtë. Një avantazh tjetër në gazetarinë online është edhe eliminimi i mekanizmave të kontrollit dhe hallkave që duhet të kalojë një lajm, derisa të publikohet në një gazetë apo televizion. Këto hallka kontrolli, në të shumtën e rasteve shërbejnë edhe si filtra censurimi të lajmit. Në mediat online, struktura organizative eliminon disa hallka të këtij lloji duke e bërë më të thjeshtë

dhe më të shkurtër procesin e publikimit të lajmit. Kjo edhe e ul mundësinë e kontrollit dhe censurimin e lajmit.

Anët negative të medieve online?

Pornografi dhe materiale seksuale, probleme mendore, probleme me varësinë, çrregullime mendore, probleme sociale, fotografi të frikshme të personave të vrarë apo të lënduar rëndë, urrejtje, drogë, armë dhe dhunë, te dhëna të pasakta dhe rel-evante, nuk ka as kufizim sa i përket përmbajtjeve të cilat mund t’i shpallin fëmijët, duke shfrytëzuar programet për komunikim apo sajtet për rrjetëzim social, shumë lehtë zbulohen të dhënat personale të tyre, prandaj është i mundshëm dhe keqpërdorimi i tyre nga të tjerë. Ka hakerë dhe viruse, funksionimi jo i mirë i sistemit, humbja e të dhënave, dëmtimi dhe shkatërrimi i tërësishëm i disa komponentëve të harduerit, ka rreziqe ligjore dhe financiare, shfrytëzim joligjor i përmbajtjeve të mbrojtura, keqpërdorim i mundësisë për kryerje të transaksioneve financiare, etj.

Kush bën pjesë në Gazetarinë Online

Gazetaria digjitale e njohur si gazetaria online paraqet formën bashkëkohore të gazetarisë në të cilën përmbajtja editoriale distribuohet nëpërmjet internetit. Se çka përmban gazetaria online është pyetje e cila po debatohet nga studiuesit, e megjithëkëtë mund të thuhet se produkti parësor i gazetarisë, lajmi dhe raportet për çështje aktuale, prezantohet si formë e përmbajtje e vetme, ose në kombinim me tekstin, audio, video dhe format tjera interaktive dhe distribuohet në platformat digjitale mediatike. Nuk ekziston një pajtueshmëri absolute se çka nënkuptohet me gazetarinë online dhe atë digjitale. Në fund duhet ta përmblehim duke thënë se mediat online dhe zhvillimet teknologjike jo vetëm që po ndryshojnë median, por po ndryshojnë edhe mënyrën sesi ne i mendojmë mediat. Në të shkuarën mediat ishin institucionet e pushtetshme elitare që ishin të vetmet të cilat kishin në dorë të ndërtonin dhe kontrollonin opinionin publik, apo të vendosnin se cili informacion është lajm, e cili jo. Sot janë njerëzit e zakonshëm ata të cilët mund të mbledhin informacion, ta shpërndajnë dhe komentojnë. Në këtë mënyrë publiku mund të ndikojë median, duke i treguar ai asaj se çfarë është lajm. Dhe ky është vetëm fillimi, të ardhmen, realisht, modestisht, as nuk e imagjinojmë dot. Mediat sociale edhe portalet në Kosovë tashmë janë pjesë e pandarë e komunikimit publik si dhe e zhvillimit të gazetarisë. Padyshim se teknologjia ka ndikim edhe në kualitetin dhe etikën në rrafshin praktik të të bërit gazetari. Debatë për portalet në Kosovë kryesisht po zhvillohet në dy rrafshë: nga perspektiva e konsumuesit të lajmeve dhe nga perspektiva e analizës së kualitetit të lajmit të plasuar në këto medime. Mungesa e analizës së prodhimit të lajmit si dhe mungesa e analizës së kontekstit të themelimit dhe veprimit të këtij lloji të mediave e lë të mangët këtë debat të cilit edhe ashtu i mungon vërtetësia e deklarimeve.

Sfidë mbetet privatësia, plasimi dhe cilësia e lajmeve

Sfidë mbetet privatësia dhe cilësia e lajmeve. Për pjesën e parë, institucionet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të krijuar infrastrukturën e nevojshme ligjore si dhe rregullimin e këtij tregu ndërsa për pjesën e dytë, tregu rregullohet vetë, brenda-për-brenda.

Sulmet kibernetike dhe citimet, sfida e radhës

Një sfidë tjetër për gazetarin online mbetet edhe citimi nga ana e portaleve për shkrimet e publikuara – të huazuara. Ka shumë portale që përdorin metodën copy paste, gjë që paraqet një devalvim të madh të lajmeve të prezantuara, aq më keq kur lajmet e huazuara nuk citohen. Kurse sulmet kibernetike mbeten problemi kryesor i të ardhmes së gazetarisë online. Portalet serioze

kanë deri diku njëfarë sigurie në serverët e tyre, por kjo siguri mund të humbet sa qel e mbyll sytë. Në Kosovë nuk ka persona përgjegjës që merren ekskluzivisht me ndërhyrjet kibernetike, me hakerët e shumtë. Kjo e bënë edhe më të vështirë funksionimin e medias online.

Udhëzime për gazetarinë online

Këto udhëzime për gazetarinë online janë pjesë përbërëse e udhëzuesit të Kodit të Mediave të Shkruara, parimet e së cilës vlejnë edhe për gazetarinë online. Dhe, këto udhëzime kanë të bëjnë me përmbajtjen e komenteve dhe të reagimeve të shkruara nga publiku, të postuara në faqet e medieve si dhe të agjencive të lajmeve, të bazuara në internet siç janë: Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi, Raportimi i krimit, Mbrojtja e fëmijëve dhe e të miturve, E drejta në privatësi, E drejta e autorit, Mbrojtja e burimeve, E drejta për t’u përgjigjur dhe Dallimi ndërmjet përmbajtjes informative dhe reklamave.

Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës

Ky Kod, i derivuar nga standardet ekzistuese ndërkombëtare të praktikës së gazetarisë, mëton të shërbejë si bazë për sistemin vetërregullues i cili do të konsiderohej profesionalisht dhe moralisht i obligueshëm për gazetarë, reporterë, redaktorë, pronarë dhe botues të gazetave, portaleve dhe agjencive të lajmeve.

Etika në gazetarinë online

Parimet etike të cilat duhet të aplikohen për gazetarinë online siç janë plasimi i saktë, i paanshëm i informacionit, verifikimi i lajmeve, citimi i burimeve, huazimi i fotografive e videove, respektimi i drejtshkrimit, etj. janë çështje brengosëse për shumë agjenci, portale e ueb-faqe të ndryshme ekzistuese. Portalet fatkeqësisht janë shkelësit më të mëdhenj të etikës duke mos anashkaluar as gazetatat. Disa shembuj konkret që do t’i trajtojmë tregojnë se sa larg ka shkuar etika në dëm të qytetarisë e demonstruar nga portalet. Çështja e etikës në gazetarinë online dhe sjellja etike në websajte, sot është një temë që ngjall debate dhe diskutime të vazhdueshme, jo vetëm për standardet etike që aplikohen, por përgjithësisht edhe për të ardhmen e gazetarisë në epokën e digjitalizimit dhe gazetarisë së internetit. Nga aspekti etik, në gazetarinë digjitale, përkatësisht gazetarinë online - webgazetarinë, janë shfaqur shumë probleme. Në mediat online, gazetarët sot bëjnë gabime që njerëzit e mediave nuk do të duhej t’i bënin: psh. Të mos botojnë informacione të njëanshme dhe të paverifikuara, nga palë që për botimin e tyre janë në gjendje të paguajnë shumta të mëdha parash. Kjo dëmton integritetin dhe komprometon gazetarinë e pavarur dhe vë gazetarinë në konflikt interesi. Ka sot shumë portale që veprojnë kështu, duke shkelur mbi etikën profesionale dhe normat e gazetarisë profesionale. Rastet tjera kur shkelet etika nga mediat online është përdorimi dhe thirrja në burime anonime, pastaj kopjimi i materialeve në stilin copy – past nga portalet tjera, pa verifikuar saktësinë e tyre. Veprimet tjera që bien ndesh me etikën janë dhe shpikja e burimeve, citateve dhe përpilimi i lajmeve me tituj sensacionalë që deformojnë apo edhe dezinformojnë realitetin.

Dëmet dhe shkeljet ligjore të raportimit gazetar

Dëmet ligjore që mund të shkaktohen nga raportimi gazetar kryesisht vijnë nga raportimi për gjykatat, raportimi për krimet e rënda, fatkeqësitë, aksidentet, zjarret, vrasjet, dhunimet, prostitucioni, kontrabanda, korrupsioni etj. Zakonisht dëmet ligjore në situatat e raportimit vijnë kryesisht rreth shpifjes. Përkufizimi i shpifjes është publikimi i një materiali, i cili dëmton reputacionin e një individi apo organizate.



- 16 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i certifikuar për ekselencë (EFQM)
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfitues për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfitues i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

Kolegji UBT - Bartës privat i Arsimit të Lartë i akredituar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe licencuar nga MASHT.

PROGRAMET E AKREDITUARA

- MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (Baçelor dhe Master)

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Manaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Marketing dhe Shitje
- Biznes ndërkombëtar
- Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit

- SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Baçelor dhe Master)

- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Grafika Kompjuterike dhe Multimedia
- Web Programim
- Rrjete dhe Telekomunikacion
- Robotikë dhe Sistemet Inteligjente
- Inxhinieri Biomjekësore
- Siguria dhe sigurimi i Informacionit
- Multimedia dhe Vizualizim

- MEKATRONIKË DHE MENAXHMENT (Baçelor dhe Master - I vetmi i akredituar në vend)

- Menaxhimi i Mekatronikës
- Automatizimi Industrial dhe Kontrolli i Procesit
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Robotikë dhe Sisteme Inteligjente
- Inxhinieri Biomjekësore
- Inxhinieri e Telekomunikimit
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieri e Aeronautikës

- SISTEMET E INFORMACIONIT DHE MENAXHEMENT (Baçelor dhe Master)

- Sistemet e Informacionit të Biznesit
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Bibliotekave dhe të Arkivave
- Statistikat, Procesimi dhe Simulimi i të Dhënave
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia
- Komerci Elektronik (E-Komerci)

- ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR (Baçelor dhe Master) (I vetmi privat i akredituar në vend)

- INXHINIERI NDËRTIMORË (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË (Baçelor dhe Master)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

- SHKENCA POLITIKE (Baçelor)

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integritime Evropiane
- Administratë Publike

- JURIDIK (LLB - Baçelor)

(Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)

- E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE

DHE EVROPIANE (LLM - Master)

- MEDIA DHE KOMUNIKIM (Baçelor dhe Master)

- POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM (Master)

- INXHINIERI E ENERGJISË (Baçelor)

- INXHINIERI E ENERGJISË EFIÇIENTE

(Diplomë profesionale - I vetmi i akredituar në vend)

- INFERMIERI (Baçelor)

- DIZAJN I INTEGRUAR (Baçelor)

- SHKENCAT E USHQIMIT DHE BIOTEKNOLOGJI (Baçelor)

PËR UBT:

“UBT është krijuar si një universitet ndërkombëtar; një universitet modern që i përmbush nevojat e një shoqërie dhe vendi demokratik, që në vazhdimësi është duke zhvilluar kapacitetet ekonomike dhe teknologjike.”

Edmond Hajrizi, Rektor i UBT-së

”Edukimi është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve , që sot veprojnë ndërkombëtarisht, jo vetëm në hapësirën e Europës, por globalisht. UBT ju ofron mundësinë për të arritur qëllimet-objektivat ndërkombëtare”

“Profesorët e këtij universiteti janë më të mirët , dhe mund të shtojë që studimet tuaja në UBT janë më të mirat për të ardhmen tuaj si dhe të vendit tuaj, por edhe për një të ardhme më të mirë të Europës.”

Dr.Erhard Busek Special Coordinator for the Stability Pact for SEE

REGJISTRIMI

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e pikëve të maturës, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë.

Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që sukcesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe çertifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Liçensa falas për software
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet me prestigjioz vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libraritë më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.
- Çertifikime për kontabilist në bashkëpunim me SCAAK

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Baçelor është **1200 €**, për nivelin Master është **1500 €** me mundësi pagese deri në **12 kështe**.

Për të gjithë **nxënësit e dalluar** UBT ofron përkrahje financiare

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik